



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYT

TEZA:

STATUSI I MITROVICËS NË KONTESTIN KOSOVË-SERBI DHE ROLI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR

KANDIDATI:
Fitim Beka

MENTOR:
Prof. Dr. Zemri Elezi

Shkup, Qershor, 2020

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

ABSTRAKT

Ngjarjet të cilat zona gjeografike e quajtur Ballkan ka kaluar dhe veqanërisht Ballkani Pernëdimor është mjaft komplekse, autentike dhe e veqant për t'u studiuar sepse problemet etnike të paraqitura shekuj më parë janë trashëguar në shtet moderne të sotme dhe janë shëndrruar në brengë për bashkësinë ndërkombëtare.

Kjo tezë do të fokusohet në mosmarrëveshjen e dy shteteve, Kosovës dhe Serbis dhe rolin që faktori ndërkombëtar ka ekzekutuar në zhvillimin e këtij konflikti i cili vazhdon të qendroj i ngurt edhe njëzet vite pas përfundimit të konfrontimit ushtarak në mes këtyre dy vendeve. Qëllimi i këtij hulumtimi është arrija në përfundime shkencore të argumentuara se cilat janë arsyet që ky konflikt nuk po arrin të zgjidhet dhe ofrimi i opsioneve për zgjedhjen e mosmarrëveshjes në mes dy vendeve. Hulumtimi u zhvillua mbi analiza në rrafshin historik, politik, etnik dhe ekonomik. Përmes mënyres krahasimore të mosmarrëveshjeve shtetërore mbi territorin, përmes anketave, librave, artikujve dhe shkencorë. Hulumtimi ndahet në tetë kapituj me qëllim të arritjes në përfundime profesionale, largëpamëse duke përfshir të gjitha elementet e një analize produktive. Kapitulli i parë përmban rishikimin e literaturës dhe përshkrimin historik të konfliktit, mbi mënyrën e rrjedhës së tij që nga paraqitja, dhe identifikimin e karakterit të mosmarrëveshjes. Kapitulli i dytë flet për Veriun e Kosoves (Mitrovicën) dhe rolin e saj. Kapitulli i tretë flet për sovranitetin shtetëror dhe ndërlidhjen e tij me rastin në fjalë. Në kapitullin e katërt do të bëhen Analiza Krahasuese: në kuptimin e krahasimit të rasteve të përafërta në përmbajtje të vetëvendosjes dhe shpëputjes nga shteti i mëparshëm dhe trashëgimi i mosmarrëveshjeve. Kapitulli i pestë flet për rolin e faktorit ndërkombëtar që ka pasur nga fillimi i këtij konflikti ndërshtetërorë dhe vazhdon ende të jete faktori kyqë në arritjen e mundshme të një marrëveshje përfundimtare. Në kapitullin e gjashtë, përfundimi. Kapitulli shtatë gjetjet e hulumtimit dhe diskutim, dhe në kapitullin e fundit, të tetë: kufizimet dhe rekomandimet.

Fjalët kyqe: Kosova, Serbia, Mitrovica, territori, faktori ndërkombëtar, mosmarrëveshje, konflikt, SHBA.

PËRMBAJTJA

Lista e Figurave	I
Shkurtesat.....	II
Shënime mbi Tekstin.....	III
HYRJE	1
Kapitulli i I: VËSHTRIM HISTORIK MBI RRJEDHËN E PROBLEMIT	4
1.1. Pasqyra e Konflikeve Territoriale: Identifikimi i Problemit.....	4
1.2. Teoria e Kaosit.....	5
1.3. Ish-Jugosllavia: E Kaluara e Rajonit Ballkanik.....	6
1.4. Kosova: Rrjedha Historike.....	10
1.4.1. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit.....	15
1.4.2. Plani i Martti Ahtisaarit për Statusin e Kosovës	16
1.5. Këndveshtrime Të Kundërta Mbi Historinë Dhe Aktualitetin	17
1.5.1. Mardhëniet ndër-etnike ndërmjet Kosovarëve dhe Serbëve	17
Kapitulli i II: MITROVICA	18
2.1 Mitrovica: Te dhëna të përgjithshme.....	21
2.1. Rëndësia Gjeopolitike: Strategjike	24
2.3. Vlera e Territorit të Diskutuar: Veriut të Kosovës.....	26
2.3.2. Vlera Ekonomike.....	28
2.3.3. Vlera Simbolike.....	30
Kapitulli i III: SOVRANITETI	34
3.1. Kuptimi i Sovranitetit	36
3.2. Njohja Ndërkombëtare	38
3.3. Autoriteti: Ushtrimi efektiv i Sovranitetit.....	41
3.3.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës: 17 Shkurt 2008.....	44
3.3.2. Kushtetuta e Serbis 2006: Qasja ndaj Territorit të Kosovës.....	44
3.3.3. Ushtrimi i Sovranitetit në Territorin e Kosovës: Veriun e Kosoves.....	45
3.4. Verndimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësis për Rastin e Kosovës	47
Kapitulli i IV: ANALIZA KRAHASUESE	50
4.1. Vlera precedenciale	50
4.2. Vetevendosja: shkëputja dhe kriza e krimes	52
4.3. Osseti jugorë dhe abkhazia (Gjeorgji).....	55
4.4. Nagono karabakh (Armeni).....	58
Kapitulli i V: FAKTORI NDËRKOMBËTAR NË RRJEDHËN E MOSMARRVESHJES	60
5.1. Realizmi.....	60
5.1.1. Konstruktivizmi: Teori Konstruktiviste e së Drejtës Ndërkombëtare	62
5.2. Legjislacioni Ndërkombëtarë për Mosmarrveshjet Territoriale	64
5.2.1. Jurispodencia e Zgjedhjes së Mosmarrveshjeve Territoriale	65
5.3. Komuniteti Ndërkombëtar dhe Kosova	67
5.3.1. Pas Ndërhyrjes në Kosovë.....	68

5.3.2. Procesi i Zgjedhjes së Statusit Final	71
5.3.3. Kosova Shpallë Pavarësinë	74
5.4. Bashkimi Evropian: Prishtina dhe Beogradi.....	76
5.4.1. Procesi i Negocimit: Roli i Bashkimi Evropian	77
Kapitulli VI: GJETJET DHE DISKUTIM	79
Kapitulli VII: PËRFUNDIMI	82
Kapitulli VIII: KUFIZIMET DHE REKOMANDIMET	84
BIBLOGRAFIA.....	86
Shtojca: Anketa.....	90

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Autostrada e Republikës së Kosovës: R7, Morinë-Mërdarë	26
Figura 2: Fabrika e Akumlatorëve në Mitrovicë, isht aktive gjatë Jugosllavicë	27
Figura 3: Gërmadhat e Kishës Mesjetare Ortodokse në Stantërg	31
Figura 4: Kalaja Mesjetare e Zvecanit	31
Tabla 5: Rezultatet e Anketës mbi rëndësin e vlerës territoriale të Veriut të Kosovës	35

SHKURTESAT

BE	Bashkimi Evropian
OKB	Organizata e Kombeve te Bashkuara
GjND	Gjykata Nderkombetare e Drejtesis
GJPA	Gjykata e Perhershme e Arbitrazhit
TNJ	Tribunali Nderkombetar per ish-Jugosllavine
NATO	North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit te Atlantikut te Veriut)
SHBA	Shtet e Bashkuara te Amerikes
KFOR	Kosovo Force
RKS	Republika e Kosoves
BP	Ballkani Perendimor
EJL	Evropa Juglindore
KE	Keshilli Evropian
KBE	Keshilli I Bashkimit Evropian
EDNP	E Drejta Nderkombetare Publike
EDN	E Drejta Nderkombetare
FN	Faktori Nderkombetar
RJMT	Rezoluta e Jurispodences se Marrveshjeve Territoriale
G7	Grupi I Shtate Shteteve te medha te Industrializuara
G8	Grupi I Tete Shteteve te medha te Industrializuara
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
RFSJ	Republika Federale Socialiste Jugosllave

SHËNIME MBI TEKSTIN

Emrat Anglez, Serb dhe Shqipëtar shkruhen duke përdorur formatin standard të shkronjave, emrat e vendeve janë transkriptuar me makrone, përveq kur emri i vendit është i njohur në anglisht (si Tokio). Disa nga emrat e institucioneve ndërkombëtare dhe lokale të përmendura janë përshkruar të perkthyer në gjuhën shqipe sepse përshkrimi i tyre në gjuhën angleze, serbe apo ndonjë gjuhë tjetër e bënë më të komplikuar përmbajtjen e hulumtimit duke dit që hulumtimi është realizuar në gjuhën shqipe dhe më të vështir për tu kuptuar.

HYRJE

Kjo tezë përbën një përpjekje për të hetuar temën e diskutueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbis, të bazuar mbi të drejtën ndërkombëtare dhe rolin që faktori ndërkombëtar ka në ecurin e këtij kontesti. Mosmarrëveshjet territoriale në Ballkanin Perëndimor paraqesin një ngatërrim empirik për studiuesit e Mardhënieve Ndërkombëtare (MN).

Qasjet konvencionale të MN ndaj mosmarrëveshjeve territoriale marrin si sqarim të tyre përshkallëzimin dhe de-përshkallëzimin e konflikteve, ndërsa shpjegimet e tyre varen nga korniza teorike e përdorur: qasjet realiste përqëndrohen në shpërndarjen e aftësive ushtarake ndërsa ato liberale theksojnë ndërvlerësin ekonomike. Edhe qasja e konflikteve territorial – një qasje e krijuar posaqërisht për të studiuar mosmarrëveshjet territorial, kërkon të shpjegojë përshkallëzimin dhe de-përshkallëzimin e konflikteve territoriale. Por mosmarrëveshjet territoriale të Ballkanit Perëndimor, megjithëse të padiskutueshme faktike dhe të prirura për polemika, vështirë se mund të shëndrrohen në konflikte ushtarake duke pasur parasysh rolin e faktorit ndërkombëtar në këtë zonë. Këto qasje konvencionale na lënë kështu pa dyshime të kornizave teorike që mund t'i drejtohem për të kuptuar qfar ndodh në këtë mosmarrëveshje; fakti që nuk ka pasur luftë ushtarake në këtë konflikt në njëzet vitet e fundit nuk do të thotë që nuk egziston rreziku që një gjë e tillë të ndodhë.

Për të vlerësuar këtë situatë, kjo tezë përdorë një qasje konstruktiviste për studimin e kësaj mosmarrëveshje, duke përdorur një kornizë konceptuale “lojën e sovranitetit” (shpjeguar në kapitullin e tretë) e cili na mundëson të analizojmë mosmarrëveshjen në mënyrë konstruktive. Loja e sovranitetit revokon vëmendje kryesore nga përshkallëzimi – de-përshkallëzimi i konfliktit dhe përdorimi i sovranitetit si një burim politik nga shtetet e përfshira.

Në vend që të pyesim, “cilët faktor ose çështje çuan në përshkallëzimin/degjenerimin e konfliktit në një mosmarrëveshje territoriale? Ose “si situata gjeopolitike imponojë përshkallëzimin/de-përshkallëzimin e konfliktit në një mosmarrëveshje territoriale?, pyetja parësore që kjo tezë shtron është: “cili ishte dhe është roli i faktorit ndërkombëtar në këtë mosmarrëveshje?” Përgjigja për të dyja këto pyetje do të bëhet e qartë pasi argumenti ynë të shpaloset; e cila qëndron në mardhëniet ndërkombëtare, ligjet ndërkombëtare, komunitetin ndërkombëtar dhe si kjo formon vendosjen dhe kuptimin e sovranitetit nga shteti dhe lidhjen në mes ligjit dhe politikës, e cila legjitimon sjellje të caktuara në mosmarrëveshjet ndërshtetërore. Pa përjashtuar “trekëndëshin” i cili do të shqyrtohet më gjerësisht në vazhdim të këtij hulumtimi: Prishtinë-Beogradë-Ndërkombëtar. Në gjuhën e

kësaj teze, sfera juridike e mosmarrëvshjes territoriale është ajo që ne e quajmë “lojë e sovranitetit”, në të cilën qëllimi kryesor i shtetit është të fitoj ose të ruaj sovranitetin mbi territorin e diskutueshëm. Kjo arrihet përmes ushtrimit të sovranitetit mbi territorin e diskutueshëm – domethënë me sjelljen konkrete të shteteve në arritjen e njohjes ndërkombëtare të sovranitetit mbi territorin e diskutueshëm, dhe parandalimin e shtetit tjetër të bëjë të njëjtën gjë.

Fokusi empirik i kësaj teze është statusi që territori i Mitrovicës / Veriu i Kosovës ka në mosmarrëveshjen e Kosovës me Serbin dhe rolin e faktorit ndërkombëtar në këtë proces i cili nga rrafshi politik, etnik, territorial është shtrir edhe në fushën ekonomike dhe kulturore dhe ka sjellë raportet në gjendje të ngrirë. Nuk është qëllim i kësaj teze të sigurojë ekzaminim historik të mosmarrëveshjes, historia është me rëndësi për atë sa ajo vendos kontekstin në fokusin e periudhës së paraqitjes së konfliktit apo në zhvillimin e ngjarjeve që kanë shënuar kthesa në këto raporte. Qëllimet e këtij hulumtimi janë: Analizimi i rolit të komunitetit ndërkombëtar në kontestin Kosovë-Serbi, specifikisht gjatë dy dekadave të fundit, duke u përqëndruar në Luftën e Kosovës dhe fazën pasuese të rindërtimit, shqyrtimi i literaturës mbi përfshirjen e bashkësis ndërkombëtare në Jugosllavi dhe më vonë në Kosovë, shqyrtimin e arsyes dhe arsyetimit të ndërhyrjes ushtarake dhe diplomatike të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, shqyrtimi i situatës politike dhe sociale në Kosovë gjatë këtyre dy dekadave: veqanërisht në veri të Kosovës, vlerësimi i përfshirjes ndërkombëtare në ndërtimin institucional të pasluftës, dhe shpjegimin se suksesi afatëgjatë i kësaj ndërhyrje varet nga bashkëpunimi shumpalësh dhe politikat me qëllime të përbashkëta. Ky punim argumenton se roli i komunitetit ndërkombëtar ka qenë i domosdoshëm jo vetëm në ndalimin e keqtrajttimeve që po u bëheshin kosovarëve, por edhe për të ndihmuar kosovarët të rindërtojnë vendin dhe institucionet e tyre të shkatërruara nga lufta. Dhe në fund argumentojmë se një ndërhyrje e mirorganizuar, shumpalëshe diplomatike / ushtarake e huaj, është një shans i mir i suksesit nëse si në Kosovë, pasohet nga një rindërtim dhe përpjekje e mir koordinuar dhe mirmenaxhuar pas luftës.

Kapitulli i parë “I” bënë një përmbledhje të literaturës mbi mosmarrëveshjet territoriale në përgjithësi, për mosmarrëveshjen në fjalë në veqanti, dhe një përmbledhje historike të rajonit. Kjo përmbledhje merrë në konsideratë qasjet e ndryshme teorike të cilat janë përdorur për mosmarrëveshjet territoriale në fokusin e pyetjes, “si mund të zgjidhet kontesti në fjalë dhe cilat janë arsyet e fillimit të këtij kontesti?”.

Seksioni i parë vlerëson literaturën mbi konfliktin territorialë, duke argumentuar se

përqendrimi i tij metodologjik në konflikt, racionalizimi teorik dhe thjeshtësimi i tij mbi qëstjet komplekse, e bëjnë atë të papërshtatshëm për përdorim në përpjekjen e kësaj teze për të kuptuar rrjedhën dhe zgjedhjen e konfliktit. Kapitulli i dytë "II" fokusohet në Mitrovicë, në rëndësin gjeopolitike dhe vlerën ekonomike, simbolike të atij territori për të dy etnitë. Kapitulli i tretë "III" fokusohet te sovraniteti: përmbledhje literature, analizë dhe përshkrimin e situatës në praktik në ushtrimin e sovranitetit në atë zonë.

Kapitulli i katërt "IV" përbën analiza krahasuese të rastit të Kosovës me raste të tjera të vetëvendosjes, dhe vlerës precedenciale që vendimi i GJND-së ka krijuar për vendet tjera të cilat pretendojnë të arrijnë shtet formimin e tyre, nga verdikti I GJND-së për pavarësin e Kosovës. Kapitulli i katërt "V" përbën argumentimin, analizën, dhe vlerësimin mbi rolin e faktorit ndërkombëtar në kontestin Kosovë-Serbi, bazuar në legjislacionin ndërkombëtar, dhe zhvillimet politike që nga përfundimi i luftës së 1999 dhe nga fillimi i dialogut të inicuar nga BE. Në kapitullin e gjashtë "VI" do të shtjellohen gjetjet e hulumtimit dhe do të zhvillohet diskutim mbi arritjet e hulumtimit. Kapitulli i shtatë "VII" përbën përmbledhjen e përfundimeve të hulumtimit, duke shfaqur rezultatet e arritura nga ky hulumtim. Kapitulli i fundit, kapitulli i tetë "VIII" përmban kufizimet dhe rekomantimet e nxjerra bazuar në gjetjet e hulumtimit, duke ofruar opsione të argumentuara shkencore për arritjen e një zgjidhje për këtë mosmarrëveshje.

KAPITULLI I

VËSHTRIM HISTORIK MBI RRJEDHËN E PROBLEMIT

1.1. PASQYRA E KONFLIKTEVE TERRITORIALE: IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT

Qasja e konflikteve territoriale ka lindur nga paknaqësit e qasjes realiste ndaj luftës dhe territorit, konkretisht realistët i trajtonin mosmarrëveshjet territoriale si “simptoma të konflikteve në mes shteteve, ndërsa lufta për pushtet dhe siguri ishte shkaku i saj i vërtet”,¹ qasja e konflikteve territoriale është ndërtuar mbi faktin empirik se shtetet që kanë mosmarrëveshje territoriale me fqinjët e tyre, ka më shumë mundësi të përfundojnë në luftë me ata “fqinjë”, se shtetet që nuk kanë mosmarrëveshje territoriale.²

Konfliktet territoriale janë pjesë e një ‘qasje më të gjerë qështjesh’, e cila ka tentuar të shpjegojë dhe parashikojë konfliktet ndër-shtetërore, duke përdorur qasje hipotetiko-deduktive të bazuara në sfida /objektivat në shkallë të gjerë, grupe të të dhënave të synuara për të rafinuar edhe më tej hipotezat në lidhje me marrëdhëniet në mes një qështje të caktuar dhe përshkallëzimit / dhe eskalimit të konfliktit. Këto qështje përfshijnë mosmarrëveshjet mbi kufijtë detarë dhe tokësor, por qështjet tokësore konsiderohen gjerësisht si qështja më konfliktuale.³

Mosmarrëveshja që hulumtohet në këtë tezë gjithashtu përmban elementet e lartëcekura por nga karakteri është mosmarrëveshje unike e cila shtrihet në të gjitha fushat e zhvillimit politik ndërshtetëror, kjo mosmarrëveshje ka elemente ndër-etnike, politike, territoriale, kulturore dhe më vonë është kthyer edhe në aspektin ekonomik. Ky kontest mund të cilësohet si shekullor duke parë raportet ndër-etnike në mes Shqiptarëve dhe Serbëve, dhe është mjaft unik për mos aftësinë e zgjidhjes së këtij konflikti edhe nga ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar. Rëndësinë e këtij konflikti e rrit pozita gjeopolitike-strategjike në të cilën ndodhen këto dy shtete dhe për zonën gjeografike që pretendojnë të dy shtetet se është pronë e tyre, e cila do të hulumtohet në vazhdim të kësaj teze.

Ndërhyrja ushtarake dhe diplomatike e huaj në Kosovë ishte iniciativë shumpalëshe e suksesshme që arriti dy qëllime kryesore: 1) ndaloi luftën e përgjakshme në Kosovë, 2) ndihmoi në stabilizimin e Kosovës dhe Ballkanit duke kanalizuar energjinë larg luftës dhe shkatërrimit dhe duke drejtuar atë në rindërtim dhe zhvillim institucional. Kosova konsiderohet një shembull i suksesshëm i “ndërhyrjes humanitare” moderne e shekullit XX. Megjithatë ishte e suksesshme, kjo ndërhyrje dhe tranzicioni pauses la disa pyetje të

¹ Kocs, A., S. (1995). *Autonomy or Power?: Franco-German Relationship and Europe's Strategic Choices 1955-1995*. Publisher: Praeger.

² Senese, D., P., & Vasquez, A., J. (2003), *The Steps to War: An Empirical Study*. Princeton University Press.

³ Hensel, P., & Mitchell, S. (2005), *Issue Indivisibility and Territorial Claims*. GeoJournal.

hapura, të cilat do të gjejnë pëgjigje në zhvillim të këtij hulumtimi.

1.2. TEORIA E KAOSIT

Interesat shtetërore në situata të caktuara janë shumë të ndryshueshme dhe të pandashme idiosinkratike. Pretendimet e zhvendosura të Serbis ndaj territoreve të ish-Jugosllavis formojnë provat empirike të këtij pohimi, i cili është marrë si përfundim logjik duke pakësuar vet idenë e teorisë së MN: pozicioni i Serbis në territoret ish-Jugosllave (pretendimet mbi Kosovën veqanërisht) “është një rezultat i varur nga rrugët e “aksidenteve të planifikuara, historike dhe politike, ndërveprimet kaotike të urdhëresave të përkohshme, diplomatike dhe strategjike, në një kontest të gjerë kulturorë dhe psikologjik. Përpjekjet për të tejkaluar deficitet e dukshme të interesave endogjene dhe mono-kauzaliteste të cilat në gjysëm shekullin e kaluar kanë krijuar mospajtime dhe paknaqësi në mes popujve. Duke u bazuar në teorinë e socializimit dhe teorinë psikologjike për të treguar se si një ndjenjë e viktimizimit e kombinuar me ndëryhrjen ndërkombëtare (në Bosnjë dhe veqanërisht në Kosovë), krijuan një situatë ku politika e jashtme Serbe u bë një i burgosur i kërkesave, egos dhe ëndrrave të tyre për një Serbi të madhe.⁴ Pa dyshim se palet në këtë konflikt mbrojnë qëndrimet e tyre në këtë kontest, dhe mund të citojnë krahasimet e tyre me rastet e ngjashme të mosmarrëveshjeve territoriale (Katalunia-Spanja, Nagorno-Karabakh), për të cilat mund të argumentohet se ka mungesë të transportueshmëris teorike.⁵ Kjo tezë nuk analizon drejtpërdrejt mbi origjinën e interesave, megjithëse përfshin raportet mbi vlerën e territorit të kontestuar në mënyrë që të kuptojmë motivet shtetërore. Në fakt, në përgjithësi qasja që do të adoptohet, ndjekë pas kursin e përshkruar nga Kimura dhe Welch: përfundimi i tyre kryesor është se derisa gjenerimi i interesave të shteteve janë idiosinkratike dhe rezistente ndaj teoris, modelet e sjelljes së shteteve pasi të përcaktohen ato interesa janë të pranueshëm për parsimoninë teorike. Ata argumentojnë se “nëse kërkojmë teori të sjelljes së shtetit që mund të na ndihmojë në identifikimin e modeleve në politikën ndërkombëtare, jo në atë që duan shtetet, por në mënyrën se si ata vazhdojnë ti ndjekin ato.”⁶ Kjo është ajo që kërkon të arrijë kjo tezë: kërkon të identifikojë vlerën e territorit të diskutuar, motivet dhe interesat të cilat ndiqen duke përdorur kapital ekonomik, ushtarak dhe diplomatik përmes lojës së sovranitetit.

⁴ Tomasevich, J. (1975). War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1945. Stanford: Stanford University Press.

⁵ Lee, H. (1996). A Theory of Portability. Springfield Ave., Urbana, USA.

⁶ Kimura, M., & Welch, D. (1998). Specifying “Interests”: Japan’s Claim to the Northern Territories and Its Implications for International Relations Theory. Jstor, The International Studies Association.

1.3. ISH-JUGOSLLAVIA: E KALUARA E RAJONIT BALLKANIK

Idetë për formimin e ish-Jugosllavisë kishin filluar qysh në vitet 1840, ideja për formimin e një shteti të madh i cili për qëllim kishte bashkimin e sllavëve të jugut në një komb, dhe fuqizimin e ndikimit të tyre në rajon i bazuar në gjuhësin dhe etnin e tyre, kishte filluar qysh në atë kohë për tu bërë rreth një shekulli më vonë realitet.⁷ Mendimtarët e cilësojnë këtë iniciativë si një “ëndërrim” të serbëve për krijimin e një perandorie serbe, këto ide erdhën në tokat e sllavëve të jugut, sepse të gjithë njerëzit që jetonin në atë zonë që më vonë do të bëhej Jugosllavi ishin atëherë subjekt i të tjerëve, dhe linjat e fajit të perandorive sunduese i ndanë sllavët e jugut nga njëri tjetri.

Sidoqoftë në vitin 1912, një nga luftërat e para që do të kishin konvuluar këtë rajon në mënyrë periodike përgjatë shekullit XX ishte gati të fillonte. Dy shtete të vogla: Serbia dhe Mali i Zi ishin bërë praktikisht të pavarura – sepse nuk ishin nën kontrollin Turk, por pjesa tjetër e asaj që do bëhej jugosllavi ishte akoma pjesë e Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze.⁸ Me luftën e parë Ballkanike të vitit 1912, gjithqka filloj të ndryshojë. Shtetet e reja të vogla: Serbia dhe Mali i Zi, duke luftuar përkrah Greqis dhe Bulgaris arritën t'i kthejnë Turqit përsëri në Konstandinopojë. Vilajeti i Kosovës u përfshi në Mbretërin e Serbis, dhe Serbia mori një pjesë të madhe të Maqedonisë. Frymëzuar dhe ndihëmuar nga shërbimet sekrete të Serbis, me 28 qershor 1914 një radikalist Serb qëllon trashëgimtarin e perandorise Austro-Hungareze, Franz Ferdinand i cili ishte në një vizitë në Bosnjë.

Pas vrasjes së trashëgimtarit të Austro-Hungarisë, rendi i vjetër ishte zhdukur. Kjo vrasje filloj Luftën e Parë Botërore,⁹ e cila në vazhden e saj shkatërroi Perandorinë Austro-Hungareze. Çka do ta zëvendësonte atë? Shum ushtarë Kroat, Serb dhe të tjerë të jugut sllavë mbetën besnik të Austro-Hungaris gjatë luftës, por kishte të tjerë që nuk ishin të tillë. Më pas, ushtria Serbe do ndihëmonte Kroacin dhe Sllovenin nga ambiciet territoriale të Italis, dhe ky bashkim do të shpëtonte edhe Kroacin nga vetë Serbia, dhe më vonë me 1 dhjetor 1918 do të formohej Mbretëria, e cila u quajt Mbretëria e Serbëve, Kroatëve,¹⁰ dhe Sllovenëve e cila do ekzistonte deri më 1929, kur edhe u formua Jugosllavia. Por menjëher u be e qartë se bashkimi nuk ishte “i lumtur”. Veqanërisht Kroatët e kundërshtuan atë, mbi arsye dhe frikën se kishin shkëmbyer dominimin e vjetër të Vienës me atë të Beogradit Serb. Popullsia Shqipëtare e Kosovës ishte gjithashtu e shqetësuar, shqiptarët nuk ishin

⁷ Judah, T. (2011). Yugoslavia: 1918-2003. BBC, History.

⁸ Shih Referencën 7.

⁹ McCormick, J. (2016). 100 Years After WWI: Local to Global Impact of an International War. University of South Carolina.

¹⁰ Tucker, S. (2005). Encyclopedia of World WWI: A Political, Social and Military History. Santa Barbara, California, Pp, 1189.

sllavë dhe ishin të hidhëruar që Kosova nuk kishte mundur të bashkohej me Shqipërin e cila sapo ishte bërë e pavarur (e cila shpalli pavarësin më 28 nëntor 1912). Nacionalistët Maqedonas gjithashtu kundërshtuan shtetin e ri.¹¹ Kështu Jugosllavia kërceu nga kriza në krizë, deri sa më në fund u rrënua nga një luftë në 1941, kur u sulmua nga Gjermania naziste dhe Italia fashiste e Musolinit. Një klikë e vogël ekstreme fashiste “kuilinge”, e njohur si Ustashas, u instalua në pushtet në kryeqytetin kroat, Zagrebin. Ata filuan një fushtë terrori dhe gjenocidi të drejtuar posaqërisht të serbët e Kroacisë dhe Bosnjës. Rezistenca filloi të shfaqej shpejt. Në Serbi, të ashtuquajturat forcat Çetnike besnike ndaj rendit të vjetër të Jugosllavisë të mbizotëruar nga serbët filluan luftën. Vitet e luftës ishin një makth i gjakdhjesh ndëretnike, luftimeve dhe luftërave pas luftërave.

Ndërsa Jugosllavia ishte e okupuar dhe rezistenca ishte e drejtuar kundër okupatorëve. Forcat e Titos, megjithatë shpejt fituan njohjen e Aleatëve. Ata gjithashtu ofruan një ideal – një ëndërr të “vllazërimit dhe unitetit”, që do të lidhte kombet ose popujt e Jugosllavis. Nga viti 1945 forcat e Titos ishin fitimtare në mënyrë thelbësore, megjithëse ushtria e Kuqe Sovetike kishte ndihmuar në luftë, ajo tani ishte zhvendosur në Evropën qendrore. Kështu që Tito, jo Moska, do të formëonte shtetin e ri. Por Tito ishte një komunist besnik i Stalinit. Ai dëshironte të modelonte vendin e tij në Bashkimin Sovjetik, kështu që u shpall një shtet federal me gjashtë republika: Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia, dhe dy krahina socialiste autonome: Kosova dhe Vojvodina.¹²

Në mes të viti 1945 dhe 1963 territori i Kosovës ishte emëruar zyrtarisht “Regjioni Autonomë i Kosoves dhe Metohisë”, dhe kishte një status të vetëqeverisjes më të ulët se Provinca Autonome e Vojvodinës. Në vitin 1963 Kosovës i ishte garantuar nivel i njëjtë i autonomisë si Vojvodinës dhe duke u bazuar në këtë edhe emri kishte ndryshuar në “Provinca Autonome e Kosovës dhe Metohisë”, në vitin 1968 termi “Metohija” ishte larguar,¹³ dhe parashtesa “Socialiste” ishte shtuar,¹⁴ duke e ndryshuar emrin e provincës në “Provinca Socialiste Autonome e Kosovës”. Në 1974, të dy vendet që kishin statusin e Provincës (Kosova dhe Vojvodina), l’u dha nivel i konsiderueshëm i autonomisë në mënyrë të konsiderueshme. Në vitin 1989, ai nivel i autonomisë ishte ulur. Në vitin 1990 termi “Metohija” u rivendos në emrin provincial,¹⁵ dhe termi “Socialist” u largua. Dhe emri përsëri kaloi në “Provinca Autonome e Kosovës dhe Metohisë, si më parë në mes 1963 dhe

¹¹ Banac, I. (1993). *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*. Cornell University Press.

¹² Huntington, S. (1996). *The Clash of Civilizations and the remaking of world order*. Touchstone, New York, p260.

¹³ Bennett, Ch. (1995). *Yugoslavia’s Bloody Collapse: Causes, Course and Consequences*. Hurst, London.

¹⁴ Cirkovic, S. (2004). *The Serbs*. Malden: Blackwell Publishing.

¹⁵ Ramet, P., S. & Pavlakovic, I., V. (2011). *Serbia Since 1989: Politics and Society under Milosevic and After*. University of Washington Press.

1968. Gjatë 40 viteve të ardheshme Jugosllavia ndryshoj përtej njohjes. Ajo zhvilloi markën e saj të socializimit dhe një shoqëri shumë më të hapur se ajo e fqinjëve të saj komunist. Për ta, dhe për shumë komunist në bote, Jugosllavia dukej se kishte zgjidhur pyetjen e hidhur nacionaliste të së kaluarës, standardet e jetesës ishin të larta dhe ndryshe nga vendet tjera komuniste, qytetarët ishin të lirë të udhëtonin në perëndim, të punonin ose të bënin pushime. Përkundër gjithë kësaj, dhe megjithëse kishte shumë substanca për Jugosllavinë, ajo në të njëjtën kohë ishte “iluzion”. Ekonomia e saj u ndërtua mbi themelet e lëkundshme të kredive masive perëndimore, dhe komunizmi liberal kishte kufijtë e tij, ashtu si edhe vetë natyra e federatës. Nxitjet dhe kundërshtimet e nacionalistëve Kroat dhe Shqiptarëve të Kosovës u shtypën sepse në realitet vlente vetëm fjala e një njeriu, e Titos.¹⁶

Pas vdekjes së Titos në 1980, Federata socialiste Jugosllave filloj të zbulohet, pasi qeveritë e republikave filluan të ushtrojnë kompetencat e tyre që ishin në kushtetutë. Shqiptarët filluan demonstratat për republikën e tyre, madje edhe për shpërbërje dhe bashkim me Shqipërinë.¹⁷ Menaxhimi i këtyre tendosjeve dhe krizave ishte mjaft i vështirë, por nga fundi i viteve 1980 filloj të ndihej se vetë komunizmi ishte në diskutim. Slobodan Milloshevic, një politikan në ardhje në Serbi, duke kapur qështjen delikate të Kosovës arriti në pushtetin supremë. Në 1989 Milloshevic hoqi autonominë e Kosovës dhe përmes një sërë lëvizjesh populiste fitoj kontrollin de-fakto mbi Kosovën, Vojvodinën dhe Malin e Zi, paknaqësit u rritën dhe në këtë mënyrë një spirale e nacionalizmave konkurrues dhe të frikësuar reciprocisht filluan të shkatërrojnë vendin.

Milloshevic në mënyrë të qartë dëshironte ta sundonte gjithë Jugosllavinë, por kur kuptojë se nuk kishte potencial, ai kaloi në një opsion tjetër, atë të Serbis së madhe. Milloshevic argumentoi se federate nënkuptonte se kombet mund të shpërbëheshin prej saj, por jo republikat. Sllovenia pa pakicë indigjene dhe Kroacia mund të largoheshin nga Jugosllavia, por Kroacia nuk mund t’i merrte zonat e saj Serbe. Si rezultat i këtyre trazirave politike dhe konflikteve gjatë fillimit të viteve 1990. Pas një periudhe krize politike dhe ekonomike në vitet 1980, republikat përbërëse të RFSJ u ndanë, por çështjet e pazgjidhura shkaktuan luftëra të hidhura ndër-etnike. Luftërat prekën kryesisht Bosnjën dhe Hercegovinën, pjesët fqinje të Kroacisë dhe disa vjet më vonë Kosovën. Statusi i Kosovës në RFSJ ishte ai i një krahine autonome të Serbisë. Kosova nuk ishte zyrtarisht e barabartë në status me republikat përkatese të RFSJ dhe nuk kishte të drejtë të shpërbëhet sipas kushtetutës së 1974. Sidoqoftë, Kosova posedonte një autonomi të gjerë, përfshirë të drejtën për

¹⁶ Glenny, M. (2001). *The Balkans 1804-1999: Nationalism, War and the Great Powers*. Penguin Publisher.

¹⁷ Mertus, A., J. (1999). *Kosovo: How Myths and Truths Started a War*. University of California Press.

kushtetutën dhe institucionet e veta, dhe konisderohej një “element përbërës” i RFSJ-së.¹⁸

1.4. KOSOVA: RRJEDHA HISTORIKE

Deri në vitin 1912 zona gjeografike e quajtur RKS sot, dhe popullsia e kësaj zone ishte nën sundimin Osman. Pas Luftës së Parë Balkanike Kosova u përfshi në Mbreterin e Serbis me Traktatin e Londrës.¹⁹ Noel Malcolm pretendon se kushtetuta e vitit 1903 ishte ende në fuqi. Kjo kushtetutë kërkonte një Asamble të Madhe Kombëtare para se kufijtë e Serbisë të mund të zgjeroheshin për të përfshirë Kosovën: por asnjë Asamble e Madhe Kombëtare nuk u mbajt kurrë.²⁰ Në kushtetutë Kosova nuk duhet të ishte bërë pjesë e Mbreteris së Serbis. Fillimisht u vendos me dekret.²¹ Partit politike serbe dhe ushtria nuk mundën të bien dakord për qeverisjen e territoreve të sapo pushtuara, përfundimisht kjo u zgjidh me një dekret mbretëror.²²

Më 1918 rajoni i Kosovës me pjesën tjetër të Serbis u bë pjesë e Mbreteris së sapo formuar të Serbeve, Kroatëve dhe Slovenëve (që nga viti 1929 u riemërua si Mbretëria Jugosllave). Gatë periudhës ndërluftuese (1918-1941), statusi kushtetues i rajonit të Kosovës brenda Jugosllavis ishte i pazgjedhur. Me 1941, Mbreteria Jugosllave u sulmua dhe u pushtua nga Gjermania naziste dhe aleatet e saj.²³ Rajoni i Kosovës ishte i okupuar nga Gjermanët (Pjesa Veriore), Italianët (Pjesa Qëndrore) dhe Bullgarët (Pjesa Lindore). Zona e okupimit italian u aneksua zyrtarisht në Shqipërinë Fashiste. Kjo shënoi fillimin e përndjekjes masive të serbëve etnik në rajonet e aneksuara të Kosovës qëndrore.

Më 1944 Tito kishte deklaruar se “do të merrte një autonomi më të gjerë, dhe pyetja se cilës njësi federale, ku do të bashkohen do të varet nga vetë njerëzit, përmes përfaqësuesve të tyre” edhe pse në praktikë vendimmarrja ishte e centralizuar dhe jodemokratike.²⁴ Kishte propozime të ndryshme për t’u bashkuar me Kosovën në zona të tjera (edhe në Shqipëri) por në vitin 1945 u vendos që bashkimi i Kosovës ti bashkohej Serbis. Sidoqoftë një pjesë e ish Vilajetit të Kosoves iu dha Republikës së re Jugosllave të Maqedonis, ndërsa një pjesë tjetër kishte kaluar në Mal të Zi, gjithashtu një entitet i ri. Në korrik 1945 një e ashtuquajtur “Rezolutë për aneksimin e Kosovë-Metohisë në Serbin federale” u miratua nga Këshilli

¹⁸ Reka, B. (2003). UNMIK as an International Governance in post-war Kosova: NATO’s Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations. Spring, Skopje.

¹⁹ Palowitch, K., S. (2002). Serbia: The History behind the Name. Hurst & Company, London.

²⁰ Peric, (1914). La question constitutionnelle en Serbie. Paris.

²¹ Malcolm, N. (1998). Kosovo: A short History. Macmillan, London.

²² Popovic-Obradovic, O. (2013). The Parliamentary System in Serbia: 1903-1914. Zagorac, Belgrade.

²³ Cirkovic, S. (2004). The Serbs. Malden: Blackwell Publishing.

²⁴ Shih Referencën 21.

Rajonal i Popullit” i Kosovës.²⁵ Në parim, shqipja u bë gjuhë zyrtare, por pak ndryshuan në praktikë pasi shumica e gjyqtarëve dhe zyrtarëve qeveritarë ishin sllavë. Në vitet e menjëhershme të pas luftës pati një sasi të caktuar bashkëpunimi me qeverinë shqiptarë, e cila madje dërgoj disa mësues shqip folës në Kosovë.

Regjioni Autonomë i Kosovës dhe Metohisë: 1945-1963

Nga viti 1945 deri në vitin 1963 u quajt Regjioni Autonom i Kosovës dhe Metohisë, i cili ishte një nivel më i ulët i autonomis se Vojvodina.²⁶ Regjiioni Autonom i Kosovës dhe Metohisë u krijua me 3 shtator 1945.²⁷ Pas pushimit me “Cominform” në 1948,²⁸ Jugosllavia shtrëngoi politika të caktuara, përfshir kolektivizimin e shpejt. Kjo qoi në ulje serioze të prodhimit të grurit në Kosovë: kishte mungesë ushqimesh në të gjithë Jugosllavin. Paralelisht me këtë qeveria shqiptare filloi të kritikojë sundimin jugosllav mbi Kosovën, qeveria Jugosllave u përgjigj me goditje ndaj popullatës lokale, në kërkim të “tradhtarëve” megjithëse grupi i hershëm nëntoksor pro-Tirana, nuk u themelua deri në fillim të viteve 1960.²⁹ Në mesin e viteve 1950, Asambleja e PR Serbia vendosi që komuna e Leposavicit (187km²) t’i dorëzohej Rajonit Autonom të Kosovës dhe Metohisë, pas kërkesave të udhëheqjes së Kosovës.³⁰ E cila deri atëher ishte pjesë e Mbreteris së Kraljevës, në të cilën popullësia ishte tërësisht serbe.³¹ Pas kësaj numri i serbëve ra në mënyrë drastike.³² Në vitin 1959 Leposavici u perfshi në provincë.

Provinca Autonome e Kosovës dhe Metohisë 1963-1968

Provinca autonome e Kosovës dhe Metohisë ishte emri i përdorur nga viti 1963 deri në 1968, kur u rrëzua termi “Metohija”,³³ dhe u shtua parashtesa “Socialiste”.³⁴ Kosova zyrtarisht u bë një provincë autonome në vitin 1963 pas reformave kushtetuese, dhe pozicioni i saj u barazua me statusin e Vojvodinës.³⁵ Tensionet në mes Shqiptarëve etnik dhe qeverisë jugosllave dhe Serbe ishin të rëndësishme jo vetëm për shkak të tensioneve

²⁵ Shih Referencën 21.

²⁶ Shih Referencën 19.

²⁷ Krieger, H. (2001). The Kosovo Conflict and International Law: An Analytical Documentation 1974-1999. Cambridge University Press. Cambridge.

²⁸ Healey, D. (1948). The Cominform and World Communism, International Affairs. Oxford Academic.

²⁹ Shih referencën 21.

³⁰ Despotic, D. (1993). Kryqëzim, apo Autoportret nga një armik Kombëtar. Nova Iskra, Beograd. p463.

³¹ Shih Referencën 29.

³² Macura, M. (1989). Problemet e Politikës së rimëkëmbjes së Popullsis në Serbi. Akademia Serbe e shkencave dhe Arteve. Fq 74. (Përkthyer nga gjuha Serbe).

³³ Shih Referencën 13.

³⁴ Shih Referencën 23.

³⁵ Shih Referencën 27.

kombëtare, por për shkak të shqetësimeve ideologjike politike, veqanërisht në lidhje me marrëdhëniet me Shqipërinë fqinje.³⁶ Masat e ashpra shtypëse i'u imponuan shqiptarëve të Kosovës për shkak të dyshimeve se ata ishin simpatizant të politikave staliniste të Enver Hoxhës së Shqipërisë.³⁷

Me 1956 u mbajt një seancë gjyqësore në të cilën shumë komunistë shqiptarë të Kosovës u dënuan si infiltrues nga Shqipëria dhe u dënuan me burg të gjatë. Gajtë kësaj periudhe kohore religjioni Islamik në Kosovë ishte i shtypur dhe të dy: shqiptarët dhe sllavët musliman u nxitën që të deklaroheshin si kombësi turke dhe të emigronin në Turqi.³⁸ Në të njëjtën kohë, serbët dhe Malazezët mbizotëruan qeverinë, forcat e sigurisë dhe punësimin industrial në Kosovë. Shqiptarët kundërshtuan këto kushte dhe protestuan kundër tyre në fund të viteve 1960, duke akuzuar veprimet e ndërmarra nga autoritetet në Kosovë si kolonialiste, si dhe duke kërkuar që Kosova të bëhej republikë, ose duke deklaruar mbështetje për Shqipërinë.³⁹

Provinca Autonome Socialiste e Kosovës: 1968-1990

Ky emër u përdor që nga viti 1968, kur u shtua parashtesa "Socialiste", dhe termi "Metohija" u largua.⁴⁰ Emri Provinca Autonome Socialiste e Kosovës është përdorur zyrtarisht deri në vitin 1990, kur termi "Metohija" u rivendos në emrin zyrtar,⁴¹ dhe termi "Socialiste" u largua. Ndërtimi i Autonomisë substanciale: 1968-1975:

Autonomia e Kosovës u forcua në mënyrë të konsiderueshme në vitin 1968, si rezultat i ndryshimeve të mëdha politike në Jugosllavi. Pas largimit të mëparshëm të Rankovicit në vitin 1966, axhenda e reformatoreve pro-decentralizimit në Jugosllavi, veqanërisht nga Sllovenia dhe Kroacia arritën që në vitin 1968 të arrinin një decentralizim të rëndësishëm kushtetues të pushteteve, duke krijuar një autonomi substanciale në Kosovë dhe Vojvodinë, dhe duke njohur kombësin muslimane në Jugosllavi.⁴² Si rezultat i këtyre reformave pati një rregullim masiv të kulturës dhe policisë së Kosovës, që zhvendoste nga të qenit i mbizotëruar nga serbët në shqiptarët e mbizotëruar nga shqiptarët duke pushuar serbët

³⁶ Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën. (2000). Raporti i Kosovës: Konflikti, reagimi ndërkombëtar, mësimet e marra. Oxford University Press, New York, USA. fq 35.

³⁷ Shih Referencën 36.

³⁸ Shih Referencën 36.

³⁹ Shih Referencën 36.

⁴⁰ Shih Referencën 13.

⁴¹ Sabrina, P., R., & Vieran, I., P. (2011). Serbia Since 1989: Politics and Society Under Milosevic and After. University of Washington Press.

⁴² Melissa Katherine Bokovoy, Jill Aa. Irvine, Carol S. LLilly, 1997, Marrëdhëniet shtet-shoqëri në Jugosllavi, 1945-1992, Scranton, Pennsylvania, USA: Palgrave Macmillan, fq 296

në shkallë të madhe.⁴³ Konsecione të mëtejshme u bënë shiptarëve etnik të Kosovës në përgjigje të trazirave, përfshirë krijimin e Universitetit të Prishtinës si një institucion në gjuhën shqipe.⁴⁴ Këto ndryshime krijuan frikë të gjerë midis serbëve që po bëheshin qytetarë të klasit të dytë në Jugosllavi nga këto ndryshime.

Autonomia Substanciale e Arritur: 1974-1990

Provinca Autonome Socialiste e Kosovës mori më shumë autonomi brenda Serbis dhe Jugosllavisë me anë të reformës kushtetuese në 1974. Në kushtetutat e reja të Serbis dhe Jugosllavisë, të miratuara gjatë reformës së vitit 1974, Kosovës i'u dha një autonomi e madhe, duke lejuar atë të ketë jo vetëm administratën e vetë dhe parlament, por edhe një autonomi thelbësore kushtetuese, legjislativë dhe gjyqësore.⁴⁵ Bazuar në Kushtetutat e SFR, Jugosllavisë dhe Serbi, Autonomia Substanciale e Kosovës gjithashtu fitoi Kushtetutën e saj. Provinca e Kosovës fitoi zyrtarët më të lartë, veqanërisht Presidencën dhe Qeverinë, dhe fitoi një vend në Predidiumin Federativ të Jugosllavisë (përfshirë fuqinë e vetos në nivelin federal).⁴⁶

Branimir Anzulovic, argumenton se luftërat për zgjerim. pushtim territorial në ish-Jugosllavi në vitet 1990 nuk ishin qështje të “urrejtjeve antike” që u rishfaqën pas disa dekadave të paqes sipërfaqësore socialiste dhe “barazisë”, siç portretizohet nga media dhe politikanët përendimorë. Përkundrazi, ato janë luftëra ekspansioniste të nxitura nga intelegjencat nacionaliste serbe që u përpoqën të përfitojnë nga prishja e rendit të vjetër socialistë në Jugosllavi, me qëllimin përfundimtar të krijimit të një Serbie të Madhe.⁴⁷ Anzulovic shpjegon rishfaqjen e kësaj intelegjence nacionaliste, mënyrat se si përdori mitet dhe gjysmë të vërtetat për të justifikuar luftërat e saj agresive dhe përfundimisht gjenocidin në Bosnjë, dhe pasivitetin e pashpjegueshëm të Komunitëve Ndërkombëtarë përballë mizorive serbe në Kroaci, Bosnjë dhe më vonë edhe në Kosovë.

Anzulovic argumenton se organet zyrtare serbe ishin në gjendje të realizonin këtë plan, pa mospërfshirjen e jashtme, sepse fuqitë përendimore ishin të fokusuara kryesisht në rënien e komunizmit, shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe shpërthimin paqësor të shteteve të pavarura në Evropën Qendrore dhe Lindore. Në mars 1981, studentet shqiptarë filluan Protestat në Kosovë, ku nga një protestë sociale u shëndrrua në trazira të dhunshme

⁴³ Shih Referencën 42.

⁴⁴ Shih Referencën 42.

⁴⁵ Shih Referencën 36.

⁴⁶ Kushtetuta Federale Socialiste e Jugosllavis. 21 shkurt 1974

⁴⁷ Anzulovic, B. (1999). *Heavenly Serbia: From Myth to Genocide*, 1st Edition. New York University Press, New York and London.

masive të cilave autoritetet jugosllave ju përmbajtën me forcë. Me 1986, Slobodan Milosevic u bë udhëheqësi i komunisteve serb, i cili më pas kapi kontrollin e Kosovës dhe Vojvodinës duke shkelur të gjitha parimet e mëparshme të garantuara gjatë kohës kur në krye të Jugosllavis ishte Tito. Kjo mund të vërehet veqanërisht në përqarjen e vitit 1987 në Kosovë, e cila u bë dalja përfundimtare e mundësis së paqes mes shqiptarëve dhe jugosllavis. Në 1988 dhe 1989, autoritetet serbe ndërmorën një sërë lëvizjesh të njohura si revolucion anti-buroktarik, i cili rezultoi në largimin e udhëheqjes së krahinës në nëntor të 1988 dhe një ulje të konsiderueshme të autonomis së Kosovës në mars 1989.⁴⁸

Më 28 qershor 1989, Milosevic udhëhoqi një festë masive të 600 vjetorit të një Beteje të Kosovës të vitit 1389. Fjalimi i Milosevicit i “Gazimestanit”,⁴⁹ i cili shënoi fillimin e rëndësisë së tij politike, ishte një pjesë e rëndësishme e ngjarjeve që kontribuan në krizën e vazhdueshme në Kosovë. Lëvizja nacionaliste pasuese e Serbis ishte gjithashtu një faktor kontribues në Luftërat Jugosllave. Statusi i Kosovës u kthye në Provincën Autonome të Kosovës dhe Metohisë para vitit 1968 me kushtetutën e re të Republikës së Serbis, e miratuar më 28 shtator 1990.⁵⁰ Më pas pasoi Lufta e Kosovës, dhe me vonë në shkurt Kosova shpalli Pavaresin e saj.⁵¹

⁴⁸ Shih Referencën 27.

⁴⁹ Fjalimi i Slobodan Milosevic, 28 Qershor 1989, gjendet tek: <http://www.slobodan-milosevic.org/spch-kosovo1989.htm>

⁵⁰ Shih Referencën 27.

⁵¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Deklarata e Pavarsis, gjendet tek: https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves-2.pdf

1.4.1. REZOLUTA 1244 E KËSHILLIT TË SIGURIMIT

Pas dështimëve të një sërë tentimesh nga faktori ndërkombëtar për ndaljen e diskriminimit, dëbimit, dhe sulmeve ushtarake ndaj popullatës civile në Kosovë që po realizohej nga Serbia, pas shpërfilljes së bisedimeve të Rambujes që synonin autonomi “substanciale” për Kosovën. Në atë situatë, më 24 Mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së, autorizoi fillimin e sulmeve ajrore në Kosovë kundër forcave Serbe.⁵² Për 78 ditë me radhë u goditën objekte ushtarake, strategjike, dhe industriale.

Për shkak të dhunës Serbe e cila përveq vrasjes dhe zhdukjes së mijëra shqiptarëve, u dëbuan nga shtëpitë e tyre rreth 1 milion shqiptarë, prej të cilëve rreth 700 mijë u vendosën në Shqipëri dhe rreth 300 mijë në Maqedonin e Veriut. Dy ditë pas autorizimit të sulmeve ajrore në Kosovë, më 26 Mars 1999, Rusia i propozoi Këshillit të Sigurimit miratimin e një projektrezolutive që konsideron sulmet e NATO-së në kundërshtim me nenet 2/4, 24, 36 dhe 51 të Kartës së OKB-së, Rezoluta nuk u miratua.

Me vendimin e 2 Qershorit 1999, GjND refuzoi kërkesën e Jugosllavis për ndalimin e sulmeve të NATO-së, si një masë e përkohshme, në bazë të nenit 41/1 të statutit të kesaj gjykate, në rastin konkret ajo nuk kishte juridiksion për gjykimin e kësaj kërkeje.⁵³ Si rezultat i sulmeve ajrore të NATO-së, më 10 qershor 1999 forcat Serbe u dorëzuan dhe të njëjtën ditë filluan të tërhiqnin trupat nga Kosova. 10 qershor 1999, në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 1244 (1999), përmes së cilës synohej “të zgjidhej situata e rëndë humanitare dhe përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë”.⁵⁴ Për këtë qëllim, në thelb, rezoluta parashikonte vendosjen e një administrate të përkohshme ndërkombëtare (UNMIK-ut), në krye të së cilës do të ishte një përfaqësues i posaqëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Kjo administratë do të krijonte dhe mbikqyrte “zhvillimin e institucioneve vetëqeverisëse dhe demokratike” në Kosovë, përfshirë këtu edhe organizimin e zgjedhjeve të lira. Parashikonte edhe largimin përfundimtar e të gjitha forcave serbe nga Kosova, si dhe ndërprerjen e çdo veprimi ushtarak nga ana e UÇK-së. Për garantimin e Rezolutës 1244 dhe të paqes, do vendosej një forcë ushtarake e NATO-së në Kosovë. Në bazë të Rezolutës 1244, kompetencat dhe përgjegjësit e UNMIK-ut do të përcaktoheshin më pas më në detaje me rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 të 15 majit 2001, të quajtur “Korniza Kushtetuese për

⁵² Whitney, R., C. (1999). NATO Authorizes Kosovo air Raids if Serbs Bar Talks. New York Times.

⁵³ Bekker, P., & Borgen, J., Ch. (1999). World Court Rejects Yugoslav Requests to Enjoin Ten NATO Members from Bombing Yugoslavia, Volume: 4 Issue: 4. American Society of International Law.

⁵⁴ Unitet Nations. (1999). 1244 Resolution of Security Council.

Vetëqeverisjen e Përkohshme”, e njohur gjithashtu si Korniza Kushtetuese”.⁵⁵

1.4.2. PLANI I MARTTI AHTISAARIT PËR STATUSIN E KOSOVËS

Në qershor të vitit 2005, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së caktoi përfaqesuesin e përhershëm të Norvegjis në NATO, Kai Eide si të dërguar të veçant të tij për të vlerësuar situatën në Kosovë. Në raportin që ai parqiti më 7 Shtator 2005,⁵⁶ rekomandonte se kishte ardhur koha për të diskutuar dhe vendosur lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës. Mendim të njëjtë kishte edhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Në një deklaratë të realizuar me 24 Tetor 2005, Presidenti i Këshillit të Sigurimit theksonte se brenda këtij organi kishte konsensus për të “... filuar procesin politik të përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës, ashtu siç parashikohet edhe në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit”.⁵⁷ Në nëntor 2005, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së caktoi ish-Presidentin Finlandez, Martti Ahtisaari, si të dërguarin e tij të veçant në procsin e përcaktimit të statusit të Kosovës. Me 2 Shkurt 2007 i njëjti paraqiti propozimin e tij lidhur me statusin e Kosovës, duke vënë në dukje gjithashtu, se “për shkak të qëndrimeve krejtësisht të kundërta, nuk mund të arrihet një marrëveshje mes palëve (Shqiptarëve të Kosovës dhe Serbëve) mbi statusin e Kosovës”. Sipas tij Kosova duhej të bëhej shtet i pavarur nën mbikëqyrjen ndërkombëtare: duhej ngritur një komision për hartimin e një projektkushtetute, e cila duhej miratuar brenda 120 ditëve nga 2/3 e Kuvendit të Këshillit të Sigurimit; mandati i UNMIK-ut duhej të mbaronte pas një periudhe tranzitore prej 120 ditëve, dhe pas kësaj kohe, “i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv që ishte nën UNMIK-un ti transferohej autoriteteve qeverisëse të Kosovës. Me 17 Nëntor 2007 u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në Kosovë, si dhe zgjedhjet për pushtetin vendor. Me 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësin. Argumenti kryesor për pavarësin e Kosovës duket se është ai se, ri-integrimi në Serbi është i pamundshëm për shkak të historisë së rajonit të spastrimit etnik dhe antagonizmit të ndërsjellë midis dy grupeve etnike, siq mbahet nga Plani i Ahtissarit dhe përkrahësit e pavarësis që flasin gjatë takimit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara pas deklaratës së njëanshme të pavarësis. ⁵⁸

⁵⁵ Stahn, C. (2001). Constitution Without a State? Kosovo Under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government. Leiden Journal of International Law.

⁵⁶ Eide, K. (2005). Report for Kosovo, UN, Security Council.

⁵⁷ UN, Security Council, 24 October 2005, Selected Security Council Presidential Statements, gjendet tek: <https://www.securitycouncilreport.org/un-documents/kosovo/>.

⁵⁸ Ahtisaari Plan, §7 ; Cf. S/PV.5839, p. 13.

1.5. KËNDVESHTRIME TË KUNDËRTA MBI HISTORINË DHE AKTUALITETIN

Gjykimi i kontestit në fjalë është i vështir dhe kompleks për tu bërë, sepse të dy këto shtete Kosova dhe Serbia argumentojn qëndrimet e tyre në mënyrë mjaft bindëse, varësisht cilës periudhë kohore i referohen. Por ajo që është me rëndësi është se ky konflikt është shekullorë dhe më i thellë se vetëm një mosmarrëveshje mbi një zonë territoriale. Serbia e cilëson Kosovën si zemrën e shtetësis dhe fesë së saj dhe vendin ku filloi ekzistencën kombi i tyre. Shum manastire mesjetare të krishtera ortodokse serbe janë në Kosovë. Nacionalistët serbë argumentimin e tyre e ngritin mbi një betejë të vitit 1389 kundër turqëve osmanë (në të cilën u mposhtën), si një simbol të luftës së tyre kombëtare mbi territorin e Kosovës, dhe përndjekjen e tyre nga ky territor.

Kombi shqiptar i shpërndar në të gjithë pjesën jugore të ballkanit, filloi të kërkojë pavarësi në fillim të shekullit të XIX. Fuqitë e Mëdha në Evropë (kryesisht Britania) donin të ruanin unitetin e perandorisë osmane, dhe më vonë u pajtuan për një Shqipëri të pavarur, por kërkuan të kufizonin kufijtë e saj, ky kufizim e la territorin e Kosoves jasht kufijeve të Shqiperisë dhe Kosova mbeti pa një status të qartë mbi situatën e saj. Kosova nuk ishte më pjesë e Shqipërisë së pavarur më 1912, dhe Serbia pikërisht me 1912 pushtoi territorin e Kosovës dhe e përfshiu atë në Jugosllavi në fund të Luftës së Parë Botërore.⁵⁹

Shqiptarët e Kosovës, të cilët janë shumicë në këtë territor që nga 1912 (periudhat e më hershme janë të vështira për tu cituar sepse nuk argumentohen në mënyrë profesionale),⁶⁰ e shohin Kosovën si vendin e tyre dhe akuzojn Serbin për okupimin, shtypjen dhe mbajtjen nën sundimin e tyre në dekadat e kaluara me dhunë të rreth 1.7000.000 shqiptareve, dhe përveq historisë ata në argumentin e tyre theksojnë dallimet kulturore etnike që ata kanë nga Serbët dhe kishin nga të gjitha etnicitetet e Jugosllavis. Ndërsa Serbët akuzojnë ndërkombëtarët për ndërhyrjen në 1999 dhe lejimin e shkëputjes së Kosovës nga Serbia, dhe historinë e lashtë të shekullit të XIII sic u theksua më lart.

⁵⁹ Eyal, J. (1999). Serbs See Kosovo as their Jerusalem. The Irish Times.

⁶⁰ Wigand, G. (1924). Ethnography of Macedonia. Leipzig.

1.5.1. MARDHËNIET NDËR-ETNIKE NDËRMJET KOSOVARËVE DHE SERBËVE

Konflikti ndëretnik në Kosovë ka qenë ekskluzivisht mbi territorin e tij ku Serbët dhe Shqiptarët kanë bërë pretendime mbi historin dhe etno-demografinë për të justifikuar të drejtën e tyre të pretenduar ekskluzive për këtë rajon etnikisht të përzier.⁶¹ Si rrjedhim, mardhëniet ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve kanë qenë mjaft problematike përgjatë shumicës së shekullit XX.

Gjatë kësaj periudhe, shqiptarët në Kosovë kanë qenë subjekt i diskriminimit, frikësimit dhe madje edhe dëbimit masiv nga autoritetet jugosllavo-serbe. Në fund të viteve 1990, këto mardhënie u përkeqësuan duke u ndikuar nga zhvillimi politikë dhe në fund eskaluan me luftën e armatosur në 1999. Mardhëniet ndëretnike në mes dy etnive vazhduan të jenë të tensionuara edhe të brishta pas Pavarësis së Kosovës. Ndryshimet dramatike të strukturës së përbërjes etnike, mizorite dhe një numër i madh i refugjatëve për shkak të luftës, kanë lënë një trashëgimi të mosbsimit të thellë dhe armiqësive në mes Shqiptarëve dhe Serbëve në gjithë rajonin dhe veqanërisht në Kosovë aty ku edhe Serbët kanë pretendime territoriale. Si pasojë, serbët në Kosovë që nga fillimi kanë refuzuar të njohin pavarësin e Kosovës dhe kanë refuzuar rigozorisht qdo qeverisje nga autoritetet e Kosovës. Komuniteti serb, veqanërisht në Veri të Kosovës, pretendon një autonomi më të forte territoriale, madje edhe separatizëm dhe bashkim me Serbin.

Mardhëniet ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve dhe veqanërisht në Kosovë, janë mbajtur dhe përcaktuar nga mardhëniet ndër-shtetërore në mes Kosovës dhe Serbis. Përmirësimet ose përkeqësimet e mardhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbis kanë ndikim të drejtpërdrejt në mardhëniet ndëretnike. Nënshkrimi i marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e mardhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbis, si pjesë e dialokut të lehtësuar nga BE, u pa si rrugëdalje historike në këtë drejtim. Megjithatë zbatimi në praktik i marrëveshjeve, veqanërisht Asociacionit / Komunitetit të Komunave Serbe, ka dëshmuar të jetë jashzakonisht i veshit. Për më tepër, mund të konkludohet se incidentet e ndërtimit të murit në veri të urës së Mitrovicës, përpjekjet e autoriteteve të Beogradit për të dërguar një tren të drejtpërdrejt nga Beogradi në Mitrovicën Veriore, i cili përmbante mesazhe nacionaliste, kanë nxitur raportet në nivele alarmante.⁶² Bazuar në këto fakte mund të konkludohet se raportet ndër-etnik varen nga raportet ndër-shtetërore, në mes Kosovës dhe Serbis.

⁶¹ Demjaha, A. (2017). Inter-Ethnic Relations in Kosovo. South East European University, Tetovo.

⁶² Shih Referencën 61.

KAPITULLI II

MITROVICA: VERIU I KOSOVËS

2.1. MITROVICA: TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Ekziston një terminologji gjeografike në rrjedhën e rëndsis së Veriut të Kosovës në kontestin Kosovë-Serbi mbi territorin e Veriut të Kosovës, dhe duke qenë Mitrovica (një qytet dy komuna)⁶³ si komuna më e madhe në Veri të Kosovës, zhvillimi i debatit bëhet mbi terminologji gjeografike dhe Veriut të Kosovës në moment të caktuara studiuësit i referohen si Mitrovicë. Mitrovica në kontekstin juridik-kushtetues ka dy komuna: Komuna e Veriut me shumicë Serbe dhe Komuna e Jugut me shumicë Shqiptare.

Pjesa Veriore e Kosovës përfshin katër komuna: Mitrovicën e Veriut, Zveçanin, Leposaviçin dhe Zubin Potokun, ajo mbulon një sipërfaqe pre 1.539 kilometra katror dhe banon rreth 40.000 qytetarë⁶⁴ kryesisht e përbërë nga popullsia etnike serbe, pasuar nga etnia shqiptare, dhe përfaqsim minimal të komuniteteve tjera.⁶⁵

Mitrovica e Veriut është komuna më e madhe me shumicë Serbe në Kosovë, e themeluar në vitin 2013 e cila është pjesë e qytetit të Mitrovicës, që ndahet nga Komuna e Mitrovicës së Jugut nga lumi Ibër (dhe ura e lumit). Ndarja e Mitrovicës në dy komuna erdhi si zgjidhje e krizës së Veriut të Kosovës, nga Plani i të dërguarit të posaqëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaarit si pjesë e decentralizimit, plan i cili u miratua nga Kuvendi i RKS dhe u zbatua në praktikë.

Fillimisht Komuna e Mitrovicës së Veriut kishte kompetenca vetëm të “Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut”,⁶⁶ pastaj me vendimin e qeverisë mori kompetencat e Komunës. Kandidatët për kryetar në katër komunat e veriut me shumicë serbe qertifikohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës,⁶⁷ dhe zgjidhen nga qytetarët në formë të njejtë të mbajtes së zgjedhjeve si në tërë territorin tjetër të RKS. Zbatimi i ligjit, duke përfshirë kohën e administrimit ndërkombëtar nga UNMIK-u dhe pas shpalljes së pavarësis së 17 Shkurtit 2008 ka qenë minimal dhe krahasuar me territorin tjetër të Kosovës vazhdon të jetë ende në nivel të ulët i zbatueshëm, duke i dhënë rrugë evazionit të gjerë të taksave dhe kontrabandës.

⁶³ UN, Martti Ahtisaari Plan for Kosovo.

⁶⁴ Kosovo Agency of Statistics. (2013). “Kosovo Population 2013”.

⁶⁵ USAID. (2006). Assessment of Economic Conditions and Possible Development Projects in Norther Kosovo.

⁶⁶ Republika e Kosovës. (2012). Kryeministri, Vendimi për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut.

⁶⁷ OSCE. (2014). Zgjedhjet për kryetar të komunes së Mitrovicës së Veriut mbahen me sukses me ndihmën e OSBE-së.

Për të filluar bashkëpunimin dhe integrimin e pjesës veriore të Kosovës, qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbis janë angazhuar në një dialog që prej Marsit 2011 i cili ndërmjetësohet nga BE (dialogu shpjegohet gjerësisht në kapitullin e pestë). Vlenë të ceket arritja më e madhe e këtij dialogu: krijimi i dy postave kufitare që kontrollohen nga të dy palët. Megjithatë, shume çështje që lidhen me kontrollin e regjimit kufitar dhe doganave mbeten të pazgjidhura.⁶⁸

Pas dakordimit të 19 Prillit 2013 për zbatimin e Planit të Ahtisaarit në të gjithë territorin e Kosovës. Kjo marrëveshje ka rezultuar në disa ndryshime serioze në terren dhe më e rëndësishmja ka hapur rrugën për organizimin e zgjedhjeve të para lokale dhe parlamentare në tërë territorin e Kosovës. Në të vërtetë, qytetarët në veri dolën për të votuar në zgjedhjet lokale të mbajtura në 3 nëntor 2013 dhe rezultati ishte një pjesëmarrje e përgjithshme prej mbi 25%. Asambletë Komunale të mëparshme dhe kryetarët e Komunave u pushuan nga puna, dhe me 11 Janar 2014 u themeluan zyrtarisht asambletë e reja dhe organet komunale në katër komunat veriore.⁶⁹

Që nga përfundimi i luftës së 1999 Veriu i Kosovës ndodhet në situatë të konfliktit të ngrirë duke nënkuptuar lëvizjen e kufizuar, sigurin dhe jo-stabilitetin që është krijuar në këtë zonë. Raporetet ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve janë minimale, spektri që i lidhë më shumë është ai i tregtis dhe ekonomisë, sepse shkollat dhe spektri tjetër kulturorë, sportiv është rrënjësisht i ndarë. Mardhëniet ndër-etnike (shpjeguar me gjerësisht në kapitullin e parë) analizuar në ndërveprimet e përditshme në mes komuniteteve mund të themi se ekziston një paqe e ngrirë në Mitrovicë.

Ushtrimi i sovranitetit në këtë territor me shumicë etnike serbe dallon nga pjesa tjetër e territorit të Kosovës në kuptimin bindjes ndaj shtetit të RKS. Siç u tha më lart, zona ndodhet në gjendje të konfliktit të ngrirë ndër-etnik dhe politikë dhe një nga indikatorët e kësaj gjendje është ngritja e strukturave paralele nga qeveria e serbis me qëllim të mosbindjes së serbëve që jetojnë në Kosovë ndaj rregullave dhe institucioneve të Kosovës. Faktori që i dallon këto dy shtete në prezencën e tyre në Veri të Kosovës është mënyra e qasjes në ushtrimin e autoritetit të tyre: Serbia nuk është prezente në mënyrë institucionale zyrtare në Veri të Kosovës – është jolegjitime nga vlerësimet ndërkombëtare, aktivitetet e saj i zhvillon përmes strukturave paralele të shtrira në këtë zonë, të cilat dirigjohen dhe financohen nga institucionet zyrtare të Beogradit, përgjatë viteve, qeveria serbe u përpoq të ruajë praninë në Veri duke siguruar udhëzime politike dhe qeverisjen e

⁶⁸ Balkan Policy Research Group. (2013). "Serbia and Kosovo: The Path to Normalization", Europe Report N°223.

⁶⁹ European Commission. (2014). Kosovo Progress Report.

administratat lokale përmes strukturave paralele të saj. Qeveria Serbe ka siguruar fonde të mëdha kryesisht përmes projekteve të zhvillimit të infrastruktures dhe vendeve të punës. Sigurimi i pavage dhe pensione, si dhe arsimit dhe kujdesit shëndetësor është financuar nga administrata e Beogradit,⁷⁰ ndërsa Kosova ushtrimin e autoritetit në Veri e bënë përmes institucioneve zyrtare shtetërore të cilat veprojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Institucionet e Kosovës, saktësisht policia, patrollon dhe ruan rendin në këtë zonë. Komisioni qendror i zgjedhjeve i RKS qertifikon kandidatët në zgjedhjet lokale dhe qendrore, dhe qytetarët Serb e pranjnë këtë rezultat, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës.⁷¹ Në institucionet e Kosovës ka multietnicitet, dhe në bazë të kushtetutës pakicat kombëtare gëzojnë trjtim të pa-cenueshem nga shumica⁷², pakicat madje kanë ulëse të rezervuara në parlamentin e RKS, 20 nga 120 uleset e Kuvendit te Kosovës janë të garantuara me Kushtetutën e vendit.⁷³ Institucionet e Kosovës për dallim nga ato të Serbis, janë legjitime nga ndërkombetarët në ushtrimin e sovranitetit në Veri të Kosovës.

⁷⁰ Balkan Policy Research Group. (2012). Setting Kosovo Free: Remaining Challenges. Europe Report N°21810.

⁷¹ Republika e Kosovës, Komuna e Mitrovicës së Veriut. (2020). gjendet tek: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëeveriut/>.

⁷² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli 3, neni 57,pika 1,2,3.

⁷³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 64, pika 1 dhe 2.

2.2 RËNDESIDIA GJEOPOLITIKE: STRATEGJIKE

Që nga ekzistimi i Jugosllavis territori i Kosovës ka qenë një “kyqje” komplekse gjeopolitike për arsye të pozitës së saj të favorshme dhe rolit të saj strategjik në zhvillimin industrial që ofronte kjo zonë. Kosova gëzon pozitë të lakmueshme gjeografike e cila i kontribon jashtzakonisht fuqisë nacionale të saj në proceset e zhvillimit social, ekonomik, dhe integruar. Duke qenë në qendër të gadishullit ballkanik, Kosova shërben si urë lidhëse mes shteteve në Evropën Juglindore.⁷⁴

Megjithëse në aspektin politik, kufijtë e tashëm (kur është duke u shkruar ky hulumtim 24.03.2020) janë rezultat i historis politike, në aspektin gjeopolitik shtrirja territoriale është mjaft e rëndësishme në trajtimet e kësaj natyre. Andaj, raporti ndër-territorial është tejet esencial për ardhmërin e një vendi dhe kombi. Në këtë kontekst, mund të themi se shprehjet se Kosova është “zemra” e ballkanit qëndron edhe ka bazë.⁷⁵ Territori i Kosovës formon një njësi gjeografike të rrethuar nga vargmale dhe kodra, por megjithatë struktura kufitare është e tillë që mbetet si urë lidhëse me fqinjët në të gjitha mënyrat. Pozita e favorshme gjeografike megjithatë nuk i shërbeu gjithnjë për favore. Pozita e përshtatshme njëkohësisht shpjegon faktin se zotërimi i këtij territori ka qenë gjithmonë i rëndësishëm dhe jetik për arsye strategjike dhe ushtarake. Pozicionimi territorial sqaron faktin se përse Kosova pati rëndësi të vazhdueshme historike në rajon,⁷⁶ dhe pretendime për tu kontrolluar nga Serbia.

Kosova gjendet në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik, në të cilin kalojnë rrugët që lidhin detin Adriatik, detin Egje dhe brendinë e Gadishullit Ballkanik. Kosova në vijë ajrore është rreth 100 km larg nga deti Adriatik.⁷⁷ Prishtina nga qendrat tjera të Gadishullit Ballkanik është larg rreth 90 km me Shkupin, rreth 120 km me Nishin, rreth 260 km me Sofien, rreth 300 km me Tiranën dhe Beogradin, dhe rreth 350 km me Selanikun,⁷⁸ dhe ndërlidhja e Prishtinës me këto qendra është e lehtë si rezultat i pozitës gjeografike.

Kosova lidhet me Serbin përmes Veriut të Kosovës ku mundësohet lidhja tjetër me Malin e Zi përmes Serbis, si dhe nga Mitrovica e Veriut për në Rozhajë, lidhjen me Shqipërinë përmes autostradës morinë-mërdar (R7, fig.1.) dhe ndërlidhjen me portet detare strategjike e ballkanit perëndimor. Kosova përmes Bujanovcit dhe Presheves del në

⁷⁴ Akademia Shqiptare e Shkencave. (2002). Historia e Popullit Shqiptarë. Tiranë.

⁷⁵ Malcolm, N. (2001). Kosovo: A Short History. Macmillan, London.

⁷⁶ Hoxhaj, E. (2008). Politika Etnike dhe Shtetëndërtimi i Kosovës. Dukagjini, Pejë.

⁷⁷ Pushka, A., & Krasniqi, N. (2007). Gjeografia. Volumi 9. Libri Shkollor, Prishtinë.

⁷⁸ Shih Referencën 77.

autostradën që e lidh Serbin me Evropën, Maqedonin dhe Greqin, në Shkup poashtu lidhet me të njëjtën autostradë e cila vazhdon për në Selanik, Athin dhe Stmboll,⁷⁹ (korridori i dhjetë i cili lidhë ballkanin me Evropën Juglindore Fig.1.)




Fig. 1. Autostada e Republikës së Kosovës: R7, Morinë-Mërdarë

Rëndësia e Veriut të Kosovës më shumë ndërlidhet me funksionimin e brendshëm të Republikës së Kosovës në kuptimin e jashtëm, pa tentuar për ti nënvlerësuar lidhjet strategjike të Kosovës që u përmendën më lart në lidhjet e saj me Serbin dhe Malin e Zi të cilat kalojnë përmes Veriut të Kosovës, roli i Veriut të Kosovës është jetikë në funksionimin dhe zhvillimin e Kosovës, për arsye të pasurive ujore dhe miera që ndodhen në atë zonë dhe ndërlidhja që kanë ato pasuri me funksionimin e shtetit të Kosovës, siç do të shtjellohet në vazhdim.

⁷⁹ Anamali, S., & Prifti, K. (2002). Historia e Popullit Shqiptar. Botimet Toena, Tiranë.

2.3. VLERA E TERRITORIT TË DISKUTUAR: VERIUT TË KOSOVËS

Mosmarrëveshjet territoriale janë të prirura për konflikte për shkak të vlerës së territorit për publikun, qoft për shkak të vlerës strategjike dhe material, apo vlerës së tij jo-materiale, simbolike. Megjithatë, pavarësisht nga implikimet e dallimit si për teorinë ashtu edhe për politikë, duke disatanguar empirikisht materialin nga simbolik ka paraqitur sfida të medha metodologjike.

Duke u bazuar në rastin e Izraelit / Palestinës, zbulojmë se një segmenti i konsiderueshëm i popullësis hebraike është bashkangjitur në territorin e diskutueshëm të Bregut Perëndimor për arsye jo-materiale, por simbolike dhe kulturore. Territori është i vlefshëm për shkak të shoqërimit të tij me një sërë përfitimesh material, nga rëndësia strategjike⁸⁰ deri tek burimet ekonomike.

Qasja racionaliste nuk thërret drejtpërdrejt mekanizmat e brendshëm, por ka implikime për opinionin publik, të paktën në mjediset demokratike ku prefencat e politikës së publikut paraqesin një pengesë të rëndësishme në hapsirën e pazareve të lidereve. Kështu, vlerësimi i territorit të individëve rrjedh nga krahasimi i përfitimeve neto të pritura nga kontrolli territorial. Kur vlerësojmë kostot dhe përfitimet e kontrollit territorial në krahasim me ato të koncesioneve, votuesit përfshijn shqetësime në lidhje me aftësit e rivalit për tu angazhuar në mënyrë të besueshme për një marrëveshje.⁸¹

Rëndësia gjeopolitike e Veriut të Kosovës nuk qëndron vetëm në aspektin territorial – gjeografik dhe historik, por edhe në potencialin e madh human dhe resurset natyrore që ky territorë gëzon. Sipërfaqja e Veriut edhe pse është jo e madhe, kjo hapsirë është e pasur me pasuri natyrore (ari, argjend, hekur, pyje dhe ujë), si dhe klimë të përshtatshme, kontinentale dhe mesdhetare. Studimi në këtë tezë përfshin një vlerësim të shkurtër të vlerës së territorit të veriut të Kosovës ose katër komunave të veriut: Mitroviës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviçit. Vlerësimi do të bëhet në katër lloje të vlerës: ekonomike, simbolike, precendeciale dhe strategjike.

Megjithëse disa nga të dhënat janë të pa përditësuara në dy dekadat e fundit, për arsye të situatës jo-stabile në të cilën ndodhet kjo zonë, dhe pasivizimit të ndërmarrjeve të cilat ndodhen në atë zonë, një njohje themelore e vlerës së territorit është thelbësor për të hulumtuar motivet e dy shteteve të përfshira dhe ndihmon për të shpjeguar pse shtetet përdorin lloje të caktuara të ushtrimeve të sovranitetit, ose punojnë shumë për të parandaluar ushtrimin e sovranitetit nga pala tjetër, në secilën sferë të ushtrimit të

⁸⁰ Carter, D. (2010). The Strategy of Territorial Conflict. American Journal of Political Science.

⁸¹ Ky proces është pjesërisht endogjen, pasi që vetë liderët kontribojnë në disa raste në shqetësimet e publikut përmes mesazheve mbi rreziqet e tradhëtis nga rivali.

sovrانيتetit. Veriu i Kosovës është i pasur me burime minerale, male dhe sasi të madhe të ujit: kryesisht i njohur për kompleksin e minierave të Trepqës. (Fig.2, Gig3Zveqani, Akumulatorska), pasuri malore: maja e Kopaonikut me lartësi 1770 metra dhe ujore: liqeni i Ujmanit me sipërfaqe prej 11.9 km prej të cilave 9.2 km ndodhen në territorin e Kosovës dhe 2.7 km në teritorin e Serbis.⁸²

Që nga ish-jugosllavia Veriu i Kosovës ka qenë një nga zonat më të pasura në sferën e pasurive nëntokësore, natyrore. Veriu i Kosovës ka një sipërfaqe prej 1.002km²: Komuna e Leposaviçit 539.05 km², Zubin Potoku 334.38 km², Zvecani 123,01 km², dhe Mitrovica e Veriore 1.002 km². Minierat në këtë zonë ende kanë rezerva prej 60.5 milion tonë xehe duke e ndarë në: 4.96% plumb, 3.3% zink dhe 74.4 gr ton argjend, që përkthehet si tre million tonë plumb, dy million tonë zink dhe 4500 tonë argjend.⁸³ Përveq pasurive mierare dhe ujore vlerën dhe dëshirën për ta kontrolluar këtë zonë nga këto dy vende e rrit vlera simbolike e shteteve për këtë territor. Qeveria serbe e konsideron Kosovën dhe Veriun e Kosovës si “zemrën” e Serbis, duke argumentuar pretendimet e tyre mbi ngritjen e shtetit Serb dhe religjionit katolik ortodoks në territorin të quajtur sot Republika e Kosovës, dhe mbi një luftë të zhvilluar në vitin 1389 ndaj perandorisë osmane të cilën serbët



Fig.2. Fabrika e Akumlatorëve në Mitrovice, ishte aktive gjate Jugosllavisë.

e cilësojnë si të humbur dhe pikërisht asaj kohe i referohen për humbjen e kontrollit jo vetëm në veri por në tërë Kosovën. Ndërsa Kosovarët argumentin e tyre e ngritin qysh në kohën parahistorike në kohën e ilireve kur Kosova quhej Dardani.

⁸² Warrander, G., & Knaus, V. (2010). Kosovo: Bradt Travel Guides, England.

⁸³ Feraud, J. (2013). The Trepca Mine. gjindet tek:

http://www.spathfluor.com/open/open_us/us_op_mines/us_trepca_kosovo_mine.htm

2.3.1 VLERA EKONOMIKE

Vlera ekonomike e pasurive natyrore të Veriut të Kosovës është veqanërisht në burime minerale, e kryesuar nga Minierat e Trepqës dhe nëndeget e saj, të cilat jo të gjitha janë në funksion, por edhe ato që janë në funksion nuk janë në situatë të mirë. Vlerësimi i këtyre burimeve do të vlerësohet duke i'u referuar kapaciteteve të tyre maksimale gjatë kohës kur kanë qenë aktive, të bazuara në arkiva nga ishjugosllavia dhe statistikave të qertifikuara nga institute apo organizata të ndryshme. Dy pasuritë më të mëdha të Veriut të Kosovës janë Minierat e Trepqës dhe Liqeni i Ujmanit.

Miniera e Trepqës ishte miniera më e madhe e zikut, plumbit dhe argjendit në Evropë.⁸⁴ Në vitin 1985, Trepça ishte struktura e parë në Evropë dhe e pesta më e madhe në botë e shkrirjes së plumbit të papërpunuar dhe një nga më të mëdhenjtë në përpunimin e zinkut. Kapaciteti prodhues përfshinte: 3.5 milion tonë xehe, 165.000 tonë plumb të papërpunuar, 110.000 tonë plumb të rafinuar, 40.000 tonë zink elektrolitik, 100 tonë argjend të imët, 100 tonë bismuth të rafinuar, 72 tonë cadmium, 200 kg ari. 20.000 tonë bateri plumbi, 280.000 tonë plehra të përbërë. Prodhoi mbi 80% të plumbit të rafinuar dhe mbi 50% të zinkut të rafinuar në Jugosllavi.⁸⁶

Në kulmin e saj, Trepça jo vetëm që operonte minierat kryesore të Kosovës, por edhe qdo vend në Jugosllavi. Trepça kishte 21 njësi me rreth 23.000 të punësuar ose rreth 10% të punsimit të përgjithshëm në sektorin social në Kosovë.⁸⁷ Përveq kapaciteteve të shkrirjes dhe rafinimit për të përpunuar zinkun, plumbin, argjendin dhe arin, në fillim të viteve 1970, Trepça filloj të krijojë dhe të sigurojë operime të ndryshme në industri, siç janë: prodhimi i baterive (fig.x.), bojra dhe llak, municione, stoli, dhe galvanizim.

Zhvillimi i industris në Mitrovicë në krye me Trepçën, pati ndikim të madhë edhe për Mitrovicën, në vetëm një periudhë regjistrimi prej 10 vjetësh, nga 1961 deri në 1971, qyteti u rrit me 57,7% (26.721 në 42,126).⁸⁸ Liqeni i Ujmanit ka një sipërfaqe prej 11.9km² nga të cilat 9.2 km² ndodhen në territorin e Kosovës dhe 2.7km² në territorin e Serbis, thellësia e tij maksimale është 105 metra dhe ka një sasi rreth 350 milion kub ujë, që nënkupton sasi më të madhe të ujit se të gjitha liqenet e Kosovës së bashku. Liqeni i Ujmanit luan rol kyq në prodhimin e energjis elektrike në Kosovë, sepse me ujin që rrjedh nga ujmani mundësohet

⁸⁴ Milisic, M. (2005). Libri i Popullit, Enciklopedia Britanica. Beograd. (Përkthyer nga Sebishtja).

⁸⁵ Bihalji-Merin, O. (1986). Enciklopedia e Vogël e Iluminizmit. Beograd. (Përkthyer nga Serbishtja).

⁸⁶ Shih Referencën 84.

⁸⁷ Osbild, R., & Bartlett, W. (2011). Western Balkan Economies in Transition: Recent Economic and Social Developments. Springer. Prishtinë.

⁸⁸ Sentija, J. (1978). Enciklopedia e Përgjithshme e Institutit Leksikografik Jugosllav. Miroslav Krleza Institute of Lexicography.

ftohja – menaxhimi i temperaturës së turbinave të termocentraleve të Korporatës Energjitike së Kosovës në Obilic, dhe ndalimi i ftohjes së turbinave të termocentralit të Obilicit nënkupton mosfunksionimin e KEK-ut që është prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në Kosovë me rreth 97% të prodhimit të energjisë.⁸⁹

Fabrika e Ferronikelit furnizohet drejtpërdrejt me ujë nga ujmani dhe njësoj si rasti i KEK-ut, furnizimi me ujë nga ujmani është jetike në funksionimin e kësaj ndërmarrje. Ujmani gjithashtu ka edhe hidrocentralin e tij – hidrocentrali i Ujmanit i cili gjeneron 35 MW energji për orë. Përdoret gjithashtu për furnizim me ujë të Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut, Skenderajit, Drenasit dhe një pjesë të Prishtinës, dhe ujitjen e gjashtë Komunave (Zubin Potokut, Mitrovicës së Veriut, Mitrovicës së Jugut, Vushtrris, Obilicit dhe Prishtinës. Liqeni i Ujmanit në rast të thatësive apo mungesës së shiut, përdoret për mbushjen e dy liqeneve të Kosovës: Batllaves dhe Badovcit. Liqeni i Ujmanit menaxhohet nga ndërmarrja hidroekonomike Ibër Lepenc, me seli në Prishtinë, nën urdhrat e Qeverisë së Kosovës. Ndërkohë në Zubin Potok ka një ndërmarrje e cila quhet “Ibar” që është themeluar në vitin 2002 dhe institucionet e konsiderojnë si të paligjshme. Prodhimi i ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike për Kosovën varet drejtpërdrejt nga ujmani i cili është jetik për zhvillim industrial dhe ekonomik të Kosovës.

⁸⁹ Banka Boterore. (2014). Projekti Energjetik i Kosovës.

2.3.2 VLERA SIMBOLIKE

Me përkufizimin e qasjes racionaliste në mosmarrëveshjet territoriale, ose duhet të injorohen plotësisht roli i identitetit kombëtar dhe vlera simbolike e territorit, ose duhet vetëm të bëhen përpjekje për ti vlerësuar ato. Përpjekjet për të kodifikuar vlerën simbolike ose indentitetin kombëtar e anashkalojnë faktin se territori kërkon që një histori e gjatë e popullësis të jetë me vlerë simbolike.

Në fakt, vlera simbolike e një territori është e pamundur të përcaktohet, por kuantifikimi i tij në qasjen e konfliktit territorial është një pasojë e pashmangshme e zbatimit të një teorie të thjesht racionaliste. Studiuesit e vlerësojnë rëndësinë e vlerës simbolike të territorit, por rezultati i një cilësimi të tillë është një konkluzion i tillë si “luftërat ndërshtetërore janë 13 herë më të prira mbi territoret me karakteristika të paqëndrueshme (vlera simbolike).”⁹⁰ Ky përkufizim na tregon se vlera simbolike e territorit është e rëndësishme, megjithëse shumë pak studiues të MN do të argumentonin me këtë propozim të dhënë në ngjarjet në Kosovë, dhe Izrael/Palestine.

Ky lloj kodifikimi i indentitetit kombëtar dhe vlerës simbolike është dënuar që nga fillimi; natyra diskrete e mosmarrëveshjeve territoriale dhe natyra thelbësore e pakualifikueshme e emocionit njerëzor tregojnë që ky është shembull i qartë.

Ashtu si e vlerësojnë edhe kritikët aspektin simbolik në qasjen e mardhënieve ndërkombëtare, vlera simbolike është shumë e vështirë për t’u matur, dhe është përtej fushëveprimit të kësaj teze të propozojë një mënyrë teorikisht të sofistikuar të matjes të një vlere të tillë, kështu që përkundrazi, do të përdoret një procedure mjaft e “pazhvilluar” e pasakt por metodologjikisht efikase, duke u mbështetur në konceptin e identitetit kombëtar,⁹¹ dhe procesin e fiksimit (ngulitja, koha e krijimit të lidhjes së popullit me token). Smith argumenton se ekzistojnë pesë karakteristika të identitetit kombëtar, e para prej të cilave është “territori historik”.

Territori historik nuk është thjeshtë tokë fizike, por një “vend me kujtime dhe lëvizje kombëtare”.⁹² Vlera simbolike nënkupton investimet nacionaliste, fetare, etnike ose vlera emocionale. Për më tepër, arsimi ose propaganda përdoren për të forcuar bindjen ndaj territorit si tokë kombëtare e brendshme dhe e shenjtë. Kështu duke ndërthurur konceptet e atdheut kombëtar me procesin e fiksimit dhe duke përdorur hulumtimet ekzistuese mbi aspektet simbolike të mosmarrëveshjeve, kjo tezë do të ofrojë një vlerësim të vlerës simbolike të territorit të diskutueshëm dhe ndikimit të tyre në këtë mosmarrëveshje

⁹⁰ Hensel, P., & Mitchell, S. (2011). *Issues and Conflict*, Jacobsen. Nova Science Publishers, New York.

⁹¹ Smith, D., A. (1991). *National Identity*. University of Nevada Press, Nevada.

⁹² Shih Referencën 91.

ndërmjet dy shteteve: Kosovës dhe Serbis. Newman ⁹³ argumenton se lidhja me territorin është një element thelbësor në formimin e identitetit grupor, i formuar përmes një procesi historik që lidhë tokën me kuptimin mitik ose fetar. Pavarësisht nëse burimi i lidhjes territoriale është gjenetike, parësorë ose e konstruktuar, nocioni kryesor që theksohen teoritë e paprekshmëris është se konfliktet territoriale nuk janë kryesisht për shkak të vlerës së brendshme të territorit të diskutueshëm. Përkundrazi, është një vlerë simbolike që i bënë territoret të diskutueshme në mënyrë të pandashme.⁹⁴⁹⁵ Qasja simbolike e shikon lidhjen territoriale si të paprekshme. Paprekshmëria nënkupton tërheqjen për vlera emocionale, ideologjike ose simbolike, mund të konsiderohet si konstruksion i dobishëm teorik vetëm në atë masë sa që preferencat politike nuk mund të shpjegohen duke iu referuar përfitimeve materiale ose të sigurisë. Kështu, implikimet thelbësore të kësaj qasje janë që publiku ose shteti është i gatshëm të bartë shpenzime të konsiderueshme materiale për të mbajtur kontrollin mbi territorin. Thënë ndryshe, lidhja jo-materiale e popullit me tokën operacionalizohet si mbështetje për kontrollin e territorit edhe kur ndikon negativisht në mirëqenien materiale ose sigurinë e tyre. Pala Serbe argumentin e saj e ngrit mbi kishat ortodokse dhe kalanë e Zveçanit (Fig.4. të cilën studiuesit Serb e cilësojnë si një nga më të vjetrat mesjetare të Ballkanit, megjithëse data e sakt e ndërtimit të saj nuk dihet. Poashtu pala kosovare argumentimin e saj e ngrit qysh në periudhën e ilireve kur Kosova quhej Mbretëria e Dardanisë, dhe mbi dallimet rrënjësore kulturore religjioze që kanë shqiptarët e Kosovës me subjektet tjera të ish-Jugosllavis, dhe veqanërisht me etnin Serbe, të cilën e akuzojnë se përmes dhunës dhe forcës i ka mbajtur Kosovarët të dirigjuar dhe nën kontroll të plotë, përkundër vullnetit dhe sakrificës së tyre shekullore.



Fig.3. Gernadhat e Kishës Mesjetare Ortodokse në Stantërg, Fig.4. Kalaja Mesjetare e Zveçanit

⁹³ Newman, D. (1999). Real Spaces, Symbolic spaces: Interrelated Notions of Territory in the Arab-Islamic Conflict. Nashville, Vanderbilt University Press.

⁹⁴ Vasquez, J. (1993). The War Puzzle. Cambridge University Press, Cambridge.

⁹⁵ Goddard, S. (2006). Uncommon Ground: Indivisible Territorial and the Politics of Legitimacy. Cambridge University Press, Cambridge.

Për të vlerësuar preferencat e qytetarëve të dy etnive në lidhje me rëndësinë e vlerës materiale apo simbolike për të kontrolluar territorin, është realizuar sondazh në internet. FigXX. Në sondazhin e zhvilluar online në një mostër të anketuarve prej 3510 personave (të rritur) të etnisë Shqiptare dhe Serbe të cilët banojnë në territorin e Kosovës. Sondazhet u administruan në dy valë: e para përfshinte një mostër të të anketuarve prej 1755 personave të moshës të etnisë serbe, dhe vala e dytë përfshinte një mostër prej 1755 personash të moshës të etnisë shqiptare. Statistikat përmbledhëse të dy mostrave, të cilat janë shtresuar sipas: etnisë, raportohen në infomacionin plotësues. Të dy valët e sondazhit u zhvilluan në mjedis kontekstualisht të qetë të raporteve politike, ku nuk kishte bisedime aktive të zyrtarëve mes dy vendeve. Arritjet e sondazhit janë paraqitur në tabelën. 5.

Anketa është zhvilluar në një platform online, në gjuhën angleze, dhe të gjithë të anketuarit në tekstin hyrës të anketës janë informuar se qka nënkupton vlera ekonomike dhe simbolike e një territori. Të dhënat janë paraqitur në tabelën 1 në vijim të hulumtimit. Përshkrimi i të dhënave është bërë në gjuhën shqipe, ndërsa zhvillimi i anketës është bërë në gjuhën angleze.

TABELA 1: TË DHËNA MBI TË ANKETUARIT

NUMRI I PJËSMARRËSVE	NDARJA NË ETNI	NACIONALITET	MOSHA
3510	1755	SHQIPËTAR	18 - PA LIMIT
	1755	SERB	




Figura. 5.: Rezultatet në përqindje të pyetjes së lartë-cekur

Figura 1 Etnia Serbe: -tregon që (92% - 1611) janë përgjigjur se vlera simbolike ka rëndësi më të madhe, ndërsa vetëm (8% - 144) janë përgjigjur se vlera ekonomike ka rëndësi më të madhe.



Figura. 5.: Rezultatet në përqindje të pyetjes së lartë-cekur

Figura 2 Etnia Shqiptare: tregon që (26% - 433) janë përgjigjur se vlera simbolike ka rëndësi më të madhe, ndërsa (75% - 1322) janë përgjigjur që vlera ekonomike ka rëndësi më të madhe.

KAPITULI III

SOVRANITETI

3.1. KUPTIMI I SOVRANITETIT

Kur ne mendojm për MN, ne kryesisht mendojm për sistemin e sovranitetit shtetëror. Ekzistojnë dy pjesë për këtë sistem, sovraniteti i brendshëm dhe sovraniteti i jashtëm. Sovraniteti i brendshëm i referohet autonomisë, aftësis së shtetit për të bërë dhe zbatuar rregullat e veta brenda vendit. Sovraniteti i jashtëm i referohet njohjes së shtetit nga shtetet e tjera, pranimi të shtetit nga bashkësia ndërkombëtare.⁹⁶ Shtetet nuk kanë domosdoshmërisht nivele të barabarta të dy llojeve të sovranitetit. Për shembull, Tajvani ka një nivel të sovranitetit të brendshëm që është i barabart me atë të shumë vendeve të tjera të industrializuara. Por ai nuk ka sovranitet të plot të jashtëm, dhe si rezultat nuk mund të marrë pjesë në shumë aktivitete të KB që çojnë në krijimin e rregullave ndërkombëtare. Në të kundërt, Republika Demokratike e Kongos ka sovranitet të plot të jashtëm, dhe mund të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet ndërkombëtare. Por ka sovranitet të kufizuar të brendshëm, sepse nuk ka kontroll mbi atë që ndodh në pjesën më të madhe të territorit të saj.⁹⁷ Sistemi shtetëror sovran jo gjithmonë ka qenë tipi organizativ qendror i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Perandoritë, më shumë sesa shtet sovranë, shkruanin pjesën më të madhe të historisë politike të civilizimeve antike, dhe epoka feudale në Evropë shfaqte modele të mbingarkesës dhe territorit të padallueshëm të autoritetit politik. Zanafilla e sistemit aktual të shteteve shpesh është datuar që nga viti 1648, kur paqja e Westfalit i dha fund luftës tridhjetë vjeçare duke reduktuar rolin politik të shumë niveleve të fisnikrisë feudale. Ndërsa kjo është një thjeshtësim i historisë, shumë nga sistemi i shteteve sovranë siç e dimë u shfaqën në Evropën e shekullit të shtatëmbëdhjetë.⁹⁸

Sidoqoft, një tipar i rëndësishëm i sovranitetit ndryshoi rrënjësisht në shekullin XIX. Në shekujt XVII dhe XVIII, princat ishin sovranë. Nga këndvështrimi i bashkësis ndërkombëtare, një vend ishte pronë e sundimitarit të tij, dhe pa marrë parasysh bashkësin ndërkombëtare, një vend ishte pronë e sundimitarit të tij sesa e popullsisë. Duke filluar nga shekulli XIX, dhe akoma më shumë në të njetat, qytetarët u bënë sovranë.

⁹⁶ Thompson, E., J. (1995) State Sovereignty in International Relations: Bridging the Gap between Theory and Empirical Research. The International Studies Association.

⁹⁷ Jackson, R. (1990). Quasi-States: International Relations, and the Third World. Cambridge University Press, Cambridge..

⁹⁸ Barkin, J., S. (2006). International Organization: Theories and Institutions. Macmillan, New York.

Rregullat u bënë përfaqësuese të popullatës me shumë se të sundimtarëve.⁹⁹ Shumica e përkufizimeve dhe përshkrimeve të sovranitetit theksojnë rolin e njohjes – siç thotë Thompson, “Sovraniteti nuk është një atribut i shtetit, por i atribuohet shtetit nga shtetet e tjera”. Njohja siguron legjitimitet dhe legjitimiteti do të thotë që shtetet e tjera do të veprojnë për të konfirmuar veprimet e shtetit sovran mbi territorin e tij të njohur. Por ky është një aspekt problematik i sovranitetit: nga njëra anë sovraniteti rrjedhë nga njohja e shteteve të tjera: por nga një këndvështrim tjetër, shtetet mund të ushtrojnë sovranitet pa njohjen e shteteve të tjera. Ai përdor shembullin e kontrollit që Bashkimi Sovjetik gëzoi mbi Baltikun për pjesën më të mirë të pesëdhjet viteve: mungesa e njohjes nuk pati efekt në praktikë pasi BRSS “kishte aftësinë fizike për të mbrojtur pretendimet e tij për sovranitet përkundër shteteve të tjera ‘refuzimi për ta njohur atë’”¹⁰⁰

Në terma të mosmarrëveshjeve territoriale, këto dy aspekte janë thelbësore. Autoriteti është aftësia për të ushtruar sovranitetin mbi territorin ose për të parandaluar një shtet tjetër ta bëjë këtë. Njohja dhe Autoriteti janë dy aspekte kryesore se si ekziston sovraniteti, por ekziston një kërkesë përfundimtare për sovranitetin, e cila tashmë është përvetësuar, dhe ai është territori. Koncepti i sovranitetit është i lidhur rrënjësisht me “rizbulimin e ligjit Romak të pronave private në shekullin e gjashtëmbëshjetë (XVI)”. Nën feudalizmin, territori ishte objekt i pretendimeve të mbivendosura dhe hierarkive të titujve; titulli për një pjesë toke nuk i jepte pronarit të drejta ekskluzive.

Siç e shpjegon Ben Holland, përmes një kuptimi të sovranitetit që buronte nga prona private Romake, “u vendos që autoriteti i fundit të ushtrohej në zona të ndërsjella ekskluzive”. Pasi ky kuptim i territorit erdhi në shprehje, ai historikisht është trajtuar si pronë e cila mund të blihet, shitet dhe bartet.¹⁰¹

⁹⁹ Barkin, J., S. (1998). The Evolution of the Constitution of Sovereignty and the Emergence of Human Rights Norms. Millennium 27. New York.

¹⁰⁰ Një shembull i një shteti që ekziston për dekada në mungesë të njohjes së shumicës së shteteve është Tajvani. Edhe pse Tajvani nuk gëzon njohje ndërkombëtare, njohja joformale nga (dhe mbështetja nga) SHBA i ka mundësuar asaj të vazhdojë ekzitencën e tij përkundër fqinjit të tij më të madh që ka pretendime territoriale mbi atë territory, Kina.

¹⁰¹ Blerja e famshme e Luzianës ku Franca – pa asnjë pengesë ose detyrim të jashtëm, shiti një pjesë të madhe të Amerikës Veriore kontinentale të SHBA-të në fillim të Shekullit XIX.

3.2 NJOHJA NDËRKOMBËTARE

Siç është argumentuar në të kaluarën, njohja ndërkombëtare është themeli i shtetit sovran si në politikë, ligj, dhe në mosmarrëveshjet territoriale, ashtu si në rastin e ekzistences së një shteti, njohja ka rëndësi. Por, megjithë barazinë sovrane të shteteve në sytë e ligjit, në praktikën politike sovraniteti nuk vjen nga asnjë njohje: janë fuqitë e mëdha dhe rajonale ata që përcaktojnë nëse një shtet është shtet sovran apo jo, si dhe kush gëzon sovranitet legjitim mbi një territor të diskutueshëm.

Historia na ka mësuar se në mosmarrëveshjet ndërshtetërore territoriale është pak me rëndësi se qfar mendojnë shtetet e vogla për situatën e caktuar, pasi shtetet e mëdha janë ata që kufizojnë fushën e veprimit. Rasti i Çekosllovakisë në vitin 1938 kur Italia, Franca dhe Britania e Madhe ranë dakord që Sudetenland, territor i Çekosllovakisë që kufizohet me Gjermaninë, i cili kishte shumicë gjermane, ti dorëzohej Gjermanisë.¹⁰² Shembull me i fundit dhe më i rëndësishëm që është edhe pjesë e qëllimit të këtij hulumtimi është rasti i Kosovës. Kosova u bë anëtare e botës së shteteve në vitin 2008 kur shpalli pavarësinë: e cila njihet nga 116 shtete (13.03.2020),¹⁰³ përfshirë të gjitha shtetet e rëndësishme të BE (përveq Spanjës) dhe të gjitha shtetet më të cilat kufizohet Kosova përveq Serbisë. Rusia, Kina dhe 105 shtete antare të KB nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Por Kosova ekziston sepse shtetet e mëdha dhe rajonale e njohin atë.¹⁰⁴

Kjo nënkupton se njohja ndërkombëtare ka rëndësi të qartë: pa njohjen ndërkombëtare të sovranitetit mbi një territor të caktuar, sovraniteti mbetet i pakompletuar. Kështu arritja e njohjes ndërkombëtare të një pretendimi të sovranitetit mbi një territor është pjesë e rëndësishme e lojës së sovranitetit. Megjithatë, sic u shtjellua më lart, njohja është vetëm një përbërës i sovranitetit: i dyti është autoriteti. Të arrish njohjen e një pretendimi të sovranitetit nga shumica e shteteve në të vërtetë nuk nënkupton se shteti gëzon sovranitet të plot mbi territorin e diskutueshëm. Në fakt, nëse territori ka qenë i okupuar nga një shtet tjetër për një periudhë të gjatë kohore, bashkësia ndërkombëtare mund edhe gradualisht të pranojë kryesisht e okupimit, edhe nëse fillimisht pushtimi ka qenë i panjohur. Kjo nuk do të thotë që njohja ndërkombëtare nuk është e rëndësishme, përkundrazi, implikimet e mungesës së njohjes mund të jenë të vështira për t'u konstatuar dhe janë të varura nga

¹⁰² Pakti I Munihut, 29 Shtator 1938.

¹⁰³ Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, gjindet tek: <http://mpi.spinagency.com/al/politika/484/lista-e-njohjeve/484>

¹⁰⁴ Nëse asnjë nga shtetet me të cilat kufizohet Kosova nuk do e njihje atë, dhe nëse asnjë prej shteteve me potencial politik, ushtarak, dhe ekonomik të madh nuk do e njihnin atë, nëse 116 shtetet që e njohin Kosovën të ishin nga Oqeania, Afrika dhe Azia qendrore, ne mund të konkludonim se Kosova nuk do të ekzistonte në formë Juridike ose Politike.

konteksti. Në disa raste, njohja mund të rezultojë në ndërhyrje ushtarake (Kuvajt), ose bojkotim (Izrael), shtetet thjesht nuk marrin asnjë pozicion në lidhje me sovranitetin e territorit, dhe shmangin qdo veprim i cili njeh sovranitetin e ndonjë shteti. Kjo mungesë njohjeje mund të shkaktoj problem për shtetin okupues: dhe ato shtete të cilat nuk marrin një qëndrim mbi sovranitetin mund të jenë në mëdyshje të bashkëpunojnë me shtetin okupues në qdo veprim që mund të hihet si akt i njohjes së sovranitetit, siq është kërkimi i përbashket i burimeve në territor ose investimi në projekte ose biznese në lidhje me territorin. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e njohjes ndërkombëtare dhe natyra e diskutueshme e teritorit mund të bëjë që aktorët privatë të hezitojnë të përfshihen në aktivitete ekonomike në lidhje me territorin.

Në analizën përfundimtare siç tregoi diskutimi i sovranitetit në tekstin më lart, të gjitha shtetet sovrane njohin vlerën themelore të sovranitetit, ekzistencën e tyre sovrane si shtete dhe sovranitetin e tyre territorial. Mungesa e njohjes ndërkombëtare e bënë atë sovranitet të pakompletuar, dhe kështu edhe nëse kostot e drejtpërdrejta materiale të atij sovraniteti të paplote nuk janë të dukshme, kjo nuk zvoglon dëshirën e shtetit për sovranitet të plot, njohja ndërkombëtare nga ato shtete që kanë rëndësi, mbi të gjithë territorin e tij të pretenduar sovran.

3.3. AUTORITETI: USHTRIMI EFEKTIV I SOVRANITETIT

Siç kemi parë më lart, njohja e sovranitetit është e rëndësishme, por ajo përfaqson vetëm një aspekt të sovranitetit, dhe madje edhe nëse një shtet gëzon njohje ndërkombëtare të sovranitetit të tij mbi një territor, kjo nuk do të thotë se gëzon zbatimin e drejtpërdrejt aktual të këtij sovraniteti. Kjo na qon në gjysmën tjetër të sovranitetit: autoritetin.

Aftësia për të ushtruar autoritetin mbi një territor të diskutueshëm është në thelb aftësia për të ushtruar sovranitet mbi të. Ushtrimi i sovranitetit formon bazën e parimit juridik të kontrollit efektiv, i cili në mungesë të një traktati autorizues, është parimi kryesor në juridiksionin e së drejtës ndërkombëtare. Padyshim në mungesë të arbitrazhit, ushtrimi i sovranitetit ushtron autoritet: është në fuqi duke kontrolluar territorin, edhe nëse sovraniteti mbetet ligjrisht i pakompletuar.

Kështu, një pjesë thelbësore e lojës së sovranitetit është aftësia për të ushtruar sovranitet mbi territorin e diskutueshëm, dhe si rrjedhim i kësaj: aftësia për të parandaluar të tjerët të ushtrojnë sovranitet. Por para se të kalojmë më tej në mënyrat në të cilat shtet vendosin ushtrimin e sovranitetit, dhe parandalimin e tyre për të qar më tej pozicionin e tyre në lojën e sovranitetit, së pari duhet përshkruar se qfarë është në të vertet ushtrimi i sovranitetit dhe ta bëjmë atë posaqëishtë me një kuptim të ushtrimeve të sovraniteti mbi territoret e diskutuara në shtetet e ndara me vetëvendosje. Përkufizimi zyrtar ligjor i ushtrimit të sovranitetit është me i ngushtë se ai ligjor, për shembull, në juridiksionin e GJND-së, hartat nuk mund të tregojnë titullin territorial, përveq nëse ato janë bashkangjitur në një tekst zyrtar, i cili është shprehje e vullnetit të shtetit ose shteteve të përfshira.¹⁰⁵ Megjithatë, siç është sqaruar më lart: loja e sovranitetit përbëhet nga ligji dhe politika, prandaj shtetet veprojnë në mënyra që nuk janë strikte “ligjore”, por që janë të informuar me ligj.

Ushtrimi i sovranitetit që është me rëndësi për këtë tezë është konkretisht ai që ka të bëjë me territoret e diskutueshme. Ato përfshijnë çdo veprim shtetëror, i cili i referohet territorit të diskutueshëm, dhe varësisht nga konteksti, mund të preken jo vetëm nga shteti në kuptimin tradicional (që do të thote jo vetëm nga qeveria qendrore), por edhe nga nën-shtetet, të cilët mund të përfshijnë qytetarë, grupe private dhe qeveri nën-shtetërore.¹⁰⁶

Ushtrimi i sovranitetit në lojën e sovranitetit bëhet kur të dy palët e njohin atë si të tillë, dhe kështu një provë e thjeshtë nëse veprimi i një shteti apo një trupi tjetër është një ushtrim i sovranitetit apo jo, është nëse shteti tjetër paraqet një protestë në përgjigje.

¹⁰⁵ Perscott, V., & Triggs, D., G. (2008), *International Frontiers and Boundaries*. Leiden, The Netherlands Brill.

¹⁰⁶ Këto ushtrime të sovranitetit janë dukshëm më të dobëta në natyrë sesa ushtrimet e drejtpërdrejta shtetërore.

Natyrisht jo të gjitha ushtrimet e sovranitetit mbajnë të njejtën peshë. Shkalla në të cilën ushtrimi i sovranitetit bën një ndryshim në lojën e sovranitetit është vetë pjesë e lojës. Disa shembuj të ushtrimeve të sovranitetit në lidhje me këtë tezë:

Ndertimi i infrastrukturës shtetërore në territorin e diskutueshem,
Deklaratat e qeverisë që shpallin sovranitetin mbi territorin e diskutueshëm,
Ushtrimi i juridiksionit penal mbi territorin.¹⁰⁷

Siç u tha më lart, një nga mënyrat se si mund të njihet ushtrimi i sovranitetit është përgjigjja ndaj tij: a protestojnë apo pranojnë pretenduesit e palës tjetër. Për të paraqitur protestë ligjore, një shtet thjesht duhet të paraqesë një protestë zyrtare. Sidoqoftë, shtrirja e protestës politike na qon te qështja kritike e efektit të ushtrimit të sovranitetit, dhe aftësisë së secilit shtet për të ushtruar sovranitet dhe për të parandaluar ushtrimin e sovranitetit nga shteti tjetër pretendues: mardhënia në mes ushtrimit të sovranitetit, protestës ose pranimi, dhe pozicionit të secilit shtet në lojën e sovranitetit. Kur një shtet përpiqet të ushtrojë sovranitetin mbi një territor, pyetja e parë që duhet të përgjigjet është: a është ky ushtrim i sovranitetit i “bazuar” në precedent, apo a është në përputhje me status quo-në e sovranitetit në mosmarrëveshje? Nëse ushtrimi i sovranitetit bie brenda status quos ekzistuese, atëherë kjo nuk ndikon në statusin e sovranitetit dhe kështu nuk ka kërkesë për ndonjë protestë madhore (përveq nëse shteti tjetër dëshiron të përdor këtë mundësi për të ndryshuar ose kundërshtuar status quo-në).

Nëse ushtrimi i sovranitetit është i paprecedent në mosmarrëveshje: do të thotë që nëse ushtrimi nuk bën pjesë, por në vend të tij ndryshon status quo-në, atëherë shteti tjetër ka dy zgjidhje: protestë ose pranim. Protesta në këtë rast nuk është protestë ligjore, megjithëse mund ta përfshijë atë, ndërsa pajtimi mund të zhvillohet pavarësisht se shteti paraqet një protestë zyrtare ligjore.

Një protestë e suksesshme në lojën e sovranitetit kërkon ndërmarrjen e veprimeve që bëjnë që shteti të përpiqet të ushtrojë sovranitetin për të hequr dorë nga veprimet e tij. Kjo protestë përfshin përdorimin e një ose më shumë prej tre llojeve të kapitalit të diskutuar më poshtë: ekonomik, ushtarak dhe diplomatik, këto përfshijnë kërcënimin ose përdorimin e vërtet të forcës, tërheqjen e ambasadorëve ose kufizimin e lidhjeve ekonomike.

Nëse protesta nuk është e mjaftueshme për të parandaluar ushtrimin e sovranitetit, nënkupton se shteti protesutes ka pranuar. Ky pranim krijon një precedent, dhe pasi të jetë krijuar precedenti, ai mund të rutinohet, duke e bërë shumë të vështirë kthimin mbrapa, më të vështirë sesa do të ishte për të protestuar dhe parandaluar ushtrimin fillestarë të vetë

¹⁰⁷ Zyra e Kryeministrit. (2010), Qeveria ndan 5 Milion euro investime për veriun e Mitrovicës, gjindet tek: <https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-ndan-5-milione-euro-investime-ne-veri-te-mitrovices/>.

sovrانيتيت.

Për ta bërë këtë më të qartë le të marrim një shembull: Shteti A kontrollon një ishull të vogël, Shteti B gjithashtu pretendon sovranitetin mbi ishullin. Shteti A nuk ka investuar kurrë asgjë në këtë ishull. Shteti A njofton planet për ndërtimin e një baze për rojet bregdetare të tij, përfshirë një port, ndërtesa dhe infrastrukturë tjetër të nevojshme. Një ushtrim i tillë i sovranitetit paraqet një ndryshim në status quo-në e mosmarrëveshjeve territoriale: do të krijonte precedentin që Shteti A mund të ndërtojë infrastrukturë shtetërore në ishullin e diskutueshëm. Shteti B, duke njohur kërcënimin për pozicionin e tij në mosmarrëveshje, dhe duke vlerësuar shumë territorin e diskutueshëm, vendos të përdor burimet e tij ekonomike. Shteti B kërcënon të prishë të gjitha lidhjet ekonomike me shtetin A nëse shteti A vazhdon me ndërtimin e bazës së rojeve bregdetare. Shteti A e merr seriozisht kërcënimin dhe vonon planet e ndërtimit dhe kështu ruhet status quo-ja, në të vërtetë është përforcuar që nga një kurs i përmbysur i shtetit, përballë kërcënimit nga shteti B, duke demonstruar paaftësinë e Shtetit A për të ushtruar në mënyrë efektive sovranitetin mbi territorin që kontrollon.

Një shembull i dytë për të sqaruar kompleksitetin e lojës së sovranitetit: në këtë rast ndodh një ndryshim në pozicionin e të dy paleve. Shteti A kontrollon territorin e diskutueshëm dhe Shteti B kundërshton sovranitetin e shtetit A. Shteti A fillon për herë të parë për të kryer kërkime shkencore detare në ujërat përreth ishujve. Shteti B proteston përmes kanaleve zyrtare diplomatike. Shteti A rithekson që ishujt e diskutueshëm janë pjesë e territorit të tij: prandaj, hulumtimi nuk ka pse e shqetëson shtetin B. Shteti B proteston edhe njëherë duke këcenuar se do të tërheqë ambasadorin e tij nëse hulumtimi nuk ndërpritet. Shteti A përfundon studimin, dhe Shteti B tërheqë ambasadorin e tij për një periudhë një javore. Status quo-ja është ndryshuar: pavarësisht protestave të Shtetit B, Shteti A ushtroi sovranitetin në mënyrë absolute. Aftësia e Shtetit A për të ushtruar sovranitetin mbi territorin është rritur, megjithëse të paktën duke tërhequr ambasadorin, Shteti B e ka bërë të qartë për Shtetin A se përsëritja e një ushtrimi të tillë do të provokojë një përgjigje pasuese. Sidoqoftë, protesta e Shtetit B ishte proporcionale, domethënë nuk ishte në gjendje të parandalonte ushtrimin e sovranitetit, pra, Shteti B pranoi ushtrimin e sovranitetit nga Shteti A. Këta dy shembuj ilustrues tregojnë se si shtetet kërkojnë të përmirësojnë pozicionin e tyre në lojën e sovranitetit përmes përpjekjes për të ushtruar sovranitetin ose parandaluar ushtrimin nga pala tjetër. Shembujt u referuan dy aspekteve të lojës së sovranitetit me qëllim për ta bërë më të kuptueshëm shpjegimin i cili do të bëhet në vazhdim për situatën e ushtrimit të sovranitetit në rastin e tezës në fjalë.

3.3.1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS: 17 SHKURT 2008

Pas përfundimit të luftes dhe vendosjes nën Administrimin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), udhëheqësit e Kosovës më 17 shkurt 2008 shpallën deklaratën e njëanshme të Pavarësis së Kosovës: ku deklaruan shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe Sovran¹⁰⁸ me kufijet ndërkombëtar të paraparë në Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit,¹⁰⁹ pranuan marrjen e obligimeve nga UNMIK-u,¹¹⁰ dhe shprehjen e dëshirës për të vendosur mardhënie të mira me fqinjët, veqanërisht me Republikën e Serbis.¹¹¹ Kushtetuta e RKS në nenin 1 pika 3 shprehë qasjen e RKS për mos pretendime territoriale ndaj ansjës shteti,¹¹² respekton të drejtën ndërkombëtare,¹¹³ dhe në mënyrë të qartë synon vlerat demokratike, me qëllim të kontribimit në stabilitetin e rajonit dhe mbarë Evropës. Në kushtetutën e saj, Kosova e cilëson veriun e Kosovës si pjesë të saj të pandashme, njësorë si tërë territoret e saj.

3.3.2. KUSHTETUTA E SERBIS 2006: QASJA NDAJ TERRITORIT TË KOSOVËS

Kushtetuta e Republikës së Serbis u miratua në vitin 2006, duke zëvendësuar kushtetutën e mëparshme që datonte nga 1990.¹¹⁴ Miratimi i kushtetutës së re u bë i domosdoshëm pas shkëputjes së Malit të Zi. Për dallim nga kushtetuta e RKS, Serbia në kushtetutën e saj Kosovës i referohet si “Kosova e Metohia”,¹¹⁵ dhe e përcakton atë si pjesë Provinciale dhe integrale të Serbis, Serbia ka pretendime territoriale ndaj asaj që sot quhet RKS dhe përkundër vullnetit të saj këto pretendime nuk ka arritur ti realizoj në praktikë, sot Serbia autoritetin e saj në RKS e ushtron në mënyrë indirekte (përmes strukturave paralele të saj) dhe vetëm në veriun e Kosovës, ndikimi i serbis më shumë është lojë diplomatike përmes veprimeve të saj siq është argumentuar tentimi për tërheqjen e njohjeve të RKS,¹¹⁶ se sa veprime në praktikë. Parathënja e Kushtetutës së Serbis: “Duke pasur parasysh traditën shtetërore të popullit Serb dhe barazinë e të gjithë qytetarëve dhe bashkësive etnike në Serbi, duke marrë parasysh gjithashtu që provinca e Kosovës dhe Metohisë është një pjesë integrale e territorit të Serbis, që ajo ka statusin e një autonomie thelbësore brenda sovranitetit të Serbis, dhe që nga një status i tillë i Provincës së Kosovës dhe Metohisë

¹⁰⁸ Deklarata e Pavarësis së Kosovës (2008), Pika 1.

¹⁰⁹ Deklarata e Pavarësis së Kosovës (2008). Pika 8.

¹¹⁰ Deklarata e Pavarësis së Kosovës (2008), Pika 9.

¹¹¹ Deklarata e Pavarësis së Kosovës (2008), Pika 11.

¹¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008), Neni 1, Pika 3.

¹¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008), Neni 16, Pika 3.

¹¹⁴ BBC News. (2006), Unitet i rrallë mbi kushtetutën e Serbis. (Përkthyer).

¹¹⁵ Kushtetuta e Serbis (2006), Parathënie.

¹¹⁶ Euro Activ News (2019), 15 Shtete (dhe duke vazhduar), kanë revokuar njohjen e Kosovës. (Përkthyer).

ndjekin detyrimet kushtetuese të të gjitha organeve shtetërore për të mbështetur dhe mbrojtur interesat shtetërore të Serbis në Kosovë dhe Metohi në të gjitha mardhëniet politike të brendshme dhe të jashtme, qytetarët e Serbis miratojnë”.¹¹⁷

3.3.3. USHTRIMI I SOVRANITETIT NË TERRITORIN E KOSOVËS: VERIUN E KOSOVËS

Koncepti klasik i sovranitetit i shekullit XIX, edhe nëse rrallë i përkiste praktikës, ishte një koncept i sovranitetit territorial absolutë. Në shekullin XXI, sovraniteti domosdoshmërisht ndahet dhe varet nga marrëveshjet me një sërë aktorësh ndërkombëtar.¹¹⁸

Siç është shpjeguar në kapitullin e parë, territori i quajtur sot RKS ka kaluar në situata komplekse, dhe ka pasur jo-stabilitet dhe jo-qëndrueshmëri në ushtrimin e sovranitetit nga cila do palë që ka pasur pushtet me të madhe. Gjykimi i ushtrimit të sovranitetit sot në këtë territor është më i lehtë për tu shpjeguar se nga viti 1999-2007, sepse pas shpalljes së Pavarësis së Kosovës më 2008 e cila është shpallur në kufijtë e 1974 (që nënkuptojnë kufijtë të cilët i pretendon sot Kosova),¹¹⁹ situata në kuptimin e ushtrimit të sovranitetit në këtë territor është qartësuar. Pas shpalljes së pavarësis së Kosovës institucionet e kësaj të fundit kanë arritur që të ushtrojnë sovranitet në tërë territorin e saj përveq veriut të Kosoves ku situata nuk është në nivelin e njetjë të kontrollit si në pjesën tjetër të saj, i cili përfshin Mitrovicën si komunën më të madhe, Zubin Potokun, Zveqanin dhe Leposaviçin. Kosova ushtrimin e sovranitetit në këtë zonë e realizon përmes institucioneve zyrtare të saj: policisë (e cila kontrollon edhe pikën kufitare Kosovë-Serbi, dhe kujdeset për sigurinë), mban zgjedhjet komunale, dhe ka arritur që në këtë zonë të banuar me shumicë serbe ti kyqë Serbët e Kosovës në skemën sociale penzionale të RKS.

Ndërsa Serbia në kushtetuten e saj të 2006 në parathenjë, jo vetëm veriun e Kosoves, por tërë territorin e Kosoves e cilëson si pjesë integrale të saj, të cilës i referohet si “Kosova e Metohija”,¹²⁰ dhe vetëm në veriun e Kosoves arrin të realizojë ushtrimin e sovranitetit në pika të caktuara. Serbia në këtë territorë ushtrimin e sovranitetit e realizon përmes rrugëve ilegale dhe strukturave paralele, ilegale. Për dallim nga Kosova, Serbia nuk ka trupa të policisë në këtë zonë, dhe ndikimin e saj e shtrin përmes nxitjeve nacionaliste tek popullata Serbe, shkollat Serbe funksionojnë me plan-program të Serbis i cili nuk është i autorizuar nga institucionet e RKS.

Pra dallimi në ushtrimin e sovranitetit në mes këtyre dy vendeve qëndron në zgjedhjen e

¹¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Serbis. (2006), Parathënie.

¹¹⁸ International Commission on Kosovo. (2011). The Follow-up Report: Why Conditional Independence?.

¹¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (2008).

¹²⁰ Kushtetuta e Serbis. (2006). Parathënie.

rrugëve për ushtrimin e sovranitetit: rrugët për ushtrimin e sovranitetit në Kosove janë caktuar nga faktori ndërkombëtar i cili është prezent në Kosovë me trupa ushtarake që nga 1999. Prezenca e këtyre trupave ka garantuar sigurinë dhe paqen në këtë territor për këto vite dhe vazhdon të jetë faktori kryesor për mos lejimin e forcave të tjera në realizimin e pretendimeve territorial mbi këtë territorë, si pretendimet e serbis.

Pra për dallim nga shembujt e lartëcekur kur Ndërkombëtarët apo shtetet e mëdha me potencial përcaktojnë sovranitetin e jashtëm, në Kosove faktori ndërkombëtar është përcaktues edhe i mosmarrëveshjes në mes Kosovës dhe Serbis në sovranitetin e brendshëm. Ky kontest bilateral ka krijuar një situatë të konfliktit të ngrirë¹²¹ në veriun e Kosovës ku zhvillimet bëhen përmes deklarimeve politike dhe më pak përmes veprimeve në praktik. Veriu i Kosovës monitorohet nga Policët e Kosovës, (KQZ) mban zgjedhjet në veriun e Kosovës.

¹²¹ Tisdall, S. (2010). Kjo botë e re e Rrezikshme e kombeve të vetë-interesuara. The Guardian. (Përkthyer).

3.4. VENDIMI I GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË NË RASTIN E KOSOVËS

Pas nismës së Serbis,¹²² Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi me 8 tetor 2008 Rezolutën 63/3, përmes së cilës, bazuar në nenin 96 të Kartës së OKB-së¹²³ dhe në nenin 65 të Statutit të GjND-së,¹²⁴ i kërkohej kësaj të fundit të jepte mendimin konsultativ lidhur me pyetjen: “A është Deklarata e njëanshme e Pavarësisë, nga institucionet vetëqeverisëse të Kosovës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?”.

Në bazë të nenit 66/1 të statutit të saj,¹²⁵ Gjykata njoftoi të gjitha shtetet për këtë kërkesë duke u’a kujtuar të drejtën që kishin për të marrë pjesë në gjykim. Bazuar në nenin 66/2 të statutit, gjykata përcaktoi datën 17 prill 2009 si afatin e fundit për paraqitjen e mendimeve me shkrim nga shtetet e interesuara, ndërsa në bazë të nenit 66/4 përcaktori datën 17 korrik 2009 si afatin e fundit, brenda të cilit shtetet dhe organizatat që kishin paraqitur me parë mendimet me shkrim të mund të bënin edhe komente me shkrim rreth mendimeve të paraqitura nga subjektet e tjera. Gjykata ftoi edhe “autoret e Deklaratës së Pavarësisë” për të paraqitur mendime dhe komente me shkrim, pasi kontributi i tyre vlerësohej se do të ishte i vlefshëm për vendimarrjen e saj.

Mendime rreth qështjes paraqitën 38 shtete, ndërsa komente me shkrim mbi mendimet e shteteve të tjera paraqitën 15 shtete. Në seancën e 1 dhjetorit 2009 paraqitën mendime dhe komente 29 shtete. GjND e dha mendimin e saj këshillimor me 22 korrik 2010, me strukturë të vendimit: 1. Juridiksioni, 2. Kuptimi i qështjes, 3. Faktet kryesore, 4. Vlerësimi nëse Deklarata e Pavarësisë është në kundërshtim me të Drejtën Ndërkombëtare, 5. Konkluzione të përgjithshme, duke deklaruar me 10 vota pro dhe 4 kundër se: “Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk cenon normat e së Drejtës Nderkombetare”.

Dhe se nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 duke i’u referuar rregullores 2001/9¹²⁶ e cila shpall Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, në të cilën përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësit në administrimin e Kosovës, dhe se kjo Rezolutë nuk përmbante ndonjë dispozitë lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës ose me kushtet e percaktimit të saj. Gjykata pastaj argumenton se “autorët nuk e ndërmorren deklarimin në emer të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse brenda Kornizës Kushtetuese, por si persona që vepruan në cilesinë e tyre si përfaqësues të popullit të Kosovës, jasht kuadrit të administratës së përkohshme”.¹²⁷ Në një perspektivë afatmesme

¹²² UN, General Assembly. (2008). Plenary.

¹²³ Neni 96 i Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

¹²⁴ Neni 65 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. gjendet tek: <https://www.icj-cij.org/en/statute>.

¹²⁵ Neni 66/1 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

¹²⁶ UNMIK. (2001). Rregullorja 2001/9.

¹²⁷ GjND. (2010). Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence.

ose afatgjatë, opinionin këshillimor për Kosovën mund të lexohet në këtë kontekst. Bazuar në të kaluarën, duket se ka pasur një ndjenjë të fort nga shum shtete se Serbia kishte humbur legjitimitetin për të qeverisur Kosovën për arsye të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut.¹²⁸ Duke parë nga ky këndvështrim, mund të themi se: sa i përket interesave të saj, Serbia mori një opinion këshillimorë 'katastrofik' (të padëshiruar) nga Gjykata.¹²⁹

Është e vërtetë që të gjitha konsideratat e përmendura thjesht janë me natyrë politike. Por kjo nuk do të thotë që ato janë juridikisht të parëndësishme. Edhe nëse vetëvendosja nuk i jep të drejtë juridike të suksesit,¹³⁰ mund të argumentohet se në rastin e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare ishte dukshëm e gatshme të pranonte në rezultat edhe pse Serbët shkelnin të drejtat e njeriut dhe diskriminonin Kosovarët, në kohën e Deklarimit të Pavarësis¹³¹ Shkurtime: edhe pse opinionin këshillimorë të Kosovës nuk thoshte shprehimisht është mbi të drejtën e shkëputjes, ai sigurisht që ka kontribuar në pajtueshmërinë e bashkësis ndërkombëtare për zhvillimet në rastin specifik të Kosovës.¹³² Dhe në këtë drejtim, nuk mund të përjashtohet që të ishte vendosur një precedent për raste të tjera.

Gjykata në opinionin këshillimorë konsideron se: "...fushëveprimi i parimit të integritetit territorial kufizohet në sferën e marrëdhënieve midis shteteve".¹³³ Gjykata arrin në këtë përfundim si rezultat i një arsyetimi mjaft të shkurtër në të cilin parimi i integritetit territorial është i lidhur me nenin 2(4), në Deklaratën e Marrëdhënieve Miqësore dhe Aktin Përfundimtar të Konferencës së Helsinkit të vitit 1975. Ndërsa është e vërtetë që integriteti territorial është përmendur shprehimisht në këto dispozita dhe dokumente dhe se, ato burojnë nga situatë ndërshtetërore, kjo nuk nënkupton logjikisht dhe domosdoshmërisht se parimet e përfshira në to aplikohen vetëm në marrëdhëniet ndërshtetërore. Nuk ka dyshim se Gjykata ishte në dijeni të (shum) pjesëve të së drejtës ndërkombëtare, te cilat ose janë të aplikuara në rendin e brendshëm juridik të shteteve¹³⁴ ose kanë aspekte

¹²⁸Folk, A., R. (2005). *Toward Authoritativeness: The ICJ Ruling on Israel's Security Wall*. Cambridge University Press, Cambridge.

¹²⁹ Christakis, T. (2011), *The ICJ Advisory Opinion on Kosovo: Has International Law Something to Say about Succession?*. Gjetet tek: <https://cesice.univ-grenoble-alpes.fr/actualites/2017-06-16/publication-leiden-journal-international-law-march-2011-about-icj-advisory-opinion-unilateral>.

¹³⁰ Ky është pozicioni mbingarkues juridik, për detaje, shih ST Peter, "Vetëvendosje" në Simma et. Al, and S oter.

¹³¹ Peter Hilpold. (2013). *The International Court of Justice's Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question*. Gjetet tek: <https://www.peterhilpold.com/wp-content/uploads/2014/03/hilpold20.pdf>.

¹³² Wilde, R. (2011). *Self-Determination, Secession and Dispute Settlement after the Kosovo Advisory Opinion*. *Leide Journal of International Law*.

¹³³ ICJ. (2011). *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo (Advisory Opinion)*.

¹³⁴ Shembull. ICJ Report. (2004), *Avena and Other Mexican Nationals (Mexico v United States of America)*.

ndërkufitare,¹³⁵ ose edhe te dyja nëse konsiderohet se e gjithë përmbajtja e ligjit për të drejtat e njeriut.¹³⁶ kjo nënkupton se sfondi i deklaratës së Gjykatës nuk mund të jetë koncept i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare si e drejta ndërshtetërore.

Qështja kryesore është se minimalizimi gjyqësor i zgjidhur nga gjykata duhet të shihet si një përgjigje adekuate ndaj problemit konkret faktik dhe juridik me të cilin u përball. Fakti që ishte përshtatur për situatën specifike të qështjes në fjalë, mund të ilustruhet nga situata hipotetike e mëposhtme: imagjinoni që Deklaratës së Pavarësis së Rodosis së Jugut, Mbreteria e Bashkuar kishte arritur të bindëte Asamblene e Përgjithshme të kërkonte nga Gjykata një opinion këshillimorë për pyetjen nëse Deklarata e Pavarësis ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

A mund të imagjinohet në të vërtetë gjykata duke deklaruar, në menyrë të ngjashme se gjithqka që mund të thoshte është se deklarata si e tillë nuk e shkelte ligjin ndërkombëtar? Sigurisht që jo. Një arsye për këtë mund të gjendet në paragrafin 81 të opinionit këshillëdhënës, ku gjykata bënë përjashtim: deklaroi se ekzistojnë rrethana të cilat mund të bëjnë që deklaratimet e njëanshme të pavarësis të jenë të paligjshme, përkatesisht 'ërdorimi i paligjshëm i forcës ose shkelje të tjera të ashpra të normave të ligjit të përgjithshëm ndërkombëtar, në veçanti ato të karakterit përfundimtarë (të pakundërshtueshme)'. Në rrethana të tilla, një opinion këshillëdhënës me siguri do të kishte theksuar rëndësinë nëse këto dispozita, dhe të konkludonte që deklarata, për këtë arsye nuk ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare".¹³⁷

Mund të argumentohet se verdikt i GJND-së në rastin e Kosovës kontribon në zhvillimin e një zgjidhjeje, megjithatë nuk e zgjidh përfundimisht qështjen. Pozicioni i Kosovës dhe pretendimi për pavarësi është forcuar faktikisht dhe politikisht nga ky verdikt i GJND-së.¹³⁸ Në të njëjtën kohë, frikësohet se sanksionimi i deklaratës së njëanshme të Pavarësis si e ligjshme, mund të hape "Kutinë e Pandorës", dhe mund të kundërshtohet në aspektin ligjor duke iu referuar minimalizimit gjyqësor të gjykatës i cili në terma strikt juridik, saktësisht shmangte qdo shqiptim mbi ligjshmërinë e shpëputjes nën të drejtën ndërkombëtare ashtu si qëndron aktualisht. Kështu, gjykata le zhvillimin e mëtutjeshëm të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me shpëputjen për të ardhmen.¹³⁹

Në përfundim të arsytimit të mësipërm, në mënyrë të përmbledhur GJND thekson se

¹³⁵ Shembull. (2004), Gorgulu Case, Federal Constitutional Court of Germany.

¹³⁶Walter, Ch., & Ungern-Sternberg, A., V., & Abushov, K. (2014). Self-Determination and Secession in International Law. Oxford University Press.

¹³⁷ Shih Referencën 136.

¹³⁸Shih Referencën 136.

¹³⁹ Howse, R. (2010), How has the ICJ Contribute to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?. Germany.

“Deklarata e Pavarësis së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk cenon normat e së Drejtës Ndërkombëtare, Rezoluten 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, si dhe Kornizën Kushtetuese”.¹⁴⁰

¹⁴⁰ ICJ. (2010). Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo.

KAPITULLI IV

ANALIZA KRAHASUESE

4.1. VLERA PRECEDENCIALE

Ndarja apo shkëputja është një qështje perqarëse në ligjërimin juridik ndërkombëtar. Shtetet zakonisht janë mjaft të rezervuara dhe skeptike ndaj përpjekjeve për shkëputje. Nga të gjitha rastet, më i jashtzakonshmi është rasti i Kosovës kur një numër i madh i shteteve e përkahën lëvizjen drejt pavarësis që ndodhi kundër vullnetit të sovranit territorial (Serbis) dhe megjithë zbatueshmërinë e vazhdueshme të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit. Deklarata e 17 Shkurtit 2008 nga Parlamenti i Kosoves që thoshte “Kosova shpallet shtet i pavarur dhe Sovran” mori një reagim të përzier në arenën ndërkombëtare. SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe shumica e shteteve anëtare të BE-së, si dhe një mori vendesh tjera, zyrtarisht e njohën Kosovën si një shtet të ri, të tjerët si Rusia, Rumania, Moldavia dhe Qipro (dhe natyrisht Serbia), argumentojnë se shkëputja e Kosovës dhe / ose njohja e kësaj shkëputje do të ishte një shkelje e ligjit ndërkombëtar.¹⁴¹

Një qështje që dukej se ndikonte në shtetet ishte nese deklarata e Kosovës, dhe njohja e saj pasuese nga shumë shtete me ndikim, do të ishte një lloj “precedenti” që do të ndikonte në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tjera separatiste, në thelb të ratifikonte pretendimet e separatistëve. Në vitet para deklaratës së vitit 2008, udhëheqësit e tjerë të separatistëve, siq është Igor Smirnov i Transnistrisë, kanë argumentuar në thelb se “nëse Kosova merr pavarësinë, atëher duhet të marrim edhe ne”.

Për të vlerësuar këtë deklaratë, është e rëndësishme që së pari të theksohet se kur avokatët ndërkombëtar dhe teoricientët e mardhënieve ndërkombetare flasin për precedentin, ata përdorin termin në menyra pak më të ndryshme. Ndërsa shkencetarët politikë zakonisht e përdorin atë për të i'u referuar një ngjarje të kaluar që mund të jetë politike bindëse ose mund të përdoret në dialog diplomatik, avokatët kanë një kuptim më strikt të fjalës dhe e përdorin atë kur një ngjarje e kaluar deklaron një rregull të ligjit që do të zbatohet në rastin aktual. Si qështje teknike, në të drejtën ndërkombëtare në krahasim me të drejtën e brendshme, precedenti nuk është detyrues. Për shembull, një vendim i mëparshëm I GjND-së në një qështje në mes dy shteteve nuk përcakton rregullin juridik që duhet të zbatohet në një rast të mëvonshëm në mes dy shteteve tjera. Ekziston një supozim shumë i fort që si

¹⁴¹ Borgen, J., Ch. (2008), Is Kosovo a Precedent? Sececcion, Self-Determination and Conflict Resolution. Wilson Center. Gjindet tek: <https://www.wilsoncenter.org/publication/350-kosovo-precedent-secession-self-determination-and-conflict-resolution>.

rastet nuk trajtohen njësoje. Ndërsa si qështje formale precedenti nuk është ligjërish i detyrueshëm, pasi një qështje praktike avokatët ndërkombëtar do të përpiqen të mbajnë një sërë rregullash koherente dhe të qëndrueshme në rastet e ngjashme. Në rastin e Kosovës, fillimisht duhet të shohim së pari Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (gjërisht në kapitullin e parë), e cila siguroi një kornizë për afrimin e stabilizimit të Kosovës. Përveq kësaj rezolute, duhet të merren parasysh rregullat dhe normat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me vetëvendosjen dhe shkëputjen.

Ligji i vetëvendosjes dhe problemi i shkëputjes është qështja më e kontestuar në lidhje me vetëvendosjen, është përcaktimi i asaj që nënkupton vetëvendosjen e popujve. Në pika të ndryshme të historisë juridike ndërkombëtare, termi “njerëz” është përdorur për të nënkuptuar qytetarët e një kombi-shteti, banorët e një territori specifik janë dekolonizuar nga një fuqi e huaj, ose nga një grup etnik.

Një grup ekspertësh u mblodh nga Asambleja Kombëtare e Quebec-it për të dhënë këshilla në lidhje me qështjet ligjore të implikuara nga një ndarje hipotetike e Quebec-it (Komisioni i Quebec-it). Në raportin e tij, Grupi i Ekspertëve në lidhje me integritetin territorial të Quebec-it në rast të Arritjes së Sovranitetit, Komisioni deklaroj (në Seksionin 3.07)¹⁴² se e drejta për të vetëvendosur varet nga konteksti dhe se lloje të ndryshme të njerëzve qojnë për aplikime të ndryshme të së drejtës së vetëvendosjes: vetë fakti që e drejta për vetëvendosje, në kuptimin e “pavarësisë”, është njohur vetëm tek popujt “kolonial” është një tregues që kjo e drejtë merr ose mund të marrë kuptime të ndryshme për kategoritë e tjera të popujve.

Pasojat problematike të qështjes së Kosovës duke u përceptuar si precedent shihen qartë në veprimet e Rusisë kundër Ukrainës (i cili nga pikpamja juridike rezulton i paligjshëm dhe mund të etiketohet si aneksim)¹⁴³, dhe përpjekjet e grupeve të panjohura në rrafshin ndërkombëtar përdorin precedentin e Kosovës për të arritur qëllimet e tyre. Abhazia dhe Ossetia e Jugut rinovuan thirrjet e tyre për njohjen e sovranitetit të tyre.¹⁴⁴

¹⁴² Commission of Quebec. Territorial integrity of Quebec in the event of the attainment of Sovereignty.

¹⁴³ Parliamentary Assembly of the Council of Europe. (2014). Resolution 1988 of 9 April 2014, para. 12. Doktrina tradicionale e “aneksimit” kryesisht merret me blerjen me forcë të territoreve, dmth, blerja e territorit të jetë përmes forces, (shihp.sh. R, Hofmann, “Anexation”, në Max Planck Encyclopedia of International law.

¹⁴⁴ Jovanovic, N., M. (2013), The Economics of European Integration. Edward Elgar Publishing.

4.2. VETËVENDOSJA: SHKËPUTJA DHE KRIZA E KRIMES 2014

Me 17 Mars 2014, pas një referendumi shumë të kontestuar, Republika Autonome e Krimes e Ukrainës shpalli pavarësinë e saj dhe paraqiti një kërkesë për t'u 'ribashkuar' me Federatën Ruse.¹⁴⁵ Kërkesa e Krimes u mirprit nga Rusia dhe të nesërmen, Presidenti Putin dhe përfaqësuesit e Krimes nënshkruan një marrëveshje pranimi që zyrtarisht e përcaktoi Republikën e Krimes si një subjekt federal të Federatës Ruse.¹⁴⁶

Këto zhvillime kishin sjellë në një krizë në "Krime", kriza në gadishullin e Krimes ka ngritur pyetje të ndryshme përkatëse të ligjit ndërkombëtar. Kjo reflektohet edhe në argumentet e paraqitura nga autoritetet e Krimes dhe Rosis, të cilat të dyja u referuan në ligjin ndërkombëtarë në përpjekjet e tyre për të justifikuar ngjarjet. Shpallja e pavarësisë së Krimes i'u referua Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe mendimit këshillimor të GJND-së për pavarësinë e Kosovës, duke argumentuar se Gjykata kishte vendosur që deklarata e njëanshme e pavarësisë nuk shkelte të drejtën ndërkombëtare.¹⁴⁷ Në fjalimin e 18 Marsit, Presidenti Putin theksoj; "precedentin e Kosovës" dhe iu referua të drejtës së vetëvendosjes në mënyrë që të justifikonte shkëputjen e Krimes nga Ukraina. Ai deklaroi:

"Sic shpalli pavarësinë dhe vendosi të zhvilloj referendum, Këshilli i Lartë i Krimes i'u referua Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila flet për të drejtën e kombeve për vetëvendosje. Rastësisht, do të dëshiroja të ju kujtoja se kur Ukraina u shkëput nga BRSS ajo bëri pikërisht të njejtën gjë, gati fjalë për fjalë. Ukraina e perdori këtë të drejtë, megjithatë banorëve të Krimes u është mohuar. Pse ndodh kjo?"¹⁴⁸

Është e dukshme që Federata Ruse pretendonte se popullsia e Krimes kishin ushtruar të drejtën e tyre për vetëvendosje në raste të ndryshme. Gjatë debateve në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, përfaqësuesi Rus paraqiti një pamje të ngjashme, duke deklaruar se:

"Në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe procedurën demokratike, pa ndërhyrje nga jashtë dhe përmes një referendumi të lirë, popullsia e Krimes kanë përmbushur atë që është parashikuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe një numër të madh dokumentesh themelore juridike ndërkombëtare, të drejtën e tyre për vetëvendosje."¹⁴⁹

¹⁴⁵ Crimea Shpallë Pavarësinë, kërkon njohjen e KB, 17 Mars 2014, available at:

<https://www.rt.com/news/crimea-referendum-results-official-250/>.

¹⁴⁶ President of Russia (2014), 'Agreement on the accession of the Republic of Crimea to the Russian Federation signed'. Gjendet tek: <http://en.kremlin.ru/events/president/news/20604>.

¹⁴⁷ Crimea Parliament declares independence from Ukraine ahead of referendum. (2014). gjendet tek: <https://www.rt.com/news/crimea-parliament-independence-ukraine-086/>.

¹⁴⁸ President of Russia. (2014). Address by the President of the Russian Federation. Gjendet tek: <http://en.kremlin.ru/events/president/news/20603>.

¹⁴⁹ UN Security Council, UN Doc. S/PV.7144, 19 March p.8.

Ka situata në të cilat përpjekjet e shkëputjeve të njëneshme konsiderohet e paligjshme në funksion të rrethanave, dhe pikërisht ky përjashtim është i rëndësishëm në rastin e Krimes. Në këtë kontekst, parimi i integritetit territorial në shum raste përdoret si mburojë kundër përpjekjeve për ndarje të njëanshme.¹⁵⁰

Për të vlerësuar nëse, në mungesë të një të drejtë juridike të së drejtës ndërkombëtare në të vërtet ndaloj përpjekjen e Krimes në shkëputjen e njëanshme, do të shqyrtojnë nëse parimi i integritetit territorial mund të shihet si ndalim në këtë drejtim. Parimi i integritetit territorial vlerësohet shumë nga shtetet dhe në shum raste referohen si shkelje, përpjekjet për shkëputjet e njëanshme.

Është e diskutueshme nëse parimi në të vërtet ndalon një veprim të tillë të njëanshëm sipas të drejtës ndërkombëtare. Në opinionin Këshillimor të Kosovës, GJND konkludoi se “parimi i integritetit territorial kufizohet në sferën e mardhënieve në mes shteteve”.¹⁵¹ Gjykata vërtetoi qëndrimin e saj duke iu referuar tre instrumenteve ndërkombëtare që përmbajn një klauzolë mbi parimin e integritetit territorial, d.m.th. neni 2(4) i Kartes së OKB-së,¹⁵² Parimi i Parë (I), paragrafi 1 I Deklaratës së Mardhënieve Miqësore,¹⁵³ dhe Artikulli IV i Aktit Përfundimtar të Helsinkit.¹⁵⁴ Këto paragrafe janë adresuar në mënyrë të qartë në shtetet dhe kryesisht tregojnë integritetin territorial në kontekstin e ndalimit të kërcënimit ose përdorimit të forcës në mardhëniet ndër-shtetërore. Si e tillë, tërësia territoriale e një Shteti mund të cenohet vetëm nga një shtet tjetër.

Meqenëse shkëputja është me përkufizim të kërkuar nga subjektet që nuk janë (akoma) shtete, por aspirojnë të bëhen një – veprim i njëanshëm që synon shkëputjen nuk to të dëmtojë parimin e integritetit territorial.¹⁵⁵ Në këtë këndvështrim integriteti territorial në përgjithësi nuk paraqet ndonjë pengesë për apo edhe një ndalim në përpjekjet për shkëputje (të njëanshme). Vetëm kur një shtet i tret do të mbështeste në mënyrë aktive një përpjekje të shkëputjes nga kërcënimi ose përdorimi i forcës, ose kur shkëputja do të kryhej nga autoritetet e huaja në kuptimin që ata pushtojn një territor me synimin për ta

¹⁵⁰ ICJ. (2009). Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of Self-Government of Kosovo (Request for Advisory Opinion), Written Statement of Argentina, 17 April, paras. 69-80.

¹⁵¹ ICJ. (2010). Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of Self-Government of Kosovo (Request for Advisory Opinion), Advisory Opinion of 22 July 2010, ICJ Reports, p. 403, para. 80.

¹⁵² Neni. 2 (4). Deklaron: Të gjithë Antarët duhet të përmbahen në mardhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimi ose përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë të qdo shteti, ose ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

¹⁵³ Karta e Kombeve të Bashkuara. (1970). Rezoluta 2625 e Asamblesë së Përgjithshme të KB. Dokument i KB, A/RES/2625 (XXV), Shtojcë, 24 October.

¹⁵⁴ Article IV (1975), Final Act of Helsinki.

¹⁵⁵ Vidmar, J. (2012). Conceptualizing declarations of independence in international law. Oxford J Legal Stud 32:153-177.

ndarë atë nga shteti mëm. Këto veprime shkelin parimin e integritetit territorial.¹⁵⁶ Duke marrë parasysh zbatueshmërinë e parimit të integritetit territorial në lidhje me shkëputjen e njëanshme, këndvështrimi i paraqitur nga GjND duket se është në përputhje me atë që shpesh quhet “neutralitet juridik” i së drejtës ndërkombëtare, për këtë qështje: e drejta ndërkombëtare as nuk autorizon shkëputje të njëanshme, as nuk e ndalon atë.

Përkundrazi, duhet të konsiderohet si qështje e brendshme e shtetit mëm, ndërsa vetëm pasojat e një veprimi të tillë – p.sh qështjet e shtetësisë, detyrimi për shtetet e treta që të përmbahen nga mbështetja e subjektit secesionist,¹⁵⁷ dhe në disa raste një detyrim për të ndaluar njohjen,¹⁵⁸ rregullohen me të drejtën ndërkombëtare.¹⁵⁹

Ndërsa pozicioni i GjND-së në fushën e parimit të tërësisë territoriale është i kuptueshëm duke marrë parasysh burimet në të cilat është mbështetur dhe është i sakt në një masë, ai është tepër kufizues.

Argumentet që përfshijnë një të drejtë të pretenduar për vetëvendosje dhe shkëputje (rregulluese) të avancuar nga autoritetet e Krimes dhe Rusisë në përpjekjen për të justifikuar krizën në Gadishullin e Krimes nuk mund të mbështeten. Përkundrazi: ndarja e njëanshme e Krimes nga Ukraina ishte qartë e paligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare.

¹⁵⁶ Crawford, J., R. (2000). Report by James Crawford: response to experts reports of the amicus curiae. Kluwer Law. International Law, The Hague, pp 153-171.

¹⁵⁷ Nolte G (2006) Secession and external intervention. Cambridge University Press, Cambridge. pp 65-93.

¹⁵⁸ Dugard, J., & Raic, D. (2006). The Role of recognition in the law and practice of secession. Cambridge University Press, Cambridge, pp 94-137.

¹⁵⁹ Shih Referencën 156.

4.3. OSSETI JUGORË DHE ABKHAZIA (GJEORGJI)

“Nëse njerëzit besojnë se Kosovës mund t’i jepet pavarësi e plotë, pse atëher duhet ta mohojmë atë në Osetin Jugor dhe Abkhazi?”¹⁶⁰ Në të kundërtën e Kosovës, e cila ka marrë njohjen e saj të gjerë ndërkombëtare, republikat e shkëputura gjerorgjiane të Abkhazisë dhe Osetit Jugorë, nuk kanë arritur të krijojnë edhe shtetet e tyre të pavarura.

Qështja nëse njohja e Kosovës si shtet i pavarur mund të shërbejë si precedent për ish republikat autonome të Gjeorgjisë, Osetit Jugor dhe Abkhazisë është qështje mjaft e diskutuar në rrafshin ndërkombëtar të zhvillimeve politiko-juridike. Parimet për krahasimin e këtyre dy rasteve, dhe pyetjet nëse Kosova mund / duhet të shërbejë si precedent për këto raste, gjejnë para së gjithashë rëndësinë e parimeve të përfshira në njohjen e shteteve sipasi ligjit ndërkombëtar.

Njohja ndërkombëtare i ka shërbyer shoqëris ndërkombëtare si një paisje me të cilën i përgjigjet shoqëris kombëtare në rendin publik botëror dhe shfaqjeve të shteteve të reja.¹⁶¹ Pas shpërbërjes së dy shteteve multietnike në dy dekadat e fundit, BRSS DHE RFJ, njohja ndërkombëtare ka fituar rëndësi të madhe. Një debat i spikatur mbi të drejtën ndërkombëtare që përcakton ekzistencën e shtetit, është një debat në mes shkollave konstitutive dhe deklarative të njohjes.

Studiuesit që përafrohen me teorinë konstitutive pretendojnë se një entitet kërkon njohje nga shtetet tjera për t’u pajisur me personalitet juridik ndërkombëtar. Ndërsa shkolla deklaruese pohon se një bashkësi politike që plotëson kërkesat e shtetësisë të parashikuar në Konventën Montevideo¹⁶² automatikisht cilësohet si “Shtet” dhe se njohja nga shtetet tjera thjesht pranon (shpall) “si një fakt diqka që deri më tani ka qenë e pasigurt”.¹⁶³

Është vërtetuar se doktrina deklarative ka ushtruar tërheqjen më të madhe se konstitutivizmi gjatë tridhjetë viteve të fundit.¹⁶⁴ Megjithatë, edhe për ata që ndajnë mbizotërimin e doktrinë deklarative, njohja nga shtetet e tjera mbetet e rëndësishme.¹⁶⁵ Shembull, ndonëse Gjykata Supreme e Kanada-së¹⁶⁶, duke kontestuar ligjshmërinë e shkëputjes së mundshme të Quebec-it nga Kanada, miratoi teorinë deklarative të njohjes, ajo theksojë: “qëndrueshmëria e një shteti të mundshëm në bashkësinë ndërkombëtare varet si qështje praktike, nga njohja nga shtetet e tjera.” Njohja kolektive në formën e

¹⁶⁰ Vladimir Putin, The Economist, <https://www.economist.com/europe/2007/11/29/if-kosovo-goes-free>.

¹⁶¹ Grant, Th. (1999). The Recognition of States, Law and Practice in Debate and Evolution. Westport.

¹⁶² Article 1 of the Montevideo Convention on the Rights and Duties of States.

¹⁶³ Dutard, J. (1987). Recognition and the United Nations. Cambridge Grotius Publications Limited. p.7.

¹⁶⁴ Thomas Grant, supra note 3 at 19: see also James L Brierly. The law of Nations.

¹⁶⁵ JShih Referencën 163.

¹⁶⁶ 20 August. (1998). Advisory Opinion of the Supreme Court of Canada Reference Re: Secession of Quebec, [1998] 2 S.C.R.217; 37 ILM 1998, 1342.

pranimi në Kombet e Bashkuara, dhe në një masë të vogël për organizatat e tjera ndërkombëtare, si në rastin e njohjes nga Këshilli Evropian i Koracis dhe Bosnjës në vitin 1992, mund të ndikojë në të gjithë pyetjen e shtetësisë.¹⁶⁷ Disa studiues kanë argumentuar se ekziston një zhvendosje nga njohja individuale e shteteve në njohjen kolektive përmes organizatave ndërkombëtare.¹⁶⁸ Megjithatë, dinamika e njohjes së Kosovës, ushtrimi me i fundit në njohjen e një shteti të ri, dëshmon të kundërtën.

Njohja e Kosovës ishte një qështje mjaft e individualizuar në mës shteteve. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, SHBA-të ishin ndër vendet e para që njohën zyrtarisht Kosovën si shtet Sovran dhe të pavarur me 18 shkurt 2008.¹⁶⁹ BE ia shtroi pyetjen anëtarëve të tij individualisht.¹⁷⁰ Franca, Gjermania, Italia dhe 20 anëtarët e tjerë të BE-së e njohën Kosovën individualisht si një shtet të pavarur,¹⁷¹

Spanja refuzoi ta njohë pavarësinë e Kosovës me pretekstin se “nuk respekton ligjin ndërkombëtar.”¹⁷² Në mënyrë të ngjashme, Qipro, Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Sllovakia refuzuan pavaësinë e Kosovës.¹⁷³ Kronologjia e lartëpërmendur e njohjes së Kosovës nga shtetet individuale dhe pamundësia apo mosgadishmëria e organizatave ndërkombëtare për të qenë në pararojë të këtij procesi tregon se procesi i njohjes së Kosovës ishte i decentralizuar në mesin e vendeve individuale dhe, në kundërshtim me atë që sugjerojnë disa studiues, njohja kolektive nuk lujati rol.

Situata me njohjen e Osetit Jugorë është e ndryshme. Kordinimi në mes organizatave ndërkombëtare për mosnjohjen e Osetit të Jugut / Abkhazisë i ngjan procesit të mosnjohjes duke zvogëluar në mënyrë minimale mundësin e këtyre subjekteve të themelohen si shtete të pavarura dhe të zbatueshme. Ish Republikat Autonome të Gjeorgjisë, Abkhazia¹⁷⁴ dhe Oseti Jugorë¹⁷⁵ shpallën pavarësin pas konflikteve secesioniste me forcat Gjeorgjiane¹⁷⁶ ku trupat shkëputëse u ndihmuan dhe u mbështetën nga Rusia.¹⁷⁷ Trupat Ruse pushtuan

¹⁶⁷ Shaw, M. (2003). The Role of Recognition and Non-Recognition with Respect to Secession: Notes on Some Relevant Issues, in Secession in International Law, Julie Dahlitz ed, TMC Asser Press, p251-252.

¹⁶⁸ Lauterpacht, H. (1948). Recognition in International Law. Cambridge University Press, Cambridge.

¹⁶⁹ U.S. Department of State, <http://www.state.gov/p/eur/ci/kv/c24701.htm>, retrieved on March 1, 2009.

¹⁷⁰ Slovenian Presidency of the Council of the European Union, Special Permanent Council Presidency of the Council of the European Union, Special Permanent Council #702, EU Statement in Response to the Serbian Foreign Minister, H.E. Mr. Vuk Jeremic, February 19, 2008. Gjindet tek:

https://www.osce.org/documents/pc/2008/02/29784_en.pdf.

¹⁷¹ BBC News. Gjindet tek: <https://www.bbc.com/news/world-europe-10725744>.

¹⁷² Spanish Foreign Minister (2008). Miguel Angel Morotionos quoted in. <https://time.com/time/world/article/0,8599,1714413,00.html>, on February 19.

¹⁷³ DW News. <http://www.dw-world.de/dw/article/0,2144,3132996,00.html>.

¹⁷⁴ Parlamenti de facto i Abkhazisë miratoi një deklaratë të njëabshme të sovranitetit në: 23 korrik 1992.

¹⁷⁵ Oseti Jugorë miratoi deklaratën e tij të pavarësis në: 20 shtatot 1990.

¹⁷⁶ Burduli, Z., & Dolidze, A. (2003). Housing and Property Restitution Rights of Refugee and Displaced Persons. Oxford University Press, Oxford.

¹⁷⁷ Kakabadze, I. (1997). Russian Troops in Abkhazia: Peacekeeping or Keeping Both Pieces?, Perspectives on

territorin e Gjeorgjisë në gusht të 2008, duke justifikuar veprimin mbi mbrojtjen e popullsisë së Osetit Jugorë nga agresioni gjeorgjian dhe kanë njoftuar planet për krijimin e bazave të përheshme ushtarake në territorin e Osetit Jugorë.¹⁷⁸

Kundër të drejtës për vetëvendosje të Azbkhazisë dhe Osetit Jugorë qëndron tërësia territoriale e Gjeorgjisë. IIFFMCG (Independent International Fact-Finding Mission on the Conflict in Georgia) dhe bashkësia e përgjithshme ndërkombëtare mbështesin integritetin territorial të Gjeorgjisë, dhe pohojnë se në përputhje me parimin e uti possidetis juris (sic zotëroni sipas ligjit) – të aplikuar nga Komisioni Badinter pas shpërbërjes së SFRJ – nën ndarjet e tij territoriale nuk kanë të drejtë të shkëputjes.¹⁷⁹ Vlen të theksohet se kjo pikpamje është kundërshtuar për faktin se uti possidetis juris është relevant vetëm në një kontekst kolonial, duke bërë që të vihet në dyshim besimi i BE-së ndaj një parimi të tillë në këtë rast.

IIFFMCG insiston që shkëputja e njëashme e Kosovës, duhet të konsiderohet sui generis dhe jo një precedent për popujt e tjerë që aspirojnë në shtetëformim për të vepruar.¹⁸⁰ Të dy rajoneve u është dhënë një percaktim i brendshëm i gjerë deri në fillim të viteve 1990, që do të thotë se atyre mund tu lejohet vetëvendosja e jashtme vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. As Kosova, dhe as Abkhazia dhe Oseti Jugorë, bazuar në situatën aktuale të zhvillimeve politike, nuk kanë gjasa të pranohen si anëtarë të Kombeve të Bashkuara në të ardhmen e afërt, për shkak të kundërshtimit të anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Tim Judah, deklaroi se ajo qfarë e bënë Kosovën ndryshe nga vendet si Iraku, Afganistani apo Ruanda është vendndodhja e saj në zemër të Evropës.¹⁸¹

Central Asia Vol. II No 6. The Eisenhower Institute.

¹⁷⁸ Up in Flames (2009): Humanitarian Law Violations and Civilian Victims in the Conflict over South Ossetia, Human Rights Watch Report January 23.

¹⁷⁹ IIFFMCG, Vol. II, p. 143.

¹⁸⁰ IIFFMCG, Vol. II, pp. 139 f.

¹⁸¹ Judah, T. (2008), Kosovo: What Everyone Needs to Know. Oxford University Press, Oxford.

4.4. NAGORNO KARABAKH (ARMENI)

Në analizen krahasuese të ngjarjeve dhe fakteve thelbësore në konfliktet në Nagorno Karabakh dhe Kosovë mund të gjenden ngjashmëri dhe dallime të rëndësishme, kjo analizë përfshin paraqitjen e ngjarjeve thelbësore dhe fakteve rreth dy konflikteve, të cilat rrjedhën si rezultat i shpërbërjes së dy kornizave institucionale, si dhe zbulon dhe paraqet rezolutat e nxjerra nga OKB, dhe nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e cila funksionon brenda dhe përtej Evropës duke përfshirë shtetet e mëparshme të Bashkimit Sovjetik në strukturën e saj. Analiza krahasuese në konfliktin e Nagorno-Karabakh-it dhe Kosovës tejkalon vlerësimin e zhvillimeve aktuale politike në Kaukaz dhe Ballkan.

Pasqyrimet për strukturën dhe dinamikën e këtyre dy krizave mund të sigurojë një bazë teorike për identifikimin e hershëm dhe parandalimin e konflikteve ndërkombëtare që kanë potencialin e përshkallëzimit në katastrofa humanitare në shkallë të gjerë, sic kishte ndodhur me shqiptarët e Kosovës dhe etnin armene në Karabakh.

Në kohën sovjetike, Nagorno-Karabakhu ishte rajon autonom kryesisht me popullsi armene në Azerbejxhan. Në kohën e Jugosllavisë, Kosova ishte një provincë autonome e Serbis me popullësi kryesisht shqiptare. Armenët luftuan kundër azerbejxhanezëve në fillim të viteve 1990, ndërsa shqiptarët e Kosovës kundër serbëve në vitet 1998-1999. Nagorno-Karabakhu shpalli pavarësinë në vitin 1991. Administrata dhe forcat e sigurisë së Serbis u dëbuan nga Kosova nga NATO në vitin 1999, dhe vendi u administrua nga Kombet e Bashkuara.

Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008. Në janar të vitit 1989 me vendimin e Këshillit të Përgjithshëm të BRSS-së, veprimtaritë e Rajonit Autonom të Karabakhut përfunduan dhe themeluan një Komitet të Veçant Drejtues nën nënshtrimin e Bashkimit Sovjetik. Këtë status Nagorno-Karabakhu e mbajti deri në dhjetor të vitit 1991, kur referendumi i Pavarësisë u mbajt në Gjeorgji.

Ndërkohë, është me rëndësi jetike të merret në konsideratë që sistemi administrues ndërkombëtar ishte ngritur në Kosovë për të parandaluar humbjen e madhe të njerëzve. Megjithatë, bashkësia ndërkombëtare nuk ndërmori asnjë masë për të pezulluar luftën e zhvilluar nga Azerbejxhani, kur humbja e njerëzve ishte dukshëm e madhe (viktima rreth 24.000, dhe rreth 1 milion refugjatë dhe persona të privuar nga brenda). Në konfliktin e Kosovës viktimat ishin rreth 13.500 jetë të humbura.¹⁸² Lufta e Nagorno-Karabakhut përfundoi vetëm në vitin 1994, kur ushtria e Mbrojtjes e Nagorno-Karabakhut u detyrua të kalojë luftë në rajonet përreth për të garantuar sigurinë e territorit të Nagorno-Karabakhut

¹⁸² Fondi për të Drejtën Humanitare. (2015). Libri I Kujtimit të Kosovës.

dhe për ta bërë tokën të imunizuar nga arileria Azerbajxhaneze.

Rrethana e dytë e një tipari të veçant në Konfliktin e Kosovës është parahistoria e shkeljeve, të cilat ishin më pak të tensionuara dhe intensive sesa në konfliktin e Nagorno Karabakhut, ku përplasjet, shtypjet dhe shkeljet filluan dhe vazhduan gjatë gjithë periudhës së BRSS-së dhe arritën kulmin në fillimin e shekullit 21 (XXI) në Baku, Shushi, Kirovobad dhe Sumgait.

Përveq zhvillimeve të lartëcekura, të fakteve të dy konflikteve, është i rëndësishëm fakti që asnjë shtet nuk e ka njohur Karabakhun si një shtet të pavarur, por Kosovën e kanë njohur 116 shtete.¹⁸³ Në të dy konfliktet i shohim armenët dhe kosovarët duke argumentuar në favor të së drejtës së një populli për vetëvendosje, dhe Serbia dhe Azrbajxhani ngrisin argumentet e tyre mbi të drejtën e shtetit për të mbrojtur integritetin territorial të pretenduar. Në këto dy raste ka mospërputhje dhe standarde të dyfishta: Rusia një aleat i Serbis, nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Por, ndryshe nga qdo vend perëndimor, ajo njohu shtetet e shkëputura të Abkazisë dhe Osetit Jugorë pas luftës së tij me Gjeorgjinë në vitin 2008. Armenët simpatizojnë kosovarët, por nuk dëshirojnë të “mërzisin” rusët, kosovarët nuk duan të turperojnë përkrahësit e tyre perëndimor. Të tilla janë bazat e diplomacisë në zonën e muzgut të MN, në të cilat shtetet e vogla dhe kombet duhet të lëvizin për të siguruar interesat e tyre më të mirë.¹⁸⁴

¹⁸³ Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës. 25 Mars 2020. Njohjet.

¹⁸⁴ Judah, T. (2011). State of Independence. The Economist.

KAPITULLI V

FAKTORI NDËRKOMBËTAR NË RRJEDHËN E MOSMARRËVESHJES

5.1. REALIZMI

Realizmi në paraqitjetet e tij të ndryshme ka qenë dhe mbetet një teori thelbësore e MN. Realizmi klasik nga Thucydides (2003) deri te Hans Morgenthau¹⁸⁵ u përpoq të shpejonte politikën ndërkombëtare bazuar në tre parime kryesore: mungesa e një autoriteti qëndror i cili mund të imponojë rend (dmth anarki): ndryshimi i aftësive materiale dhe përceptimi i këtyre ndryshimeve: dhe së fundi një konceptim negativë, pesimist i natyrës njerëzore, i mishëruar në rrethin klasik nga dialogu Melian I Thucydides: “të fortët bëjnë atë që munden dhe të dobët vuajnë atë që duhet.”¹⁸⁶¹⁸⁷ Realizmi ka një traditë të gjatë intelektuale brenda studimit të MN, dhe ajo tashme është zhvilluar në një shkollë kryesore mendimesh me disa degë të ndryshme të teorisë.

Në një aspekt, këto shkolla të ndryshme kanë pasuruar shkollën realiste. Duke pasur parasysh pikëpamjen se thelbi i politikës është lufta për pushtet, realizmi pohon se vendet me udhëheqësit e tyre, nëse janë të kujdesshëm, janë praktikisht të detyruar ta bazojnë politikën e tyre të jashtme në ekzistencën e një botë, në të cilën fuqia është qelësi për mbijetesë kombëtare. Sipas Joshua Goldstein, nuk ka asnjë teori të vetme që mund të shpjegojë gamën e gjerë të ndërveprimeve ndërkombëtare, si konfliktuale, ashtu edhe bashkëpunuese.¹⁸⁸

Ai më tej pohoj se ekziston një kornizë teorike që tradicionalisht ka mbajtur një pozicion qëndror në studimin e MN. Goldstein e quajti këtë qasje: Realizmi.¹⁸⁹ Realizmi është shkollë e mendimit që shpjegon MN në lidhje me fuqinë. Ushtrimi i pushtetit nga shtetet ndaj njëri-tjetrit nganjëher quhet “realpolitik” ose “politikë e pushtetit”.¹⁹⁰ Nga këndvështrimi i realistëve, sistemi ndërkombëtar është anarkik,¹⁹¹ është anarkik sepse mardhëniet midis shteteve zhvillohen në mungese të një qeverie botërore. Kështu, MN kuptohen më së miri

¹⁸⁵ Morgenthau, J., H. (1978). *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*, Fifth Edition. Revised, New York.

¹⁸⁶ Thucydides, Cravley, R. (2004). *History of the Peloponnesian War*. Dover, Publications.

¹⁸⁷ Edhe pse teoritë e Morgenthau dhe Thucydides ishin të rrënjësura në batyrën e njerzore, teoria e Morgenthau ishte një teori e qartë, që merrej me dëshifrimin e ligjeve universal dhe të objekteve të politikës ndërkombëtare. Ndërsa Thucydides konsiderohet konvencional, dhe realist klasik, mënyra me të cilën athinasit e fuqishëm vuajnë nga humbja spektakulare ka sugjeruar lexime alternative. Shiko shembull Lebow (2001).

¹⁸⁸ Goldstein, J. (1999). *International Relations*, 3rd Ed, Washington, D.C. Longman, p. 53.

¹⁸⁹ Shih Referencën 188.

¹⁹⁰ Shih Referencën 188.

¹⁹¹ Griffiths, M. (1999). *Fifty Key Thinkers in International Relations*. Routledge, New York. p.1.

duke u përqendruar në shpërndarjen e pushtetit në mes shteteve.¹⁹² Pushteti është thelbësor për shpjegimin e MN dhe shpërndarjes së pabarabartë të pushtetit, nënkupton që arena e MN është një formë e “pushtetit të politikës”. Realistët besojnë se betejat në mes shteteve për të siguruar interes të tyre kombëtar shpesh në kundërshtim, janë veprim kryesorë në skenën ndërkombëtare.

Meqenëse qasja realiste beson gjithashtu se pushteti përcakton se cili vend mbizotëron, ata mendojnë se politika ka për qëllim rritjen e fuqisë, mbajtjen e pushtetit ose demonstrimin e fuqisë. Sidoqoftë, duke qenë se fuqia nuk është lehtësisht e matshme dhe nuk ka konsensus në mes shteteve për mënyrën e shpërndarjes, ajo kështu i kthen MN në një fushë të domosdoshme dhe vazhdimësi me kalimin e kohës.¹⁹³

Në përgjithësi, realistët morën përsipër ndjekjet e pushtetit të shteteve si pikenisje të tyre.¹⁹⁴ Ndjekja e pushtetit sjell në pah qendrën e forcës ushtarake brenda asaj fuqie dhe konfliktin që ajo do të krijojë në një botë me sovranitet të shumfishtë. Ndërsa nuk mohoi plotësisht një rol për moralin, ligjin dhe diplomacinë, realizmi shtoi stresin më të madh për fuqinë e armatosur si një instrument për ruajtjen e paqes.

Ata vendosën premium të lartë në përdorimin e balancit të fuqisë si një mekanizëm kryesor për rregullimin e konfliktit.¹⁹⁵ Përmes këtij mekanizmi, forca e padrejtë e një shteti do të kompensohej nga forca e shtuar ose aleancat e zgjeruara nga ana e të tjerëve. Përdorimi racional i pushtetit është një supozim thelbësor i realizmit.

Ai deklaroi që një shtet as nuk duhet të humbas fuqinë për qëllime periferike dhe as të ndjekë qëllime që nuk ka fuqi për ti arritur. Kjo nënkupton që fuqia aktuale, dhe ajo e mundshme e shtetit duhet të përshtatet në atë mënyrë që ti lejojë shtetit të arrijë synimet ose aspiratat e tij në sistemin ndërkombëtar në kohën më të shkurtër të mundshme dhe në minimumin e kostos. Kjo ishte ajo që Richelieu e cilësoi si “raison d’être” (arsyeja për të qenë) në politikë. Mosarritja e këtij akti balancues në përgjithësi do të rezultojë në paaftësinë e një shteti për të arritur objektivat e tij të deklaruara në sistemin ndërkombëtar.

¹⁹² Shih Referencën 101.

¹⁹³ Shih Referencën 101.

¹⁹⁴ Holliday, F. (1994). *Rethinking International Relations*. Macmillan, London. p.10.

¹⁹⁵ Shih Referencën 103.

5.1.1. KONSTRUKTIVIZMI: TEORI KONSTRUKTIVISTE E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Për dallim nga drejtimi teorik i mësipërm, I cili me gjithë dallimin ndërmjet disa autorëve dhe shkollave, ka përcaktuar qartë premisat e tij themelore, konstruktivizmi nuk mund të shqyrtohet në atë mënyrë. Ai nuk përmban ndonjë kategori të njësuar, që do të lidhte rrymat e ndryshme të konstruktivistëve, por sic pohojnë edhe vetë studiuesit, “bota është aq komplekse, saqë është e pamundur të krijohet një teori e njësuar e MN, duke refuzuar kështu paraprakisht qdo përpjekje për t’i futur ata në kuadër të një teorie të uniformuar.”¹⁹⁶

Qasja alternative për studimin e MN, e quajtur konstruktivizëm, është rritur jashtëzakonisht në popullaritet në 20 vitet e fundit. Konstruktivizmi përshkruhet më shumë si një qasje sesa një teori. Ashtu si feminizmi dhe postmodernizmi, origjina e tij qëndron në disiplina të tjera. Kur zhvendoset në thelbin e tij, nuk thotë asgjë për MN, por kur njeriu merr mësimet e tij për natyrën normative, identitetin dhe ndërveprimin shoqëror seriozisht, ai mund të ketë njohuri të mëdha në botën e MN.

Konstruktivizmi është i interesuar se si aktorët përcaktojnë interesat e tyre kombëtar, kërcënimet ndaj atyre interesave dhe mardhëniet e tyre me njëri-tjetrin. Realistët (dhe neoliberalistët) priren thjesht të marrin interesat e shtetit ashtu sic u është dhënë. Ndërsa, konstruktivizmi i vendos MN në kontekstin e mardhënieve të gjera shoqërore.¹⁹⁷

Ka shumë fillesa të hulumtimeve konstruktiviste. Një linjë e shquar shqyrton se si nderthuren interesat dhe identitetet e shteteve, si dhe si ato identitete formohen nga bashkëveprimet me shtetet e tjera.¹⁹⁸ Shembull, pse SHBA-të janë të shqetësuara kur Koreja e Veriut ndërton armë bërthamore, por jo kur prodhon Britania e Madhe? Realistët do të përgjigjeshin shpejt se Koreja e Veriut paraqet një kërcënim më të madh, megjithatë nga një prespektivë e pastër e fuqisë ushtarake, Britania e Madhe është një forcë ushtarake shumë më e madhe se Koreja e Veriut.

Megjithatë, askush nuk do të argumentojë që Britania e Madhe është një kërcënim për SHBA-të, pavarësisht sa armë bërthamore ndërton. Studiuesit konstruktivistë do të theksonin se ekziston një histori e përbashkët, aleanca e përbashkët dhe normatë e përbashkëta që u tregojnë amerikanëve dhe britanikëve se ata nuk janë një kërcënim për njëri-tjetrin edhe pse janë shumë të fuqishëm ushtarakisht. Identiteti i qështjeve të mundshme kundërshtarë, jo vetëm aftësive dhe interesave të tij ushtarake. Ky është një

¹⁹⁶ Vukadinovic, R. (2006). Mardhëniet Ndërkombëtare Politike. Kolegjin Universitar Victory, Prishtinë.

¹⁹⁷ Checkel, T. J. (1998). The Constructivist Turn in International Relations Theory. Cambridge University Press, Cambridge.

¹⁹⁸ Hall, B., R. (1999). National Collective Identity: Social Constructs and International System. Columbia.

refuzim I supozimit realist që shtetet duan gjithnjë më shumë sesa me pak fuqi dhe pasuri dhe supozimin se ndërqytetërimet shtetërore ekzistojnë në mënyrë të pavlefshme te një kontekst ndërveprimesh në mes shtetve.¹⁹⁹

Konstruktivistët mendojnë se këto identitete shtetërore janë komplekse, ndryshojnë dhe lindin nga bashkëveprimi me shtetet e tjera, shpesh përmes një procesi të socializimit. Disa studiues konstruktivist pohojnë se me kalimin e kohës, shtetet mund ta konceptojnë njera-tjetrën në atë mënyrë që të mos kenë rrezik nga një dilemë sigurie, gara armësh ose efektet e tjera të anarkisë. Ata tregojnë për Evropën si një shembull, një kontinent që ishte qendra e dy konflikteve ushtarake në gjysmën e parë të shekullit XX që vrau miliona njerëz. Në fund të këtij shekulli, lufta ishte bërë e paimagjinueshme. Identitetet evropiane tani janë gërshetuar me Bashkimin Evropian, jo me nacionalizmin e dhunshëm që qoi në dy Luftëra Botërore. Për konstruktivistët, politika e pushtetit, anarkia dhe shënimi I forcës ushtarake shpjegojnë këtë ndryshim. Regjimet e institucioneve, norma dhe ndryshimet në identitet janë shpjegime më të mira.²⁰⁰

Shtetet gjithashtu mund të arrijnë të vlerësojnë dhe lakmojnë konkurrencën si statusi ose reputacioni, të cilat janë koncepte shoqërore, jo materiale. Zvicrra, për shembull, vlerëson rolin e tij si një shtet neutral, jo I lidhur (nuk I përket BE-së dhe as NATO-së, dhe u bashkua me KB vetëm në 2002). Ky status si neutral I jep prestigj dhe fuqi Zvicrrës – jo fuqi materiale si para ose armë - por një fuqi normative për të ndërhyrë në mënyrë diplomatike në qështje të rëndësishme ndërkombëtare. Në mënyrë të ngjashme, politika e jashtme e Kandadsë përmban imperativat dhe kufijtë e saj të identitetit. Një fushë tjetër e hulumtimit konstruktiv gjithashtu mbështetet shumë në normat ndërkombëtare dhe fuqinë e tyre për të kufizuar veprimin e shtetit. Ndërsa realistët (dhe neoliberalistët) pretendojnë se shtetet marrin vendime të bazuara në një logjikë të pasojave, studiuesit konstruktivist theksojnë se ekziston një logjikë e fuqisë së përshtatshmërisë.²⁰¹ Konstruktivizmi është ende një qasje e diskutueshme për studimin e MN, por nuk mund të injorohet.²⁰²

¹⁹⁹ Wendt, A. (1992). *Social Theory of International Politics*. Cambridge.

²⁰⁰ Checkel, J. (2000). *Social Learning and European Identity Change*. Cambridge University Press, Cambridge.

²⁰¹ March, G. J., & Olsen, J. (1998). *The Institutional Dynamics of International Political Orders*. Cambridge University Press, Cambridge.

²⁰² James Fearon, Alexander Wendt (2002), *Rationalism v. Constructivism: A Skeptical View in Carlsnaes*. *Handbook of International Relations*, Sage Knowledge.

5.2. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR PËR MOSMARRËVESHJET TERRITORIALE

Karta e KB thotë: “të gjithë anëtarët do të përmbahen në mardhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimi ose përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shtet, ose në ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me qëllimet e Kombeve të Bashkuara”.²⁰³

Mosmarrëveshjet territoriale kanë kuptim domethënës në shoqërin ndërkombëtare për arsye se lidhen me të drejtën themelore të shteteve, sovranitetin dhe gjithashtu sepse janë të rëndësishme për paqen ndërkombëtare, sigurinë kolektive. E drejta ndërkombëtare ka mardhënie domethënëse me mosmarrëveshjet territoriale, sepse trajtojnë bazën e së drejtës ndërkombëtare; territorin e shtetit. E drejta ndërkombëtare bazohet në “subjektet” e së drejtës ndërkombëtare, të cilët kërkojnë një “territorë të caktuar” sic deklarohet në konventën e Montevideo-së të vitit 1933.

Neni 1 i Konventës së Montevideo-së për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve deklaron se “një subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet të ketë kualifikimet e mëposhtme: (a) popullësi të përhershme, (b) territorë, (c) qeveri, (d) aftësi për të hyrë në mardhënie me shtetet tjera”.²⁰⁴ “Në të drejtën ndërkombëtare dhe mardhëniet, prania e territorit është e rëndësishme sepse sovraniteti mbi territorin përcakton atë që përbën një shtet”.²⁰⁵ Prandaj, shkëlja e kufijëve të një vendi ose mosmarrëveshje territoriale, përbëjnë një kërcënim për sovranitetin e një shteti dhe të drejtën si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Mosmarrëveshjet territoriale nuk mund të ndahen nga e drejta ndërkombëtare, sepse baza e saj / tyre është në ligjin e kufijëve shtetëror, dhe për shkak të zgjidhja e saj e mundshme gjithashtu mbështetet në ligjin dhe Gjykatën Ndërkombëtare.

Pëlqimi i shteteve është baza e juridiksionit dhe gjykatave ndërkombëtare dhe rrjedhimisht mosmarrëveshjet në mënyrë shumë të dy shteteve nuk mund të vendosen pa miratimin e të gjitha shteteve në fjalë. Pa një pëlqim të tillë nuk mund të bëhet marrëveshje ose zgjidhje e pjesëshme e mosmarrëveshjes. Dispozitat në lidhje me juridiksionin dhe procedurat në statutet dhe rregullat e gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare shpesh paraqesin karakteristika specifike dhe unike.²⁰⁶

²⁰³ Karta e KB, Neni 2, Pika 4.

²⁰⁴ Montevideo Convention, Article 1.

²⁰⁵ Taylor Sumner, T., B. (2015). Territorial Disputes at the International Court of Justice. Duke Law Journal.

²⁰⁶ The Institute of International Law. (1999). Judicial and Arbitral Settlement of International Disputes Involving More Than Two States.

5.2.1. JURISPRUDENCA E ZGJEDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE TERRITORIALE

Kohët e fundit përdorimi i zgjidhjes së konflikteve është duke u rritur, duke u bërë më i sofistikuar dhe duke pasur sukses më shumë.²⁰⁷ Shumica e zgjedhjes së konflikteve përdor një palë të tretë, roli i të cilit është ndërmjetësimi në mes dy palëve në konflikt.²⁰⁸

Shumia e konflikteve të sotme ndërkombëtare kane një ose më shumë palë ndërmjetësimi që punojnë rregullisht për të zgjidhur konfliktin pa dhunë. Nuk ka asnjë rregull të vështirë dhe të shpejt që deklaron se qfar lloj palësh të treat ndërmjetesojnë llojet e konflikteve.

Aktualisht OKB është ndërmjetësuesi më i rëndësishëm në skenën botërore. Disa konflikte rajonale ndërmjetesojnë përmes organizatave rajonale, shteteve individuale, apo edhe individëve privatë.²⁰⁹ Shembull, ish presidenti i Kosta Rikës, Oscar Arias, fitoi qmimin Nobel për paqe në vitin 1987 për ndërmjetësimin e një marrëveshje shumpalëshe midis presidentëve të Amerikës Qendrore për t'i dhënë fund disa luftërave brutale në rajon.²¹⁰

Përfshirja e ndërmjetësit mund të ndryshojë. Disa ndërmjetësime janë rreptësisht teknike – një ndërmjetës mund të marrë rol aktiv, por në mënyrë të qëndrueshme neutral në orientimin e komunikimit ndërmjet dy shteteve, në mungesë të kanaleve të tjera të komunikimit.²¹¹ Në lehtësimin e komunikimit, një ndërmjetës dëgjon idetë e secilës palë dhe i paraqet ato në një mënyrë që pala tjetër mund t'i dëgjojë. Ndërmjetësi punon për të ndryshuar këndvështrimin e secilës palë për qështje të vështira.

Në këto role, ndërmjetësi është si përkthyesi në mes dy palëve, ose një therapist që i ndihmon ata të zgjidhin problemet psikologjike në marrëdhëniet e tyre.²¹² Nëse të dy palët bien dakord praktikisht që t'i përmbahen një zgjidhje të hartuar nga një ndërmjetës, procesi quhet arbitrash. Në atë rast, të dy palët paraqesin argumentet e tyre për arbitrin, i cili vendos për një zgjidhje “të drejtë”. Shembull, kur negociatorët serbë dhe boshnjak nuk mund të pajtoheshin se kush do ta merrte qytetin e Brcko, ata e kthyen qështjen në arbitrash, në vend se të mbanin Marrëveshjen e plotë të Dejtonit 1995.

Arbitrazhi shpesh përdor një panel prej tre personash, një i zgjidhur nga secila palë në mënyrë të njëanshme dhe një i treti për të cilin pajtohen të dy palët. Në 2002, një panel i tillë (me OKB-në duke zgjedhur anëtarin e tretë) përcaktoi kufirin Eritrean pas një lufte të

²⁰⁷ Lester R Kurtz (1999), *Encyclopedia of Violence, Peace and Conflict*, Cambridge

²⁰⁸ Goldstein, S., J & Pevehouse, C., J. (2006). *International Relations*, Seventh Edition. Priscilla McGeehon.

²⁰⁹ Shih Referencën 208.

²¹⁰ Child, J. (1992). *The Central American Peace Process, 1983-1991: Sheathing Swords, Building Confidence*. Boulder, CO: Lynne Rienner.

²¹¹ Stein, G., J. (1989). *Getting to the Table: The Processes of International Prenegotiation*. Sage Publications, Canadian International Council.

²¹² Crocker, A., Ch. & Hampson, O., F. & All, P. (2004). *Taming Intractable Conflicts: Mediation in the Hardest Cases*. United States Institute of Peace, USA.

kushtueshme. Ekzistojnë justifikime të panumërta që shtetet kanë bërë për pretendimet e tyre territoriale, nga afërsia deri te titujt historik, Thomas Franck flet me një të vërtetë të përrjetshme kur tregon se, “për cdo parim, ka një kundërveprim”.²¹³ Ndërsa pretendimet historike janë më të zakonshmet, jurisprudenca e arbitrit të mosmarrëveshjeve territoriale ka krijuar një hierarki parimesh për të cilat janë thirrur në mënyrë të vazhdueshme. Dy parimet kryesore të rëndësishme këtu janë traktatet dhe kontrolli efektiv: ekzistojnë parime të tjera të fuqishme juridike, sic janë “uti possidetis”,²¹⁴ parime të cilat janë të rëndësishme për llojin e territorit të kontestuar në këtë tezë.

Traktatet dhe marrëveshjet përfaqsojnë të drejtën dhe legalizimin nga të gjitha arsyetimet për pretendimet territoriale, dhe gjithashtu mund të argumentojnë disa nga arsyetimet e tjera. Traktatet janë të ngjashme me kontratat private, meqenëse ato krijojnë të drejta dhe detyra ligjore, dhe si të tilla janë detyruese për nënshkruesist.

Neni 26 i Konventës së Vjenës mbi Ligjin e Traktateve (i cili kodifikon ligjin e mëparshëm zakonor mbi traktatet) thotë që “cdo traktat në fuqi është detyrues për palët në të dhe duhet të kryhet prej tyre me mirëbesim.”²¹⁵ Kështu, pretendimet mbi territorin të cilat bazohen në traktate të vlefshme kanë mbështetjen e madhe të së drejtës ndërkombëtare. Në fakt, në një përmbledhje të jurisprudencës së GJND-së, traktatet renditen si faktori kryesor vendosës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve territoriale - aty ku ekziston një traktat ekzistues, marrëveshja është e mbështetur.

Ato shtete që mund të tregojnë prova të një traktati që u cakton territorin e diskutueshëm atyre kanë pretendimin më të fortë për territorin, duke ndjekur jo vetëm ligjin zakonor, por edhe konventat ndërkombëtare. Ushtrimi i sovranitetit, i siguron një shteti bazë për një kërkesë ligjore legale, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha ushtrimet e sovranitetit në të gjitha kohërat historike konsiderohen nga gjykatatë. Koncepti i datës kritike e parandalon këtë. “Data me të cilën të drejtat e palëve për një mosmarrëveshje territoriale janë kristalizuar aq shumë sa që ato që ata bëjnë më pas nuk ndikojnë në pozitën juridike.”²¹⁶ Kjo nënkupton se nga këndvështrimi juridik, ushtrimet e të shfaqjes sovranitetit pas mosmarrëveshjes nuk janë juridikisht të rëndësishme.²¹⁷

Ekziston një aspekt tjetër ligjor i kohës në të cilin aktet e ndodhura duhet të zbatohen, në

²¹³ Franck, M., Th. (1983). The Strategic Role of Legal Principles in the Falklands War. The American Journal of International Law.

²¹⁴ US Legal Definitions, Uti possidetis Law and Legal Definition. Gjetet tek: <https://definitions.uslegal.com/u/uti-possidetis/>.

²¹⁵ Konventa e Vjenës mbi Traktatet, Neni 26, pika 3.

²¹⁶ Aust, A. (2005), Handbook of International Law. Cambridge University Press, Cambridge.

²¹⁷ Për sa kohë që shtetet i mbajnë pretendimet e tyre pas shfaqjes – kundërshtari duhet të vazhdojë të protestojë.

vend që të zbatohet e drejta ndërkombëtare në mënyrë retrospektive.

5.3. KOMUNITETI NDËRKOMBËTAR DHE KOSOVA

Megjithëse komuniteti ndërkombëtar ka qenë i përfshirë në Kosovë për më shumë se dy dekada, roli i tij nuk ka qenë gjithmonë për pavarësi / ose pro-Kosovë. Gjatë këtyre dy dekadave (duke filluar rreth 1990), komuniteti ndërkombëtar ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe shpesh kompleks në Kosovë dhe Ballkan në përgjithësi. Konflikti i Serbëve dhe Shqiptarëve mbi Kosovën nuk ishte qështje parësore për komunitetin ndërkombëtar, sepse kishte raste të ngjashme.²¹⁸

Por me shpërbërjen pasuese të Jugosllavisë në fillim të viteve 1990 - Kosova ishte një nga tetë njësitë federale që përfshinte Jugosllavinë, dhe me fillimin e luftës në Slloveni dhe Kroaci, Komuniteti Ndërkombëtar (qeveritë perëndimore) nuk kishte zgjidhje tjetër përveç së të përfshihej në këtë qështje.

Tim Judah, argumenton se një nga arsyet që fuqitë perëndimore përdorën si pretekst për tu përfshirë në mënyrë ushtarake në Kosovë (dhe që nga ajo kohë janë prezente në mënyrë ushtarake), ishte parandalimi i një katastrofe humanitare pasi rreth 250.000 njerëz ishin shpërngulur nga Kosova në fillim të vitit 1999.²¹⁹ Një nga arsyet kryesore të ndërhyrjes së Perëndimit në Kosovë ishte përvoja e kaluar e cila kishte ndodhur vetëm katër vite para luftës së Kosovës, në Srebrenicë të Bosnjës dhe Hercegovinës, ku ishte kryer një masakër e cila nuk ishte parandaluar.

Perëndimi nuk dëshironte të shihte një Srebrenicë tjetër në Kosovë dhe ndërhyri. Judah shpjegon se udhëheqësit e fuqive kryesore perëndimore u “bazuan” në rastin e Srebrenicës, ky ishte faktori kryesor që i motivoi Bill Clintonin, Tony Blair dhe udhëheqësit tjerë perëndimorë të ndërmarrin veprime vendimtare. Ideja ishte të parandalohet një Srebrenice tjetër (ku 7.000 Boshnjak u masakruan) duke u’a bërë të qartë palëve se asnjë veprimtari e tillë nuk do të lejohej.

Kur ishte fjala për qështjen e Kosovës, administrata e Presidentit Amerikan “Bush I” po merrte një qasje tjetër. Në fund të vitit 1992, ajo dërgoi një paralajmërim me fjalë të forta – të ashtuquajturën “paralajmërimi i krishtlindjeve” - Presidentit të Serbis Slobodan Milosevic dhe ushtrisë së tij, duke e paralajmëruar atë se “në rast të një konflikti në Kosovë të shkaktuar nga veprimet serbe, SHBA-të do të përgaditen të përdorin forcën ushtarake

²¹⁸ Zimmermann, W. (1996). *Origins of a Catastrophe: Yugoslavia and its Destroyers – America’s Last Ambassador Tells What Happened and Why*. New York Times Books.

²¹⁹ Judah, T. (2008). *Kosovo: What Everyone Needs to Know*. Oxford University Press, Oxford.

kundër serbëve në Kosove dhe në Serbi.”²²⁰ Paralajmrimi doli të ishte pothuajse profetik shtatë vite më vonë kur NATO, e udhëhequr nga SHBA-të, nisi sulmet ushtarake kundër forcave serbe në Kosovë dhe në Serbi. Danner argumenton se nderhyrja e SHBA-ve në Kosovë, nuk ishte vetëm një qështje humanitare, por edhe një llogaritje gjeopolitike dhe përfundimisht, prestigj ndërkombëtar. Javier Solan, Sekretar I Pergjithshem I NATO-së, gjithashtu në artikullin e tij të vitit 1999 “Suksesi I NATO-së në Kosovë”, kur filloi fushatën ushtarake kundër Serbisë në 1999, thekson se kjo ishte “një sfidë e madhe” dhe se NATO, një aleancë mbrojtëse, filloi një fushatë ushtarake me qëllim të “shmangies së një tragjiedie humanitare jashtë kufijëve të saj.”²²¹

5.3.1. PAS NDËRHRYJES NË KOSOVË

Ndërhyrja ushtarake e NATO-së në Kosovë në mars të vitit 1999 ishte një ngjarje fillestare që pati pasoja të gjata ligjore dhe praktike për kufijtë e sovranitetit shtetërorë perballë shtypjes ekstreme të një grupi etnik, zhvillimit të një doktrine të re të ndërhyrjes bazuar në vlerat thelbësore perëndimore dhe vendosjes së misionit të madh paqeruajtës dhe administrativë në historin e Kombeve të Bashkuara, dhe më vonë, të Bashkimit Evropian.²²² Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, fillimisht hezitoi të aprovojë qdo lloj ndërhyrje ushtarake në Kosovë për shkak të kundërshtimit të antarëve të përhershëm, Rosisë dhe Kines, dhe e beri atë de fakto më pas duke aprovuar Rezolutën 1244 të Keshilit të Sigurimit, e cila autorizoi shtetet anëtare të KB për të dërguar një “forcë civile dhe ushtarake ndërkombëtare” në Kosovë.²²³

UNSCR 1244 gjithashtu kerkoi tërheqjen nga Kosova të të gjitha institucioneve civile dhe ushtarake serbe, duke krijuar një boshllëk juridik dhe administrativë që duhet të zgjidhej. Për këtë qëllim, KB krijuan Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në fund të vitit 1999, përgjegjësia për krijimin dhe promovimin e “autonomisë thelbësore” dhe “vetëqeverisjes” për Kosovën “në pritje të një zgjidhje përfundimtare” (UNSCR 1244). Pas rindërtimit të pas luftës së infrastruktures kryesore dhe institucioneve ekonomike, UNMIK-u më pas do të dorëzonte ngadalë funksionet administrative institucioneve të reja “të përkohshme” që do të ngriheshin pas

²²⁰ Danner, M. (1999). Endgame in Kosovo: Ethnic Cleansing and American Amnesia, The New York Review of Books.

²²¹ Solana, J. (1999). NATO's Success in Kosovo. Council on Foreign Relations.

²²² Janjic, D. (2011). The Status of Kosovo, Kosovo: Independence, Status, Perspectives: Adjusting Regional Policies of Ethnicity and Borders. Ravenna: Longo Print.

²²³ NATO and Kosovo: UN Resolution 1244 (1999). Gjindet tek:
<https://www.nato.int/kosovo/docu/u990610a.htm>.

zgjedhjeve. NATO do të ishte përgjegjëse për garantimin e sigurisë, dhe ajo vendosi “forcat e saj ushtarake ndërkombëtare të sigurisë”, Forcën e Kosovës (KFOR), pasi serbët ishin të detyruar të tërhiqeshin nga Kosova. NATO, e bëri këtë jo vetëm nën autoritetin e Rezolutës 1244, por edhe nën autoritetin e vetë të “Marrëveshjes Teknike Ushtarake” që ajo kishte nënshkruar me Republikën Federale të Jugosllavisë me 9 qershor 1999, e cila parashikonte tërheqjen graduale të forcave serbe / RFJ, për tu zëvendësuar me forcat e NATO-së / KFOR.²²⁴

Në raportin e vitit 2005, nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave, të titulluar “Kosova: Drejt Statusit Përfundimtar”, eksploron zgjidhje të mundshme për statusin e Kosovës dhe rolin që do të luante Bashkësia Ndërkombëtare në një proces të ardhshëm të zgjidhjes të statusit. Raporti pretendon se Komuniteti Ndërkombëtar nuk ka përcaktuar udhëzime të qarta politikash për një strategji të mundshme daljeje, dhe kishte ndërmarrë vetëm hapa të vegjël dhe provues drejt zhvillimit të një “Kosove: në Drejtim.”

UNMIK-u kishte luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e institucioneve të Kosovës dhe fuqizimin e tyre për të drejtuar (disa) nga punët e tyre, por për shkak të udhëzimeve nga Zyra Ligjore e KB në New York dhe kufizimeve të qenësishme të Rezolutës 1244, ai nuk kishte arritur të adresonte qështje të attributeve shtetërore dhe sovranitetit. Kishte pozicion të palakmueshëm të një organizate që ishte angazhuar në një aktivitet të komb-ndertimit për një entitet, statusi i së ardhmes i të cilit si komb i pavarur nuk ishte i garantuar.²²⁵ Por meqenëse ishte e nevojshme të fillohej me krijimin e institucioneve të vetëqeverisjes nga fillimi, UNMIK-u vendosi të hartojë, në koordinim me aktorët politikë vendorë, një “Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme”, të cilën më pas e aprovoi. Korniza Kushtetuese, duke tërhequr legjitimitetin e saj nga Rezoluta 1244, ishte hartuar në atë mënyrë që të dukej si kushtetutë e një shteti Sovran, por pa asnjë nga gjurmët që e bëjnë atë shtet Sovran.

Ajo përcaktonte “vetëqeverisjen” dhe “përgjegjësit lokale”, por autoriteti i fundit ishte në duart e Përfaqesuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB, kreut të UNMIK-ut. Elementi më i rëndësishëm i Kornizës Kushtetuese ishte që lejonte zgjedhje të lira, të ndershme, dhe formimin e një qeverie të re për të marrë përsipër disa nga funksionet që UNMIK-u kishte mbajtur më parë. Në analizën e tij të vitit 2011 për misionet ndërkombëtare pas UNMIK-ut në Kosovë, “EULEX-I dhe Gordian Knot I Kosoves”, Adam Balcer shqyrton punën e UNMIK-ut, rezultatet e tij dhe trashëgimin e tij në Kosovë. Tema

²²⁴ NATO and Kosovo: Military Technical Agreement – 9 June 1999. Gjetet tek:

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>.

²²⁵ Andreopolos, J.M.G. (2011). What Next for Self-Determination?: Kosovo's Quest for Independence and the ICJ Opinion. Ravenna: Longo Print.

thelbësore në analizën e tij është se UNMIK-u në thelb nuk ishte në gjendje të përmbushte me sukses mandatin e tij në ndonjë mënyrë kuptimplote. Ishte i suksesshëm në organizimin e zgjedhjeve dhe krijimin e institucioneve të vetëqeverisjes, por ishte i pasuksesshëm për t'i ndihmuar ato të zhvilloheshin në institucione funksionale dhe efektive.²²⁶

UNMIK-u ngriti gjykatat dhe sistemin e drejtësisë, themeloi Policinë e Kosovës dhe kishte një pjesë përbërëse të konsiderueshme të Policisë së vetë, por ajo nuk ishte në gjendje të krijojë dhe të ruajë sundimin e ligjit (veqanërisht kur bëhej fjalë për krimin e organizuar dhe korrupsionin). Dhe së fundi, ishte i suksesshëm në krijimin e shtyllave kryesore të një ekonomie të tregut të lirë, por nuk ishte në gjendje të përmirësonte kushtet e jetesës së një numri të madhë të Kosovarëve.

King dhe Whit Pricedo, të dy shërbyes të UNMIK-ut në Kosovë, në librin e tyre “Si dështoi Bota në Kosovë”, shqyrtojnë sukseset dhe dështimet e UNMIK-ut, të cilat, përkundër një angazhimi të madh të burimeve dhe mbështetjes së forcave të NATO-së, në fund dështuan në arritjen e qëllimeve të tyre dhe zbatimin e mandatit të tyre në Kosovë. Autorët argumentojnë se kjo ishte për shkak se UNMIK-u ishte i gatshëm të merrej me “pandëshkueshmërinë e perceptuar” të një “klasë të madhe kriminelësh dhe militantësh”. UNMIK-u kishte avantazhin e qartë të fuqisë së fortë, pasi komandonte forcë të madhe fizike, por nuk ishte në gjendje ose nuk dëshironte ta përdorte atë për të arritur qëllimet e tij sepse “vendosi një qmim më të lartë për të shmangur viktimat, sesa për të pohuar vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare.”²²⁷

UNMIK-u kishte sukses në ndërtimin e rrugëve, miratimin e një kodi të ri ligjor dhe krijimin e autoritetit tatimor, por asgjë nuk ishte aq shkatërruese për imazhin e tij dhe perceptimin e tij nga Kosovarët, si të ashtuquajturat “institucione paralele serbe dhe toleranca e dukshme e UNMIK-ut ndaj tyre. Kjo nuk ishte askund më e dukshme se në Mitrovicë / Veri të Kosovës, që u bë skenë trazirash dhe konfliktesh mes qytetarëve të saj shqiptarë dhe serbë, gjë që përfundimisht qoi në ndarjen e saj përgjate vijave etnike (serbët u zhvendosën në masë të madhe në veri të Kosovës).

²²⁶ Balcer, A. (2011). EULEX and the Gordian Knot of Kosovo. Ravenna: Longo.

²²⁷ King, I., & Mason, W. (2006). Peace at any Price: How the World Failed Kosovo. Cornell University Press, New York.

5.3.2. PROCESI I ZGJEDHJES SË STATUSIT FINAL

Të ballafaquar më rritjen e presionit të brendshëm nga shqiptarët e pakënaqur, dhe i ngarkuar me detyrën e veshtirë të përgaditjes së Kosovës për procesin e zgjidhjes përfundimtare, UNMIK-u vendosi të fillojë një strategji politike që synonte përgaditjen e Kosovës për negociatat e statusit të ardhshëm të quajtur “Standardet para statusit”. Zyrtarisht zbatuar në 2002, “Standardet para statusit” do të përcaktonte qartë kriteret e përcaktuara si për UNMIK-un ashtu edhe për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Përkohshme përpara se të fillonin ndonjë bisedë serioze për statusin.

Të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të zbautuara në mënyrë të dobët, “standardet para statusit” bënë pak për të përmirësuar standardet e qeverisjes: në 2004 ato u zëvendësuan me një strategji të re, të quajtur “Standardet dhe Statusi”. Ideja ishte që të përmirësoheshin këto të ashtuquajtura “standarde” paralelisht me procesin e statusit, një kërkesë e përherëshme nga partitë politike me shumicë shqiptare.²²⁸

Trazirat e rënda në 2004 dhe një fillim i ngadaltë për strategjinë “Standardet dhe Statusi”, e benë të qartë për Komunitetin Ndërkombëtar se Kosovarët donin të zgjidhnin statusin e tyre politik dhe të vazhdonin me jetën e tyre. I dërguari special I KB, Kai Eide, në raportin e tij gjithëpërfshirës për Kosovën të vitit 2005 thekson: Strategjia “Standardet dhe Statusi” ishte e dobishme dhe nuk duhet të braktiset, por qëllimet e saj ishin “ambicioze” dhe ato “nuk mund të permbushen në një kohë të shkurtër.” Megjithëse Eide arriti në përfundim se zbatimi i këtyre standardeve ishte i “pabarabartë”, kishte ardhur koha për të “filluar procesin për adresimin e statusit të ardhshëm të Kosovës”.²²⁹ Duke qenë të vetëdijshëm se koha po mbaronte në Kosovë, Sekretari I Pergjithshëm i KB, Kofi Annan, emëroi ish presidentin finlandez Marti Ahtisaar me 10 qershor 2005 si “të dërguarin special për procesin e statusit të ardhshëm për Kosovën”, veprim i cili u mbështet nga Këshilli i Sigurimit.²³⁰ Sidoqoftë, shpejt u bë e qartë se Ahtisaari nuk do të kishte autonomi të plotë për të vendosur rregullat themelore dhe kornizën për Procesin e Statusit të Ardhshëm: do të ishte Grupi i Kontaktit, një grup joformal i fuqive kryesore perëndimore plus Rusia, i formuar për të lehtësuar diskutimet mbi qështjet që i përkasin Ballkanit, që do të zhvillonte shfaqjen në sfond. Ahtisaari do të kishte autonomi në drejtimin e negociatave dhe vendosjen e ritmit të tyre, por Grupi i Kontaktit do të siguronte kornizën aktuale për vetë

²²⁸ Dzihic, V., & Kramer, H. (2009). Kosovo After Independence: Is the EU's EULEX Mission Delivering On Its Promises?. Fried Ebert Stiftung, Berlin.

²²⁹ Eide, K. (2005). A Comprehensive Review of the Situation in Kosovo, UN Security Council Report S/2005/635. New York.

²³⁰ Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's future status, United Nations Office of the Special Envoy for Kosovo, 26 Mar, 2007. Gjindet tek: <http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>.

negociatat.²³¹ Kështu ndodhi kur ai nxorri të ashtuquajturën “Parimet Udhëzuese” në nëntorë të 2005, dhe deklarata ministrore e Londrës e 31 Janarit 2006.²³² “Parimet Udhëzuese” ishin një tërësi prej dhjetë parimesh që Grupi i Kontaktit vendosi në menyrë që të infomojë të gjitha palët për rezultatin e mundshëm të negociatave: ata përjashtuan ndarjen, një kthim në situatën para 23 Marsit 1999 (fillimi I fushatës ajrore të NATO-së, duke nënkuptuar se nuk mund të ketë kthim të Kosovës në Serbi), ai u bëri thirrje palëve të krijojnë ekipet e tyre negociuese dhe të veprojnë në “mirëbesim dhe në menyrë konstruktive”.²³³ Deklarata e Ministrisë së Londrës e Janarit 2006, dëshmojë se ishte interesante: ajo përseriti parimet e njejta nga dokumenti i mëparshëm, por gjithashtu prezantoi dy tema kryesore që do të formesonin punën e Presidentit Ahtisaari më vonë. Përkatesisht, deklarata I bëri thirrje Beogradit të “mbante në mendje se zgjidhja duhet ndër të tjera të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës”, dhe gjithashtu i bëri të qartë Beogradit se “politikat e tyre shkatërruese të së kaluarës qëndrojnë në zemër të problemit aktual”.²³⁴ Gjuha e qartë e përdorur në deklaratën e ministrisë në Londër, ishte një zhvillim i rëndësishëm sepse Rusia, një aleat tradicional i serbis, nënshkroi deklaratën në nivelin e ministrit të jashtëm.²³⁵

Ahtisaari nuk hargjoi kohë, ai organizoi disa takime të nivelit të lartë midis dy palëve dhe më pas vazhdoi të organizojë takime të nivelit të ekspertëve për “qështje teknike të shqetësimit të ndërsjellë”. Ato përfshinin, por nuk u kufizuan vetëm në decentralizimin dhe trashëgiminë kulturore, të drejtat e komunitetit, qështjet e borgjit dhe financave sovrane. Çuditërisht, disa nga propozimet e Ahtisaarit për statusin e ardhshëm të Kosovës, u diskutuan vetëm midis Ahtisaari-t, Grupit të Kontaktit, BE-së, NATO-së dhe organizatave tjera ndërkombëtare: ato nuk u dorëzuan palëve për negociata ose konsultime.²³⁶ Ndërsa negociatat po mbaronin dhe Ahtisaari po përgaditej t’i dorëzonte propozimet e tij Grupit të Kontaktit për t’u “filtëruar”, Rusia po shfaqte shenjat e para të mospajtimit me rezultatet e procesit. Ajo kishte provuar në heshtje të drejtonte Ahtisaarin dhe palët drejt zgjatjes së procesit të negociatave, palët kishin arritur në një bllokim në fund të vitit 2006 pas një viti e gjysmë negociatash, dhe po aludonte se nuk do të ishte e gatshme të pajtohej për një

²³¹ International Crisis Group. Kosovo Status: Delay is Risky, (2006), gjindet tek: <http://www.crisisgroup.org/en/regions/>.

²³² U.S. Department of State. Statement by the Contact Group on the Future on Kosovo. Gjindet tek: <http://2001-2009.state.gov/p/eur/rls/or/62459.htm>.

²³³ Guiding Principles of the Contact Group for a settlement of the status of Kosovo, Office of the Special Envoy of the Secretary-General of the United Nations for the Future Status Process for Kosovo.

²³⁴ U.S. Department of State. Statement by the Contact Group on the Future on Kosovo.

²³⁵ Dzihic, V., & Kramer, H. (2009). Kosovo After Independence: Is the EU's EULEX Mission Delivering On Its Promises?. Fried Ebert Stiftung, Berlin.

²³⁶ International Crisis Group. (2006). Kosovo Status: Delay is Risky.

zgjidhje të imponuar për Serbin.²³⁷ Kur Ahtisaari përfundoi bisedimet dhe i dorëzoi propozimet e tij zyrtare Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, SHBA-të dhe vendet tjera perëndimore po bënin presion për një vendim të shpejt, nga frika se status quo-ja mund të mos zgjasë gjatë. Rusia, megjithatë ishte e bindur që negociatat nuk ishin shterur. Retorika e saj u ngurtësua dhe përparësitë ndryshuan, Rusia filloi të kritikojë hapur Ahtisaarin, duke i quajtur negociatat e tij “të cekëta” dhe “të shkurtuara”.

Ajo kërkoj bisedime të reja dhe lindi idenë e një procesi të ri, me një ndërmjetës të ri.²³⁸ E nxitur nga mbështetja ruse, Serbia vazhdoi kundërshtimin e propozimeve të Ahtisaarit, duke kërkuar që bisedimet të vazhdonin. Ashtu si Rusia, edhe Serbia sulmoi besueshmërinë dhe paanshmërinë e Ahtisaarit, duke argumentuar se për shkak se ai ishte “i paanshëm”, bisedimet ishin një dështim dhe propozimi i tij ishte i papranueshëm.²³⁹

Kosova nga ana tjetër ishte e kënaqur që Propozimi Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i njohur gjithashtu si “Plani i Ahtisaarit”, i cili propozoi pavarësinë për Kosovën, përveq emrit. Zyrtarët e lartë të Kosovës sinjalizuan pranimin e tyre të planit.²⁴⁰ Megjithatë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Moon shprehu mbështetjen e tij për rekomandimet e të dërguarit të tij, dhe zyrtarisht ia përcolli Propozimin Gjithpërfshirës Këshillit të Sigurimit, nuk kishte asnjë marrëveshje në Këshill, kështu që nuk u morë asnjë veprim.²⁴¹ Të gjendur perballe kundërshtimit të fortë rus në Këshillin e Sigurimit, dhe një Serbie intriguese në terren, SHBA-të dhe aleatet e tjerë perëndimorë vendosën të provojnë një raund tjetër negociatash, me ndërmjetës të rinj, deri sa ata “hartojnë mënyra për të mbështetur kalimin e Kosovës në pavarësinë e kushtëzuar pa qenë nevoja për mbështetjen e Këshillit të Sigurimit”.²⁴²

Përpyekjet e SHBA-ve për të siguruar një mbështetje të gjerë të BE-së u irrituan nga hezitimi i disa kryeqyteteve evropiane: BE kishte shpresuar për një mandatë të qartë të Këshillit të Sigurimit për misionin e tij ambicioz të Sundimit të Ligjit / Zyra civile Ndërkombëtare e paraparë të merrte përsipër kompetencat nga UNMIK-u, kështu që u vendos që një përpjekje e fundit për një zgjidhje të negociuar mund të ishte rruga e mesme për të dalë nga bllokimi. Si rezultat, Këshilli i Sigurimit autorizoi negociatën të reja dhe u bëri thirrje SHBA-ve, BE-së dhe Federatës Ruse që të udhëheqin procesin. E ashtuquajtur

²³⁷ International Crisis Group . (2007). Kosovo: No Good Alternatives to the Ahtisaari Plan.

²³⁸ Shih Referencën 237.

²³⁹ Hamilton, D. (2013). Serbs and Albanians await U.N. Plan for Kosovo. The Washington Post.

²⁴⁰ Shih Referencën 235.

²⁴¹ Letter Dated 26 Marcy 2007 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council: Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's future status. United Nations Security Council, New York.

²⁴² International Crisis Group . (2007). Kosovo Countdown: A Blueprint for Transition.

“Troika”, një fjale ruse që nënkupton një grup prej tre, i cili kishte një mandatë të eksploronte qdo rrugë të mundshme në kërkim të një zgjidhjeje të negociuar, por ishte e kufizuar në një kornizë kohore prej vetëm katër muajsh.²⁴³ Troika filloi punën e saj pothuajse menjëher, por u përball me “perspektivë të zymtë” dhe detyrën e pamundur për të bindur Kosovën të rinegociojë atë që ajo tashmë kishte pranuar dhe e konsideroi një lëshim të madh. Troika thirri palët në disa takime, por nuk ishte në gjendje të bënte ndonjë përparim domethënës: ajo raportoi përsëri në Këshillin e Sigurimit me 10 dhjetor 2007, dhe theksoi se qëndrimet e palëve mbeten diametralisht të kundërta sepse asnjë palë nuk ishte e gatshme të jepte “për qeshtjen themelore të sovranitetit”.²⁴⁴

5.3.3. KOSOVA SHPALLË PAVARËSINË

SHBA-të dhe aleatët perëndimorë, pasi kishin përulur kërkesat ruse për më shumë bisedime në mes të presionit në rritje të shqiptarëve të Kosovës për qartësi në pavarësinë e tyre, tani ishin gati për të kaluar përtej Këshillit të Sigurimit. Ndërkohë në katër muajt e fundit të asaj periudhe ishte shpenzuar shumë kohë duke përgaditur Kosovën për shpalljen e ardhshme të pavarësisë, ndërsa njëkohësisht lobonte në vendet skeptike evropiane për mbështetjen e tyre. BE tani ishte e gatshme të mbështeste një deklaratë të pavarësisë së Kosovës duke vendosur misionin e saj për Sundimin e Ligjit pa autorizim të qartë nga Këshilli i Sigurimit.²⁴⁵

Zgjedhjet e nëntorit 2007 në Kosovë prodhuan një fitues të qartë, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me një mandatë të fortë për të udhëhequr vendin drejt pavarësisë: sidoqoftë, një koalicion në mes PDK-së dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), u formua si një shfaqje uniteti në një kohë vendimtare për vendin.

Kosova shpalli pavarësinë e saj me 17 Shkurt 2008 gjatë një mbledhje të veçantë të Parlamentit të Kosovës. Ata ranë dakord për të zbatuar Zgjidhjen Gjithpërfshirëse të Statusit (“Plani i Ahtisaarit”) dhe ftoi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit / Zyren Civile Nderkombetare për të ushtruar disa funksione ekzekutive me mandate të Ahtisaar-it gjatë periudhës kalimtare të “pavarësisë së mbikqyrur” të saj.²⁴⁶ Pasi njohja e shpejte nga SHBA-të, Mbretëria e Bashkuara, Gjermania, Australia, Japonia dhe vendet e tjera perëndimore, Serbia e quajti atë “një veprim të paligjshëm”, dhe Rusia njoftoi se nuk

²⁴³ Vucheva, E. (2013). International Troika Ups Efforts to Break Kosovo Deadlock.

²⁴⁴ Letter Dated 10 December 2007 from the Secretary-General to the President of the Security Council: Report of the European Union/United States/Russian Federation Troika on Kosovo.

²⁴⁵ International Crisis Group. (2007). Kosovo Countdown: A Blueprint for Transition.

²⁴⁶ International Crisis Group. (2008). Kosovo's First Month.

do ta njohë Kosovën. Kosova e cilesonte shalljen e pavarësisë të ligjshme dhe të justifikuar, dhe vazhdoi që vetë procesi ishte “i koordinuar” dhe “shumëpalësh”. Duke ju bërë thirrje shteteve të tjera që ta njohin këtë shpallje, dhe duke i njoftuar se ajo ishte duke u bashkuar me “familjen e madhe të shteteve sovrane”.²⁴⁷

Kosova shpalli pavarësinë e saj me mbështetjen e Bashkësis Ndërkombëtare, dhe e bëri këtë pasi e kaloi procesin e vështirë të ndërtimit të kombit nën maskën e një territori të administruar nga OKB, dhe pas bisedimeve të gjata dhe të veshtira me ish shtypësin e saj. Mbështetja e Bashkësisë Ndërkombëtare (kryesisht SHBA-të dhe aleatet Evropian) për pavarësinë e Kosovës nuk ishte automatike dhe e sigurtë. Mund të argumentohet se duke miratuar Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB dhe duke zvarritur procesin e statusit për gjashtë vite para se të fillonte me seriozitet, komuniteti ndërkombëtar ishte ambivalentë në rastin më të mire ndaj Kosovës.

Megjithatë me kalimin e kohës, u bë e qartë se pavarësia ishte e vetmja zgjidhje e zbatueshme, ndërsa Presidenti Ahtisaari e vendosi atë në “Raportin e të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e së ardhmes së Kosovës”, zhvillimi ekonomik dhe shoqërorë në Kosovë “kërkon qartësi dhe stabilitet që vetëm pavarësia mund të sigurojë”. Komuniteti Ndërkombëtar luajti rol vendimtar jo vetëm në udhëheqjen e procesit të statusit nga fillimi në fund, por edhe në sigurimin e asaj shtytje të rëndësishme përfundimtare pasi bisedimet kishin dështuar, dhe vazhdimi i qetë i status quos ishte larg nga i sigurtë. Ky rishikim literature ka treguar se, për të gjitha sfidat dhe dështimet e tij në stabilizimin dhe zhvillimin e Kosovës menjëher pas luftës së 1999, roli i komunitetit ndërkombëtar në udhëheqjen nga lufta, shkatërrimi dhe deri në fund të pavarësisë ishte kritik, vendimtar dhe i domosdoshëm.

²⁴⁷ Deklarata e Pavarësis së Kosovës. 17 Shkurt 2008.

5.4. BASHKIMI EVROPIAN: PRISHTINA DHE BEOGRADI

Brukseli ka qenë prej kohësh faktori kryesor në mardhëniet Kosovë-Serbi. Në vitin 2008, misioni i sundimit të ligjit, i BE-së në Kosovë (EULEX) mori përsipër funksionet e policisë, drejtësisë dhe doganave nga Kombet e Bashkuara.

Tani që Kosova ka zhvilluar institucionet e veta këto kompetenca janë transferuar tek autoritetet Kosovare. Pozicioni i BE-së për statusin e Kosovës është ky: “23 shtete anëtare të BE-së e kanë njohur Kosovën si shtet i Pavarur. Pesë shtete nuk e kanë njohur: Spanja, Qipro, Greqia, Rumania dhe Slovakia. Për ti përshtatur këto dallime, qasja e BE-së ka “diversitet në njohje, por unitet në angazhim”. Për të sinjalizuar diversitetin, dokumentet e BE-së shmangin referimin e Kosovës si vend i pavarur, ndërsa angazhimi nënkupton ofrimin e perspektivës evropiane.”²⁴⁸ Si Kosova ashtu dhe Serbia aspirojnë antarësimin në BE, Serbia si vend kandidat dhe Kosova si kandidat i mundshëm.

BE ka përdorur këto aspiratë në realizimin e synimeve të saj, që është normalizimi i mardhënieve në mes dy vendeve, duke insistuar tek Serbia që duhet normalizuar mardhëniet me Kosovën para se të antarësohet. Që nga viti 2011, BE ka luajtur rolë kyq në ndërmjetësimin e bisedimeve të drejtpërdrejta në mes dy vendeve, të cilat synojnë normalizimin e mardhënieve. Dialogu teknik i filluar në mars 2011 rezultojë në provën e parë të gadishmërisë së Prishtinës dhe Beogradit për të zgjidhur problemet së bashku. Zyrtarët e Komisionit Evropian argumentojnë se procesi i normalizimit nuk ka kërkesa specifike të përcaktuara nga BE, por palët në dialog lejohen të përcaktojnë kriteret e tyre për ato që ata konsiderojnë se duhet normalizuar.²⁴⁹

Procesi i dialogut është përcjell me një natyrë të paqartë e cila ka shfaqur pikëpamjet kontestuese të dialogut se kush në të vërtetë do të përfitoj nga dialogu. Në një studim të Institutit Demokratik të Kosovës, është argumentuar se: “Rreth 71% e qytetarëve vlerësojnë se elementi kryesor për normalizimin e mardhënieve në mes Kosovës dhe Serbis është kërkim falja për krimet e luftës nga Serbia.

Rreth 60% e qytetarëve të komunitetit serb të Kosovës interpretojnë normalizimin si mos ndërhyrje në qështjet e njëri-tjetrit në rrugën evropiane ose anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare pa pasur nevojë që shtetet të njohin shtetësin në mënyrë reciproke. Ndërsa të anketuarit e komunitetit shqiptar (73%) dhe komunitetet tjera (68%) e vlerësojnë kërkim faljen e Serbis për krimet e luftës si vendimtar për normalizimin e mardhënieve.”²⁵⁰ Pra roli i BE në raportet Kosovë-Serbi është monitorues-këshilldhënës, të cilin e ekzekuton

²⁴⁸ Parlamenti Evropian. (2019). Mardhëniet Kosovë-Serbi: Konfrontim apo Normalizim.

²⁴⁹ Interview Batora with DG NEAR Serbia Desk senior official, and DG NEAR Kosovo Desk senior official, 23.

²⁵⁰ Instituti Demokratik i Kosovës(2017), Sondazh:Kuvendi të Fuqizohet, Marrëveshjet e Dialogut të Zbatohet.

përmes përdorimit të pozitës gjeografike të dy vendeve dhe aspiratave të tyre për tu anëtarësuar në BE.

5.4.1. PROCESI I NEGOCIMIT: ROLI I BASHKIMIT EVROPIAN

Pas Rezolutës 64/29 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, BE ka lehtësuar dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit që fillon nga fillimi i 2011. Sipas Rezolutës, “proceci i dialogut në vetvete do të ishte një faktor për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe qëllimi i tij do të ishte promovimi i bashkëpunimit, arritja e përparimit në rrugën drejt BE-së dhe përmirësimi i jetës së njerëzve”.

Gjatë fazës së parë të negociatave teknike, palët nënshkruan disa marrëveshje për levizjen e lirë të personave, pullat doganore, njohjen e diplomave universitare, regjistrimet kadastrale, regjistrat civile, Menaxhimin e Integruar të Kufijëve. Dialogu arriti kulmin në prill të vitit 2013 me nënshkrimin e “Marrëveshjes së parë të Parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”, e përmendur shpesh si marrëveshja e Brukselit.²⁵¹ Marrëveshja 15-pikëshe që synon integrimin e Komunave me shumicë serbe të veriut të Kosovës, në sistemin kushtetues dhe juridik të Kosovës përmes krijimit të një Asociacioni/Komuniteti të Komunave Serbe. Ai afirmoi përparësin e kornizës ligjore dhe institucionale të Kosovës, duke siguruar njëkohësisht bazën për vetëqeverisje të konsiderueshme lokale për shumicën serbe në veriun e Kosovës. BE dhe aktorë të tjerë kryesorë ndërkombëtarë, si SHBA-të, OSBE, NATO dhe KB kanë mirëpritur dialogun dhe në esencë kanë përshëndetur marrëveshjen e Brukselit si një përparim historik për marrëdhëniet Kosovë-Serbi.

Dialogu ka vuajtur vazhdimisht nga paqartësi dhe mospërputhje, si në aspektin e qëllimit të tij të përgjithshëm, ashtu edhe për sa i përket zbatimit të marrëveshjeve tashmë të nënshkruara. Fillimisht, dialogu filloi si “teknik”, pa vendosur rezultatin përfundimtar të tij. Dialogu nuk ka përcaktuar së qfarë do të thotë “normalizimi” dhe as nuk ka adresuar qështjen thelbësore – pranimin e Kosovës nga Serbia. Qëndrimi ambivalent i BE-së dhe i paqëndrueshëm i shoqëruar me interpretime konfliktuale dhe narracione kotradiktore të Kosovës dhe Serbis kanë quar në konfuzion dhe tensione. Të gjithë këta faktorë kanë hedhur dyshime të mëdha në dobësinë e dialogut, si dhe në mundësinë e krijimit të rezultateve përfundimtare.

²⁵¹ Marrëveshja ndër të tjera specifikon “që asnjë palë nuk do të bllokojë, ose inkurajoni të tjerët të bllokojnë, përparimin e palës tjetër në shtigjet përkatëse të BE-së”. Shih Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), Marrëveshja e Parë ndërmjet Serbisë dhe Kosovës të Parimeve që Drejtojnë Normalizimin e Marrëdhënieve (Përkthyer).

Sa i përket sovranitetit të RKS, mund të argumentohet se dialogu i Brukselit nga fillimi i tij minoi sovranitetin e jashtëm dhe të brendshëm të vendit, pasi që ai nuk u vendos si dialog midis dy shteteve të pavarura, por më tepër si dialog në mes Beogradit dhe Prishtinës.

Siq argumenton David Philips, dokumentet dhe lajmet që vijnë nga Serbi e përshkruajnë dialogun si një mjedis Serbis dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës.²⁵² Qeveria e Serbis ka deklaruar se dialogu është mjet për të minuar shtetësinë e Kosovës dhe vonuar njohjen ndërkombëtare të tij.²⁵³ Duke vonuar njohjen ndërkombëtare dhe duke dëmtuar shtetësinë e RKS, mund të argumentohet se dialogu i motivuar dhe monitoruar nga BE, dëmton dhe cenon drejtpërdrejt sovranitetin e jashtëm të Kosoves deri sa zhvillohet pa identifikime të qarta të dialoguesve.

²⁵² Demjaha, A. (2018). Threats and Challenges to Kosovo's Sovereignty. Columbia University. Prishtinë – New York.

²⁵³ Shih Referencën 252.

KAPITULLI VI

GJETJET DHE DISKUTIM

Literatura e prezentuar në këtë studim ishte e dobishme për të dhënë një kuptim të thellë të statusit të Mitrovicës në këtë mosmarrëveshje, dhe rolin e komunitetit ndërkombëtar në zhvillimin e kësaj mosmarrëveshje.

Ky hulumtim më ndihmoi gjithashtu të fitoja një këndvështrim më të gjerë për disa nga konceptet politike dhe historike, të diskutuara nga autorë të ndryshëm të përzgjedhur. Fillimisht statusi i Mitrovicës mund të themi se momentalisht në zhvillimin e raporteve Kosovë-Serbi është kthyer në piken kyqe të diskutimit, bazuar në debatin publik i cili qarkullon në mediat lokale dhe globale, potenciali të cilin ky territor e gëzon e ka rritur edhe angazhimin e të dy shteteve për të kontrolluar atë, dhe veqanërisht serbis e cila siç është cekur në përbërje të këtij punimi nuk është prezente në mënyrë zyrtare. Presioni ndërkombëtar për Kosovën Republikë, siq duket e ka bindur edhe serbin se është momenti që të hek dorë nga Kosova, por jo siq duket edhe për veriun e saj. Bindja e serbis, shprehur në mënyrë direkte “për të marrë diçka nga Kosova”, dhe aftësia e saj negociuese do ta quaja, ka sjelle në një situatë ku, ndër autorë dhe media të shumtë diskutohet mundësia e shkëmbimit të territoreve në mes Kosovës dhe Serbis, (mundësi kjo e prezentuar nga Presidentët e dy vendeve në mënyrë indirekte duke përdorur terma si: korrigjimi i kufijeve²⁵⁴, kompromisi i dhimbshëm²⁵⁵²⁵⁶), shkëmbim i cili nënkupton tejkalimin e Veriut të Kosovës nën juridiksionin e Serbis dhe Kosova ta bëjë të njëjtën në Preshevë dhe Medvegjë, të cilat janë njësi territoriale të serbis.²⁵⁷²⁵⁸

E rëndësishme ishte zhvillimi i doktrines së NATO-së, si mbrojtësi i sigurisë dhe vlerave të përbashkëta në Evropë. Një tjetër gjë interesante ishte racionalizimi politik dhe ushtarak i dhënë një ndërhyrje “humanitare” ndryshe. Ndonjëherë dukej sikur shkaku themelor i ndërhyrjes ishte thjesht interes politik, me vuajtjet e civileve një përfitim shtesë në argumentimin e ndërhyrjes. Bazuar në literaturën dhe analizën e hulumtimit, mund të themi se qështja e Bosnjës ishte e fortë politikisht dhe juridikisht sepse Bosnja ishte antare e OKB-së, dhe ishte në sulm nga një vend jo antarë, ndërsa rasti i Kosovës ishte ndryshe,

²⁵⁴ Top Channel Albania. <https://www.youtube.com/watch?v=RYb9AbGE-8>.

²⁵⁵ Presidenti i RKS. <https://www.president-ksgov.net/sq/oped/korrigjimi-pagesor-i-kufirit-ndermjet-kosoves-dhe-serbise>.

²⁵⁶ Parlamenti Evropian. (2019). Mardhëniet Kosovë-Serbi: Konfrontim apo Normalizim. Gjindet tek: [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=EPRS_BRI\(2019\)635512](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=EPRS_BRI(2019)635512).

²⁵⁷ BBC News. <https://www.bbc.com/news/world-europe-45423835>.

²⁵⁸ DW News. <https://www.dw.com/en/opinion-serbia-kosovo-land-swap-will-open-pandoras-box/a-47751508>.

megjithëse i ngjashëm në natyrë dhe shtrirje, Bosnja dhe Kosova ishin dy probleme thellësisht të ndryshme: njera ishte problem i agresionit të huaj, ndërsa Kosova ishte një rast i shtypjes së vazhdueshme të qytetarëve të vet – një pakice etnike në shtet, por një shumice në vetvete në Kosovë, nën kontrollin e dhunshëm të një regjimi despotik dhe autoritar.

Qështja e Kosovës ishte e fortë politikisht, por jo juridikisht (në kuptimin e intervenimit nga Kombet e Bashkuara). Përfundimi u përball me një dilemë dhe duhej të bënte një zgjedhje në mes respektimit të rregullave të verbëra ligjore ose parandalimit të një katastrofe humanitare dhe ekonomike. Si përfundim, procesit të ndërhyrjes, në kohë kritike dhe të veshtir OKB vendosi të ndërhyjë pa autorizim të qartë nga Këshilli i Sigurimit. Edhe pas ndërhyrjes dhe ndaljes së luftës, komuniteti ndërkombëtar ishte prezent në Kosovë përmes administrimit të saj, në përmbajtje të studimit argumentohet se edhe në shpalljen e pavarësis ishin ndërkombëtarët ata që ndihmuan në përgaditjen e saj edhe në kontekstin e tekstit, përmbajtjes së shpalljes së saj, me qëllim të mos diskriminimit të autoriteteve ndërkombëtare prezente në Kosovë.

Pas shpalljes së Pavarësis, ndërkombëtarët krijuan ambientin për negociim, qëllimi i të cilit ishte normalizimi i marrëdhënieve në mes dy vendeve. Të gjitha këto argumente të mbledhura në përpyetje të këtij hulumtimi, na bindin që prezenca e faktorit ndërkombëtar në qështjen ndërmjet serbis dhe Kosovës ka ekzistuar që nga viti 1999. Madje lehtë mund të deklarohej se pa prezencën dhe mbështetjen ndërkombëtare pavarësia e Kosovës vështirë ose fare mund të ishte e realizueshme. Pas ekzaminimit të të gjitha instrumenteve të përdorura për të mbledhur të dhëna për këtë studim, mund të konkludohet se ka informacion të mjaftueshëm për të ju përgjigjur pyetjeve kërkimore të këtij studimi, duke pranuar ose refuzuar hipotezat.

Hipoteza 1: Nëse statusi i Mitrovicës / Veriut të Kosovës, do të ishte trajtuar njësoj si pjesa tjetër e Kosovës pas shpalljes së pavarësis nga institucionet e Kosovës, mosmarrëveshja do të ishte zgjidhur;

Bazuar në studimin e kryer kjo tezë qëndron. Vakumi institucional që nga intervenimi ndërkombëtar në 1999 dhe deri pas shpalljes së pavarësis së Kosovës ka ndihmuar në krijimin e strukturave paralele ilegale serbe, duke i zëvendësuar ato zyrtare të Kosovës. Siq shpjegohet në kapitullin 3, qështja e veriut të Kosovës nuk gëzon ushtrim të sovranitetit të RKS njësoj si Prishtina, dhe moskontrolli i këtij territori mund të identifikohet si mungesë e sovranitetit e cila është rezultat i gjendjes së këtij territori që nga intervenimi i 1999, administrimi ndërkombëtar dhe shpallja e pavarësisë së RKS. Mungesa e ushtrimit të

sovrانيتit të RKS është faktori që e dallon veriun nga pjesa tjetër e Kosovës.

Hipoteza 2: Pasuritë natyrore arsyjeja e moszgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbis;

Bazuar në gjetjet e këtij studimi mund të thuhet se kjo teze rezulton e vërtet. Sidoqoftë, nuk mund të thuhet se është arsyjeja e vetme.

Hipoteza 3: Rëndësia e vlerës historike, kulturore, simbolike, arsyjeja e (mos) zgjedhjes së kësaj krize bilateral në mes Kosovës dhe Serbis;

Hipoteza e tretë gjithashtu qëndron. Kjo hipotezë mbështetet me prova nga rezultatet e anketës së qytetarëve të dy etnive që jetojnë në Kosovë, sidoqoftë, nuk mund të argumentohet se është faktori kryesor në mos arritjen e një marrëveshje përfundimtare.

Hipoteza 4: Faktori ndërkombëtar, shtytësi dhe ofruesi i vetëm i opsioneve për arritjen e marrëveshjes;

Hipoteza e katërt qëndron, inkuadrimi i faktorit ndërkombëtar në këtë qështje që nga fillimi i saj, dhe tentimet për ta zgjidhur këtë nyje bilaterale ka qenë i pandalshëm, dhe po vazhdon edhe sot, në fakt në përmbajtje të studimit argumentohet në mënyrë të nënkuptuar se faktori ndërkombëtar ka qenë më i intersuar dhe angazhuar në arritjen e një marrëveshje më shumë se dy shtetet e përfshira në momente të caktuara.

KAPITULLI VII

PËRFUNDIMI

Përpyjekja ndërkombëtare për të zgjidhur qështjen e statusit të Kosovës, e cila filloi me 2005 nën udhëheqjen e Martti Ahtisaarit, përfundoi me shpalljen e pavarësis së Kosovës në 2008. Që atëher, Serbia i reziston integritit të Kosovës në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Beogradi gjithashtu vazhdon të mbështesë “strukturat paralele” në veriun e Kosovës të cilin serbët e mbajn jasht kontrollit të institucioneve të RKS.

Deklarata e pavarësis së Kosovës ka pasur një ndikim të thellë dhe polarizues në mardhëniet ndërkombëtare. Ndërsa mbi një e treta e vendeve të botës e kanë njohur Kosovën, të tjerët kanë qenë të shqetësuar se ajo paraqet një precedent për pakicat shkëputëse.²⁵⁹ Para së të shpjegohen rezultatet e statusit që Mitrovica / Veriu i Kosovës ka në këtë mosmarrëveshje, vlenë të theksohen pasojat që kjo mosmarrëveshje ka krijuar në këtë zonë, mungesa e autoriteteve zyrtare të Kosovës në prezencë absolute ka bërë të mundur forcimin e strukturave paralele serbe, të cilat funksionojn me urdhërat të cilat vinë nga jasht, dhe natyrisht kanë përmbajtje kundër forcimit të sundimit të ligjeve të Kosovës në atë zonë.

Gjykuar në kuptimin e sigurisë, gjendja në Veri të Kosovës mund të cilësohet si jo e keqe duke pas parasysh faktin që aty kishte vakum institucional për më shumë se dhjetë vite, por ky përkufizim nuk nënkupton se në veri ka siguri të garantuar. Sidoqoftë, situata e përgjithshme mbetet e paknaqshme dhe potencialisht e paqëndrueshme.

De jure, i gjithë territori i Kosovës është sovran, sipas parimit një vend një ligj, por de facto, në veri ka struktura paralele të cilat janë shëndrruar në një “sekret publik” për komunitetin ndërkombëtar, i cili mund të themi se me mosveprimin e tij ka kontribuar në shtrirjen e tyre që nga vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar, mosveprim i cili është vazhduar edhe nga institucionet e Republikës së Kosovës pas shpalljes së pavarësisë. Vakumi institucional ka krijuar kushte për zhvillimin e aktiviteteve kriminale nga këto struktura paralele, të cilat përveq aktiviteteve kontrbanduese krijojnë frikë tek qytetarët serb të RKS të cilët i binden institucioneve të RKS.

Komuniteti serb ballafaqohet me probleme dhe kërcënime të mëdha që vijnë nga këto grupe ilegale. Statusi i Mitrovicës vazhdon të mbetet një nga arsytet e mos arritjes së marrëveshjes, madje nga zyrtarët serb në disa raste është lënë të nënkuptohet se veriu i Kosovës mund të zgjidhte këtë problem, nëse Kosova do të hiqte dorë nga ai territorë. Se

²⁵⁹ James Summers, (2011) Kosovo: A Precedent?: The Declaration of Independence, the advisory opinion and implications for statehood, self-determination and minority rights

statusi i Mitrovicës është i rëndësishëm për këtë kontest bilateral e dëshmon ideja e shkëmbimit të territoreve nga dy presidentët, ai i Republikës së Kosovës dhe të Serbis, dhe gadishmëria e nënkuptuar nga pala serbe për tu pajtuar me këtë shkëmbim.²⁶⁰ Dymbëdhjetë vite pas shpalljes së pavarësisë, konsolidimi i shtetësis dhe sovranitetit të Kosovës, si dhe integrimi i tij brenda bashkësis ndërkombëtare ka mbetur qështje e papërfunduar.

Zhvillimet në sferën ndërkombëtare në dekadën e fundit nuk ishin të favorshme për forcimin e shtetësis së Kosovës. Politikat armiqësore të Serbis ndaj Kosovës, rritja e ndikimeve malinje Ruse dhe Turke në Ballkan, lodhja nga zgjerimi i BE-së dhe mungesa e unitetit të antarëve të saj drejt pavarësis së Kosovës, janë bërë sfida dhe kërcënime madhore dhe afatgjate për sovranitetin e Kosovës.

Bazuar në argumentet e mbledhura në këtë hulumtim, mund të themi që faktori ndërkombëtar ka pasur dhe vazhdon të ketë rolë kyq në rastin e Kosovës që nga vendosja nën mbikqyrjen ndërkombëtare (UNMIK) deri te shpallja e pavarësis. Përpjekja e Kosovës dhe realizimi i saj për shtetësi paraqet një shembull unik të shkëputjes së njëanshme të suksesshme, dhe ky procesë do të ishte i pamundur pa përkrahjen ndërkombëtare. Komuniteti ndërkombëtar ka qenë i domosdoshëm jo vetëm për ndalimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, dhe të masakrave, por edhe për të ndihmuar Kosovarët të rindërojnë institucionet vetëqeverisëse dhe funksionalizimin e tyre.

Rasti i Kosovës, i motivuar nga përjetimet e së kaluarës, synimet e së ardhmes dhe i monituar-mbështetur nga faktori ndërkombëtar (kryesisht shtetet perëndimore), mund të themi se sot e ka sjell Kosovën në një situatë relativisht të mir politike, me pavarësi dhe institucione të saj demokratike dhe të njohura nga 116 shtete.

²⁶⁰ EU Observer, <https://euobserver.com/enlargement/147484>

Kapitulli VIII

KUFIZIMET DHE REKOMANDIMET

Kjo tezë përqëndrohet vetem në një zonë territoriale: Kosovën, me specifikim të veçantë në raste të caktuara në veriun e saj. Por në kuptimin teorik dhe rrafshin e ndikimit politik, përfshihet komuniteti ndërkombëtar përmes rolit të tij në zhvillimin e këtij procesi. Ky punim prek vendet dhe rajonet përreth, veqanërisht Bosnjën, sepse përvoja e saj me luftën dhe ndërrhyrjen ushtarake të huaj është e rëndësishme për Kosovën. Përqëndrohet në dy dekadat e fundit (afërsisht 1990 – deri tani), por gjithashtu paraqitet historia e Kosovës dhe njerëzve të saj në mënyrë që të sigurohen disa informata mbi origjinën e konfliktit.

Ky studim përqëndrohet kryesisht në zhvillimet e rëndësishme për pozicionin e jashtëm të Kosovës, si dhe në marrëdhëniet e saj me qeveritë e huaja dhe organizatat ndërkombëtare: zhvillimet e brendshme paraqiten vetëm kur janë të rëndësishme për temën e përgjithshme, siq është statusi i Mitrovicës.

Për tu siguruar që tema të paraqitet në mënyrë koncize dhe të qartë, unë jam përpjekur që të përqëndrohem te figurat e mëdha në politikën ndërkombëtare, të quajtur kolektivisht: “Komuniteti Ndërkombëtar”. Ky term përfshin të gjithë faktorët e rëndësishëm të politikës së jashtme globale duke nënkuptuar shtetet me potencialin më të madh politik, ushtarak, ekonomik dhe diplomatik, gjithashtu janë përfshirë organizatat ndërkombëtare nën këtë term kolektiv, por kur ka qenë e nevojshme, janë quajtur në emrin ose akronimin e tyre. Kjo përfshin organizata të tilla ndërkombëtare si: NATO, KB, OSBE, BE. E fundit por jo më e rëndësishmja, ky hulumtim është i kufizuar në rolin e Komunitetit Ndërkombëtar në kontestin Kosovë-Serbi para dhe pas Luftës së Kosovës. Ky hulumtim është një shkrim mbi zhvillimet e përgjithshme të raporteve të Kosovës dhe Serbis, zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, ashtu siq është e përshtatshme për tezën kryesore.

Pasi u vendosën kufizimet e këtij studimi, ka disa rekomandime që do të jap. Fillimisht aktorët ndërkombëtar – së bashku me Beogradin dhe Prishtinën duhet të përmirësojnë sigurinë veriore dhe rendin publik, duke përdorur dialogun e lehtësuar nga BE për të zgjidhur sa më shumë qështje të jetë e mundur dhe për të ndertuar besim. Prishtina duhet të zhvillojë një vizion të shtetësisë që u bënë thirrje serbëve të veriut dhe të përqëndrohet në mirëqenien e tyre në mënyrë që Serbia të mos e përdorë mosbindjen e tyre serbve ndaj Kosovës si arsye të pretendimeve për të kontrolluar veriun e Kosovës.

Fokusi i Kosovës duhet të fokusohet në zhvendosjen e fokusit në raportet me serbët e veriut në tërheqjen e tyre, në kuptimin e përdorimit të fuqisë së butë në ndryshimin e

bindjes ndaj Republikës së Kosovës. Beogradi duhet të ndalojë instrumentalizimin e Veriut dhe banorët e saj për të minuar sovranitetin e Prishtinës dhe të fillojë ta shohë atë si një formë bashkëpunimi në rrugën e tyre të përbashkët për antarësimin eventual në BE. Vetëm kur të dy shtetet pranojnë se ata kanë jo vetëm interesat e tyre, por edhe interesat e përbashkta, dhe janë të gatshëm t'i adresojn ato përmes rrugëve të pranueshme reciproke, në këtë mënyrë do të zgjidhnin mosmarreveshjen më serioze territoriale të Ballkanit Perëndimor.

Në nivelin ndërkombëtar rajoni është në gjendje të “paqes negative”, e cila nënkupton mungesë lufte në mes Serbis dhe Kosovës, por konflikti mbetet i pazgjidhur, duke munguar marrëveshja përfundimtare.

Ekziston konflikti mbi qështjet territoriale; kujtimet e luftes mbahen gjallë dhe luftërat propagandiste vazhdojnë së bashku me veprimet e konfliktit ekonomik të manifestuar nga tarifa e ngritur nga Kosova në periudhën 2017-2019, dhe pengesat ekonomike të cilat asnjëher nuk kanë rreshtur ndaj produkteve të RKS, përmes mosnjohjes së targave të automjeteve, mospranimi i qdo produkti me titullin e Republikës së Kosovës. Komuniteti ndërkombëtar duhet të unifikohet në qëndrimet ndaj Kosovës dhe ti hapen rrugët e njohjes së jashtme absolute Republikës së Kosovës, duke mundësuar antarësimin në OKB, dhe në oganizatrat rajonale ndërkombëtare.

BE-ja duhet të fillojë dialogun me synime të qarta, qëllimi i të cilit duhet të jetë arritja e një përparimi real të mardhënieve ndërshtetërore, i cili do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Tejkalmimi i kërkesave boshe të pa bazuara për ndarjen e Veriut të Kosovës nga tërësia territoriale e Kosovës, sepse pasojat e një ndarje të tillë janë të njohura dhe dihet që nuk i kontribuojnë paqes,
- Obligimi i kërkim faljes së Serbis për krimet e kryera në vitet 1997-1999 në popullatën e Kosovës,
- Ndalja e Serbis në kundërshtimin e Kosovës në antarësimet në Organizatat Ndërkombëtare dhe njohjeve të saj,
- Unifikimin i BE-së në qëndrimin e saj ndaj Kosovës, dhe mos lejimi i lojrave të standardeve të dyfishta për ta përdorur situatën e Kosovës për përfitime politike-diplomatike shtetërore brenda saj.

BIBLIOGRAFIA

- Kocs, A., S. (1995). *Autonomy or Power?: Franco-German Relationship and Europe's Strategic Choices 1955-1995*. Publisher: Praeger.
- Elezi, Z. (2007). *E Drejta Kushtetuese – Përmbledhje tekstesh Universitare*. Tetovë.
- Reka, B., & Bashota, B., & Sela, Y. (2016). *Mardhëniet Ndërkombëtare*. Skopje.
- Senese, D., P., & Vasquez, A., J. (2003), *The Steps to War: An Empirical Study*. Princeton University Press.
- Gruda, Z. (2003). *E Drejta Ndërkombëtare Publike*. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
- Gruda, Z. (2000). *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*. Prishtinë.
- Heywood, A. (2008). *Politika*. Dukagjini, Pejë. (Përkthyer nga Blendi Kraja).
- Hensel, P., & Michelle, S. (2005), *Issue Indivisibility and Territorial Claims*. GeoJournal.
- Tomasevich, J. (1975). *War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1945*. Stanford: Standord University Press.
- Lee, H. (1996). *A Theory of Portability*. Springfield Ave., Urbana, USA.
- Kimura, M., & Welch, D. (1998). Specifying "Interests": Japan's Claim to the Northern Territories and Its Implications for International Relations Theory. Jstor, The International Studies Association.
- McCormick, J. (2016). *100 Years After WWI: Local to Global Impact of an International War*. University of South Carolina.
- Tucker, S. (2005). *Encyclopedia of World WWI: A Political, Social and Military History*. Santa Barbara, California, Pp, 1189.
- Banac, I. (1993). *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*. Cornell University Press.
- Huntington, S. (1996). *The Clash of Civilizations and the remakind of world order*. Touchstone, New York, p260.
- Bennett, Ch. (1995). *Yugoslavia's Bloody Collapse: Causes, Course and Consequences*. Hursta, London.
- Cirkovic, S. (2004). *The Serbs*. Malden: Blackwell Publishing.
- Ramet, P., S. & Pavlakovic, I., V. (2011). *Serbia Since 1989: Politics and Society under Milosevic and After*. University of Washington Press.
- Glenny, M. (2001). *The Balkans 1804-1999: Nationalism, War and the Great Powers*. Penguin Publisher.
- Mertus, A., J. (1999). *Kosovo: How Myths and Truths Started a War*. University of California Press.
- Reka, B. (2003). *UNMIK as an International Governance in post-war Kosova: NATO's Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations*. Spring, Skopje.
- Palowitch, K., S. (2002). *Serbia: The History behind the Name*. Hurst & Company, London.
- Peric, (1914). *La question constitutionnelle en Serbie*. Paris.
- Malcolm, N. (1998). *Kosovo: A short History*. Macmillan, London.
- Popovic-Obradovic, O. (2013). *The Parliamentary System in Serbia: 1903-1914*. Zagorac, Belgrade.
- Cirkovic, S. (2004). *The Serbs*. Malden: Blackwell Publishing.

- Krieger, H. (2001). *The Kosovo Conflict and International Law: An Analytical Documentation 1974-1999*. Cambridge University Press. Cambridge.
- Healey, D. (1948). *The Cominform and World Communism*. Oxford Academic.
- Sabrina, P., R., & Vieran, I., P. (2011). *Serbia Since 1989: Politics and Society Under Milosevic and After*. University of Washington Press.
- Katherine, M. & Bokovoy, Jill Aa. Irvine, Carol S. LLilly, 1997, *Maredheniet shtet-shoqeri ne Jugosllavi, 1945-1992*, Scranton, Pennsylvania, USA: Palgrave Macmillan, fq 296
- Anzulovic, B. (1999). *Heavenly Serbia: From Myth to Genocide*, 1st Edition. New York University Press, New York and London.
- Whitney, R., C. (1999). *NATO Authorizes Kosovo air Raids if Serbs Bar Talks*. New York Times.
- Bekker, P., & Borgen, J., Ch. (1999). *World Court Rejects Yugoslav Requests to Enjoin Ten NATO Members from Bombing Yugoslavia*, Volume: 4 Issue: 4. American Society of International Law.
- Stahn, C. (2001). *Constitution Without a State? Kosovo Under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government*. Leiden Journal of International Law.
- Eide, K. (2005). *Report for Kosovo, UN, Security Council*.
- Wigand, G. (1924). *Ethnography of Macedonia*. Leipzig.
- Demjaha, A. (2017). *Inter-Ethnic Relations in Kosovo*. South East European University, Tetovo.
- Malcolm, N. (2001). *Kosovo: A Short History*. Macmillan, London.
- Hoxhaj, E. (2008). *Politika Etnike dhe Shtetëndërtimi i Kosovës*. Dukagjini, Pejë.
- Pushka, A., & Krasniqi, N. (2007). *Gjeografia. Volumi 9. Libri Shkollor*, Prishtinë.
- Anamali, S., & Pifti, K. (2002). *Historia e Popullit Shqiptar*. Botimet Toena, Tiranë.
- Warrander, G., & Knaus, V. (2010). *Kosovo: Bradt Travel Guides*, England.
- Osbuild, R., & Bartlett, W. (2011). *Western Balkan Economies in Transition: Recent Economic and Social Developments*. Springer. Prishtinë.
- Sentija, J. (1978). *Enciklopedia e Përgjithshme e Institutit Lexsikografik Jugosllav*. Miroslav Krleza Institute of Lexicography.
- Hensel, P., & Mitchell, S. (2011). *Issues and Conflict*, Jacobsen. Nova Science Publishers, New York.
- Smith, D., A. (1991). *National Identity*. University of Nevada Press, Nevada.
- Newman, D. (1999). *Real Spaces, Symbolic spaces: Interrelated Notions of Territory in the Arab-Islamic Conflict*. Nashville, Vanderbilt University Press.
- Vasquez, J. (1993). *The War Puzzle*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Goddard, S. (2006). *Uncommon Ground: Indivisible Territorial and the Politics of Legitimacy*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Thompson, E., J. (1995) *State Sovereignty in International Relations: Bridging the Gap between Theory and Empirical Research*. The International Studies Association.
- Jackson, R. (1990). *Quasi-States: International Relations, and the Third World*. Cambridge University Press, Cambridge..

- Barkin, J., S. (2006). *International Organization: Theories and Institutions*. Macmillan, New York.
- Barkin, J., S. (1998). *The Evolution of the Constitution of Sovereignty and the Emergence of Human Rights Norms*. Millennium 27. New York.
- Perscott, V., & Triggs, D., G. (2008), *International Frontiers and Boundaries*. Leiden, The Netherlands Brill.
- Folk, A., R. (2005). *Toward Authoritativeness: The ICJ Ruling on Israel's Security Wall*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Wilde, R. (2011). *Self-Determination, Secession and Dispute Settlement after the Kosovo Advisory Opinion*. Leide Journal of International Law.
- Walter, Ch., & Ungern-Sternberg, A., V., & Abushov, K. (2014). *Self-Determination and Secession in International Law*. Oxford University Press.
- Howse, R. (2010), *How has the ICJ Contribute to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?*. Germany.
- Nolte G (2006) *Secession and external intervention*. Cambridge University Press, Cambridge. pp 65-93.
- Dugard, J., & Raic, D. (2006). *The Role of recognition in the law and practice of secession*. Cambridge University Press, Cambridge, pp 94-137.
- Grant, Th. (1999). *The Recognition of States, Law and Practice in Debate and Evolution*. Westport.
- Dutard, J. (1987). *Recognition and the United Nations*. Cambridge Grotius Publications Limited. p,7.
- Thomas Grant, supra note 3 at 19: see also James L Brierly. *The law of Nations*.
- Lauterpacht, H. (1948). *Recognition in International Law*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Judah, T. (2008), *Kosovo: What Everyone Needs to Know*. Oxford University Press, Oxford.
- Morgenthau, J., H. (1978). *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*, Fifth Edition. Revised, New York.
- Thucydides, Cravley, R. (2004). *History of the Peloponnesian War*. Dover, Publications.
- Goldstein, J. (1999). *International Relations*, 3rd Ed, Washington, D.C. Longman, p. 53.
- Griffiths, M. (1999). *Fifty Key Thinkers in International Relations*. Routledge, New York. p.1.
- Holliday, F. (1994). *Rethinking International Relations*. Macmillan, London. p.10.
- Vukadinovic, R. (2006). *Mardhëniet Ndërkombëtare Politike*. Kolegjin Universitar Vitoria, Prishtinë.
- Checkel, T. J. (1998). *The Constructivist Turn in International Relations Theory*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Hall, B., R. (1999). *National Collective Identity: Social Constructs and International System*. Columbia.
- Wendt, A. (1992). *Social Theory of International Politics*. Cambridge.
- March, G. J., & Olsen, J. (1998). *The Institutional Dynamics of International Political Orders*. Cambridge University Press, Cambridge.
- James Fearon, Alexander Wendt (2002), *Rationalism v. Constructivism: A Skeptical View* in Carlsnaes. *Handbook of International Relations*, Sage Knowledge.
- Sumner, T., B. (2015). *Territorial Disputes at the International Court of Justice*. Duke Law Journal.

- Lester R Kurtz (1999), *Encyclopedia of Violence, Peace and Conflict*, Cambridge
- Goldstein, S., J & Pevehouse, C., J. (2006). *International Relations*, Seventh Edition. Priscilla McGeehon.
- Child, J. (1992). *The Central American Peace Process, 1983-1991: Sheathing Swords, Building Confidence*. Boulder, CO: Lynne Rienner.
- Stein, G., J. (1989). *Getting to the Table: The Processes of International Prenegotiation*. Sage Publications, Canadian International Council.
- Crocker, A., Ch. & Hampson, O., F. & All, P. (2004). *Taming Intractable Conflicts: Mediation in the Hardest Cases*. United States Institute of Peace, USA.
- Franck, M., Th. (1983). *The Strategic Role of Legal Principles in the Falklands War*. *The American Journal of International Law*.
- Aust, A. (2005), *Handbook of International Law*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Zimmermann, W. (1996). *Origins of a Catastrophe: Yugoslavia and its Destroyers – America's Last Ambassador Tells What Happened and Why*. New York Times Books.
- Judah, T. (2008). *Kosovo: What Everyone Needs to Know*. Oxford University Press, Oxford.
- Danner, M. (1999). *Endgame in Kosovo: Ethnic Cleansing and American Amnesia*, *The New York Review of Books*.
- Andreopolos, J, M G. (2011). *What Next for Self-Determination?: Kosovo's Quest for Independence and the ICJ Opinion*. Ravenna: Longo Print.
- Balcer, A. (2011). *EULEX and the Gordian Knot of Kosovo*. Ravenna: Longo.
- King, I., & Mason, W. (2006). *Peace at any Price: How the World Failed Kosovo*. Cornell University Press, New York.
- Dzihic, V., & Kramer, H. (2009). *Kosovo After Independence: Is the EU's EULEX Mission Delivering On Its Promises?*. Fried Ebert Stiftung, Berlin.
- Hamilton, D. (2013). *Serbs and Albanians await U.N. Plan for Kosovo*. *The Washington Post*.
- Demjaha, A. (2018). *Threats and Challenges to Kosovo's Sovereignty*. Columbia University. Prishtinë – New York.

SHTOJCAT

Shtojca 1 – Pyetësi i të anketuarve

Të dhënat nga ky pyetësor do të përdoren për qëllime këkimore. Pyetësi është zhvilluar online në pamundësi të qasjes në kontaktete reale me qytetarë të etnisë serbe, për arsye të barrierave etnike të cilat ekzistojnë në Kosovë. Zhvillimi i anketës është realizuar në gjuhën angleze me qëllim të tejkalimit të pengesave gjuhësore në qasjen ndaj të anketuarve. Pyetësi i'u drejtohet dy etnive që jetojnë në Kosovë: Shqiptarëve dhe Serbëve, gjegjësisht me nga 1755 të anketuar për etni, gjithsej 3510 të anketuar.

Përmbajtja e anketës:

Specify your ethnicity:

a) Serbian; b) Albanian

1. Which value of territory of North Kosovo is more important to you?

a) Symbolic Value; b) Economic Value

Përmbajtja e anketës në gjuhën shqipe:

Specifikoni Etnin tuaj:

a) Serb; b) Shqiptarë

1. Cila vlerë e territorit të Veriut të Kosovës është më e rëndësishme për ju?

a) Vlera Simbolike; b) Vlera Ekonomike